

Maj 2016
Numri: 98
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

ETIKA




TË ARRISH PËRSOSMËRINË
PËRMES KURANIT DHE SUNETIT
DO TË THOTË TASAVVUF
OSMAN NURI TOPBASH



LETËR NËNËS
NESLIMAN NURI TURK



ZHVILLIMI MENDOR;
PËRTEJ PËRPIJEK JES
PËR TË MBIJETUAR
MESUT KAJA



RINIA
DR. ADEM ERGYL



BOTA
SADIK DANA



REVOLUCIONI FRANCEZ I VITIT 1789
AHMET MERAL

Nostalgjia është njohje

ISSN 2227-3611
9 772227 361004 0 5

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ

Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Gjithnjë më ka interesuar të kthehem e të rikthehem nëpër vende dhe objekte të braktisura, për të “koleksionuar” ato “frymë të vdekura” dhe gjurmët e tyre në entropi e sipër. Janë gjurmë që komunikojnë pa folur, çdonjëra me historinë e vet. Të turpshme si petalet në ag. Të heshtura si hija e një lisi.

Edhe ajri në të tilla vende është tjetër nga ai i zakonshmi që thithim çdo çast; një ajër për të cilin nuk mund të thuash se ka mbetur pezull, por mbase nuk qarkullon normalisht dhe si i tillë depërton më shumë, më thellë; i njeh porët tona më mirë se çdo aromë; ajër që shkruan pas-thirrma mbi lëkurë.

Edhe koha madje është një befasi më vete në këto vende: sikur i ka braktisur, sikur ka mbetur pezull, por edhe sikur u rikthehet beftë duke lënë ndonjë shenjë në kufijtë e të mistershmes. Nuk e shquan dot këtë kufi. Ai shënon kalimet tona nga faza në fazë, nga gjendja në gjendje.

Është e vërtetë se kur i rikthehesh një vendi të tillë pas një kohe pak a shumë të gjatë, çdo gjë të duket më e vogël, por ky është vetëm përjetimi i parë, pasi më pas je ti ai/a jo që zvogëlohesh e përshtjellohesh njëkohësisht nën peshën e kujtimeve. Kujtime të papërballueshme, që afrohen nga nuk e di se ku e mandej ikin sërishmi; që afrohen për të mbjellë një farë, duke të vënë në provë se a do kujdesesh që ajo farë të mbijë. Ti ke frikë nga ajo çfarë do mbijë. Ndiheh i pasigurt. Dija nuk të shërben aspak në këtë përshtjellim. Mos e përdor dijen, se përshtjellimi shndërrohet në makth.

Mund të dëgjohen zëra apo fjalë në ajrin enigmatik, dhe kjo varet nga forca e dëgjimit pa veshë. Veshët nuk bëjnë punë, madje mund të të shkëpusin. Prandaj, veshët janë një mundësi daljeje për atë që nuk rri dot në këto ambiente.

“Kujtesa për gjërat e së shkuarës nuk është e rëndësishme të jetë kujtesë për gjërat siç kanë qenë.” (Proust)

Është peshë kjo gjendje; e atillë sa nuk e mban dot për gjatë, përpos disa çasteve, të cilat e shpluhurosën me aq vrull Tjetrin brenda nesh, deri në atë pikë sa pothuaj mezi e njohim. Këtu është rasti të krahasojmë Tjetrin e dikurshëm me veten e tanishme: çfarë kemi humbur e çfarë kemi fituar; cilët ishim e cilët jemi; sa peshonte bota brenda nesh e sa peshon tani; si ka ndryshuar afrimet me njerëzit; po buzëqeshja, po çiltërsia, si dhe shumë pikëpyetje të tjera.

Maj 2016

VITI: X

NUMRI: 98

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Artur Tagani

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 607 8484

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur

se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja




11

Rinia jonë
dhe rinia e medreseve
Adem Tahir Jëllmaz



Të arrish përsosmërinë
përmes Kuranit dhe Sunetit
do të thotë Tasavvuf
Osman Nuri Topbash

34




20

52



Zhvillimi mendor; përtej përpjekjes për të mbijetuar...
Mesut Kaja

- 5 Diversiteti i ymetit
Ahmet Tashgetiren
- 8 Rinia
Dr. Adem Ergyl
- 14 Të analizosh periudhën e rinisë
Prof. dr. Sulejman Derin
- 16 Gërryerja njerëzore
përkundruall parimeve parake
Nuredin Nazarko
- 20 Lotët e nënës
Neslihan Nur Turk
- 22 Nokta'i Suvejda
Prof. dr. Et'het Xhebexhiollu
- 25 Tellal-ët vullnetarë
Xhemal Nar
- 26 Kujdes nga rënkimi i atij
që i është bërë padrejtësi
Ismail Lutfi Çakan



46

Testi i inteligjencës dhe Ahireti 29

Nuredin Jëlldëz

Mrekullitë e Kuranit 30

Një Ajet - Një Hadith 32

Bota 41

Sadik Dana

Mallkuar qofshin kriminelët! 42

Ali Riza Temel

Vendosmëria në rrugën e drejtë 44

Xhafer Durmush

Zekvan Ibn Abdikajs 46

Xhafer Durmush

Misioni objektiv i thirrësit në Islam 48

Doç. dr. Muhamed Mustafi

Ndaj dhe rrotullohemi 51

Ali Byjyqçapar

Revolucioni francez i vitit 1789

Ahmet Meral



54

10 përgëzime për atë që e fal namazin e sabahut me xhemat
Naim Driçaj

58



Diversiteti I YMETIT

Ahmet Tashgetiren

Dikur **“ymeti më i nderuar ishte ymeti muhamedan”**, sepse nderi ishte veçori përbërëse e tij, nderi ishte një përfundim i natyrshëm i lidhjes me Allahun dhe me të Dërguarin e Tij.

Ndërsa tani ai ymet është në një gjendje të trishtueshme, si pasojë e divergjencave që po përjeton nga brenda.

Një ymet që në kohën e Resulullahut (a.s.), ishte një i vetëm, njerëzit kapeshin dorë për dore, bëheshin rrathë-rrathë, kurse sot shohim shpërndarje, shohim përçarje, trishtim. Nuk duhet të ishte kështu ymeti i Muhamedit, por sa keq që, me sa duket këto ndodhin si pasojë e të mosqenit e një pjesës tonë të rëndësishme **“ymet i Muhamedit”**.

Me siguri nuk është ky i njëjti diversitet që përmendte Resulullahu (a.s.), kur thoshte: *“Diversiteti i ymetit është mëshirë.”* Pasi, Resulullahu krijoi

“ymetin e nderuar” duke riparuar dhe përmirësuar sjelljet që thyejnë zemrën e njëri – tjetrit, si dhe duke pastruar qendrat diverse që shkatërronin lidhjen e sinqertë mes tyre.

Po, mundet që “divergjenca”, mendimet ndryshe, qasjet e ndryshme, janë “mëshirë”. Atëherë kur besimtarët bëjnë çdo përpjekje, sado diverse qoftë, por me qëllim kërkimin dhe ndërtimin e mirësive të përbashkëta. Të gjithë këto kërkime kanë një kontribut në hauzin e ymetit të përbashkët. Rrugët që të çojnë tek e vërteta mund të jenë të ndryshme. Diversiteti duhet drejtuar nga qëllimi për të gjetur më të mirën. Ndonjëherë, kur artikullohet ajo çfarë është më kontradiktoria madje gjatë një diskutimi a shqyrtimi, për sa kohë që qëllimi është pëlqimi i Allahut dhe pasurimi i hauzit të përbashkët të ymetit, duhet konsideruar si një mirësi.

Mirëpo, thënia *“Diversiteti e ymetit është mëshi-*

rë”, nuk do të thotë se çdo lloj divergjence është mëshirë. Në Epokën e Lumturisë janë përjetuar disa divergjenca që, vetë Resulullahu (a.s.), i pati etiketuar si **“sjellje të periudhës së injorancës”**.

Ndaj dhe në një shoqëri myslimane nuk pranohej ndjenjat dhe sjelljet mashtruese mes vëllëzërve myslimanë.

Ndërkaq, për shkak të veçorisë së të qenit universal të Islamit, përfshirja si pjesë e ymetit e popujve të ndryshëm është e pashmangshme dhe në Ligjëratën e Lamtumirës, Resulullahu ka dhënë mesazhe të qarta mbi dëmtimin që shkakton për ymetin keqkuptimi i diversitetit racor, gjuhësor dhe krahinor. Këto mesazhe manifestojnë qëllimin e tij për të flakur tutje divergjenca të lindin nga diversitetet racore, gjuhësore dhe krahinore që gjendeshin në zemrat e besimtarëve të papjekur akoma me të vërtetën e islamit.

Islami nuk ka lënë jashtë vëmendjes probabilitetin e diversitetit në marrëdhëniet që do të krijojnë njerëzit apo popujt me njëri-tjetrin, qofshin këta edhe vetë myslimanë mes vete. Njerëzit kanë një marrëdhënie të tillë me njëri-tjetrin, saqë, që në ditët e para që është krijuar madje, vëllai ka arritur të lëndojë vëllain e vet. Pra, është bota e Habilëve dhe Kabilëve.

Edhe myslimanët janë të pajisur me plot dobësi njerëzore, nuk janë qenie që u është hequr nervi. Kur bëjmë fjalë për myslimanin, nuk flasim për engjëj. E kemi fjalën për njerëz që shejtani merret me ta, që nefsi u ka krijuar pezmatim në sistemin mendor.

Në ajetin 59 të sures Nisa, na tregohet se si duhet të sillemi në situata të tilla. Kuptimi i ajetit është ky:

“O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiamet-

tit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur.” (Nisa, 59)

Kujt i drejtohet? Besimtarëve!.. Pikësëpari këtë duhet të bëjmë kujdes. Pastaj vijnë thirrjet e tjera:

- Bindjuni Allahun.

- Bindjuni të Dërguarit (a.s.).

- Dhe, besojuni atyre njerëzve që respektojnë urdhrat hyjnore dhe drejtuesve që i besojnë Allahut dhe Pejgamberit.

Pastaj vjen radha e zgjidhjes së problemit të diversitetit:

- Nëse bini në kontradiktë lidhur me një çështje, çojeni atë çështje tek Allahu dhe i Dërguari i Tij. Një veprim i tillë është edhe më i mirë edhe më i bukur nga aspekti i nxjerrjes së ndonjë përfundimi.

Këtu ekziston detaji **“Nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit.”** Që do

të thotë se “besimi tek Allahu dhe Dita e Kiametit” është pika kyçe e gjithçkaje. Nesër në Ahiret do të dilni në audiencën e Allahut dhe aty, nën ndriçimin e Mahsherit, edhe sikur të mos arrijë gjuha të rrëfejë, do të arrijnë duart e këmbët tuaja të dëshmojnë dhe të gjithë organet, dhe aty do të vërtetohet se sa ia keni adresuar veprat Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Pa konsultohuni me zemrën tuaj, vallë vërtet çështjet e ndryshme ia keni atribuar Allahut dhe Resulullahut, apo mos ndoshta e keni konsideruar zot dëshirën tuaj, dhe keni marrë për bazë orientimet e dëshirave tuaja, në vend të orientimeve të Allahut të Madhëruar?

Pa konsultohuni pak me zemrën tuaj, vallë ajetet e Allahut i keni përdorur për interesat tuaja, në shërbim të ndjenjave tëhuajëzuese, në favor të nefsit tuaj? A mos keni përdorur shembujt e jetës fisnike të Resulullahut për bindjet e grupit tuaj, e partisë suaj?

Vërtet, ç’do të thotë “t’ia atribuosh Allahut dhe të

“Ju vini tek unë duke më shndërruar në gjyqtar. Ndonjëri prej jush mundet që të jetë më i shkathët në argumentim. Nëse unë jap një gjykim që cenon të drejtën e vëllait tjetër, duke u bazuar në ato çfarë thotë tjetri, atëherë le ta dini se unë i jap atij një copë nga zjarri i Xhehenemit; le të mos e marrë atë!”

Dërguarit të Tij zgjidhjen e çështjeve diverse”?

Kjo gjë mund të ishte e lehtë të bëhej gjatë jetës së Resulullahut. Shkohej tek Resulullahu dhe i tregohej çështja, pastaj Resulullahu jepte gjykimin e çështjes, nëse kishte ajet të shpallur, nëse jo, shpallej ajeti përkatës.

Edhe në kohën kur ai ishte në këtë jetë nuk qe aq e lehtë. Kur i patën sjellë çështje të diskutueshme diverse, i pati qortuar në këtë mënyrë:

“Ju vini tek unë duke më shndërruar në gjyqtar. Ndonjëri prej jush mundet që të jetë më i shkathët në argumentim. Nëse unë jap një gjykim që cenon të drejtën e vëllait tjetër, duke u bazuar në ato çfarë thotë tjetri, atëherë le ta dini se unë i jap atij një copë nga zjarri i Xhehene-mit; le të mos e marrë atë!” (Buhariu, Shehadat, 27.)

I Dërguari i Allahut, ndonëse e donte shumë, ka qortuar një shok të tij duke i thënë *“a ia hape zemrën dhe e pe ti?”*, pasi ai kishte justifikuar vrasjen e një personi, ngaqë pretendonte se ai kishte thënë shehadetin nga frika, ndërkohë që ishin në fushëbetejë. Nuk është edhe aq e lehtë ta konsiderosh islam veprimin duke gjykuar ato çfarë duken nga jashtë. Një ditë, kur të ndërtohet gjykata e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij, do të dalim ballë për ballë dhe do të pyetemi: *“a ia hape zemrën dhe e pe ti?”*

- Kudo nëpër botë gjenden plot myslimanë që etiketojnë njëri –tjetrin me vulën e “hipokritit”.

- Ndërkohë që bëhet tekfir tjetri, pra, damkoset me vulën e qafirit/femohuesit, a merret ndopak me mend dëshmia e Allahut dhe të Dërguarit të Tij?

- Ndërkohë që kërkohet ndonjë shenjë hipokrizie tek tjetri, njeriu, njerëzit, nuk shohin tek vetja fjala vjen, nëse kjo gjë është përgojim!

- Askënd nuk e shqetëson përgjegjësia e përdorimit të ajeteve të Allahut dhe thënieve profetike porsì një shkop për t’i rënë tjetrit në kokë.

T’ia atribuosh Allahut dhe të Dërguarit të Tij çështjet diverse, do të thotë të bartësh brenda Prehjen Sublime. Dhe të bartësh brenda atë prehje do të thotë të ndihesh në trajtën **“ihšan”**, pra, të jesh një besimtar që jeton gjithnjë me vetëdijen sikur e sheh vazhdimisht Allahun.

Duke thënë se Allahu dhe Resuli i Tij do e zgjidhte në këtë mënyrë këtë çështje, do të thotë të japësh gjykim duke bërë dëshmitarë Allahun dhe të Dërguarin e Tij.

Pashë Allahun, kështu bëhet lidhur me zgjidhjen e diversiteteve të ymetit kohëve të fundit? Pse, kështu funksionon sistemi i akuzimit të tjetrit me hipokrizi, gjë e cila konsiderohet si **“më e keqe edhe se vetë femohimi”**?

Pse, kështu myslimanët duhet të fusin e të nxjerrin njëri – tjetrin në Islam? Ndërkohë që dy grupe i bien në qafë njëri – tjetrit, a mos vallë po marrin leje nga Allahu dhe i Dërguari i Tij?

Natyrisht që jo.

Është koha për të pastruar të brendshmen tonë.

Që të jemi një shoqëri që meriton të qenit “ymet i Muhamedit”.

Përpjekja jonë për të mos bërë sjelle a vepra për të cilat është e vështirë të jepet llogaria në Ahiret, veçanërisht gjykimi i një tjetër besimtari me epitete që kalojnë kompetencën tonë nuk është tjetër veçse një krim që i bëjmë tjetrit. Sprova që po japim ne si myslimanë të kësaj kohe, është sprova e **“të qenit apo të mos qenit ymet i Muhamedit!”** Nuk ekziston ndonjë lloj sprove duke prerë kokën e njëri – tjetrit. Në shekullin 21, është e pamundur të vijë pranvera e Islamit duke qenë ende sot në mesin tonë **“pjellat e kohës së injorancës”**.

Ne duhet të dëgjojmë sërish thirrjen e Kuranit: **“Vraponi drejt Allahut!”** Sërish duhet ta kapim për dore pejgamberin tonë të dashur, Muhamedin (a.s.).

*Përpjekja
jonë për të mos bërë
sjelle a vepra për të cilat
është e vështirë të jepet llogaria
në Ahiret, veçanërisht gjykimi i
një tjetër besimtari me epitete që
kalojnë kompetencën tonë
nuk është tjetër veçse
një krim që i bëjmë
tjetrit.*



RINIA

Raporti mes rrethit shoqëror dhe atmosferës

Dr. Adem Ergyl

Çdo popull, çdo familje dhe ndoshta çdo individ diskuton ose duhet të diskutojë mbi çështjen e rinisë. Secili shpreh botëkuptimin dhe pritshmëritë e veta mbi periudhën e rinisë. Kjo është një ndjenjë e bukur. Pasi rinia është një thesar aq i madh, sa nuk u duhet lënë vetëm të rinjve. Rinia është pasuria më e rëndësishme e prindërve dhe e të gjithë atyre që kanë një kauzë; e atyre që kanë diçka për të thënë dhe që kanë synime lidhur me të ardhmen; e shtetit dhe e popujve.

Periudha e rinisë njihet si pranvera e kalendarit të jetës. Gjithçka është e gjallë dhe dinamike. Trupi është dinamik, perceptimi dhe kuptimi është i shpejtë, është e vështirë t'i limitosh ndjenjat dhe ëndërrimet, sjelljet janë me gjithë zigzaget e veta. Gjatë rrugëtimit të njohjes së vetes në këtë periudhë, nganjëherë shfaqen kryengritjet e brendshme, mburrjet e llojit “e di unë!”, pretendimet,

këmbënguljet dhe trimëritë. Ndaj dhe kjo periudhë duhet analizuar siç duhet, duhet organizuar dhe udhëhequr në mënyrë të shëndetshme.

Thuhet se njeriu është fëmija i mjedisit që e rrethon. Vallë, a ia kemi arritur t'u ofrojmë një atmosferë dhe mjedis të volitshëm të rinjve tanë?

Për shembull, atmosfera e familjes sonë a është e përshtatshme për një gjë të tillë? A kemi ndonjë përpjekje për ta njohur saktë të riun, me temperamentin e ndjenjave që e karakterizon atë? A e respektojmë atë? Mesazhin “*Mirë që je!*” dhe “*Ti je një djalosh shumë me vlerë!*”, a e japin njëkohësisht si me fjalë ashtu edhe me gjuhën e trupit, si dhe me qëndrimet tona? A kemi arritur të duam ta shohim brenda botës së sotme a së nesërme që do të jetojë ai, apo po përpiqemi ta tërheqim brenda botës sonë të djeshme? Si duhet t'i pajisim ata, sipas periudhës që jetojnë ata, apo sipas asaj

që kemi jetuar ne? Kur duket se nevojitet sakrificë materiale dhe shpirtërore, deri ku e kemi limitin? Nëse dëshirojmë që ai të jetë një hap më përpara se shokët e brezit të tij, a kemi ndonjë plan zhvillimor mbi të cilin bazohemi? Pyetjet mund të shtohen edhe më shumë se kaq. Këto pyetje dhe përgjigje, në një farë forme duhet të bëhen brenda në familje. Pasi vendi ku brumset personaliteti i një njeriu është atmosfera e familjes.

Natyrisht, nuk mbaron gjithçka me klimën familjare.

Në krye të mjediseve më të rëndësishme për rininë janë rrethet shoqërore dhe rrugët ku mund të jetohet. Në fakt tashmë rrugët janë zmadhuar dhe zgjeruar. Bota virtuale thuhet se ka shkatërruar të gjithë muret dhe tashmë të gjitha rrugët janë kthyer në vende ku mund të shëtisim lehtësisht të gjithë. Edhe shoqëria është virtualizuar. Tashmë kemi ardhur në një kohë shumë më të vështirë. Mirëpo, nuk mund të mohohet rëndësia dhe ndikimi i rrugëve ku jetohet dhe shoqërisë, pjesë e së cilës është individi. Kësisoj, neve na duhet të zgjedhim rrugën në të cilën do të jetojnë shëndetshëm brezat. Tashmë me sa duket, hixhretet moderne në metropole do të realizohen si zgjedhje për lagjet. Pasi nuk janë të njëjtë të rinjtë që rriten në një lagje pa ezan me të rinjtë që rriten në një lagje ku përjetohen vlerat shpirtërore.

Qendra më e rëndësishme e lidhjes (network) ku rinia rritet është mjedisi shoqëror. Për të krijuar këtë mjedis të përshtatshëm, duhet hyrë në një kërkim serioz dhe duhet ndihmuar rinia. Pata dëgjuar një kujtim të një njeriu të ngritur. Le ta ndaj me ju:

“Njeriu nuk arrin dot ta menaxhojë siç duhet fëmijën e vet, veçanërisht në periudhën e rinisë. Pashë që edhe tek fëmijët tanë nisi të dukej një mangësi interesimi shpirtëror dhe emocional ndaj fesë. Një ditë i bëra një vizitë profesorit të shkollës së

mesme, ku studioja, me të cilin mendoja se ndaja gjithçka. “Profesor, i thashë, ecuria e fëmijëve tanë nuk është në atë formë siç më do zemra. Ju i keni parasysh nxënësit që i japin përparësi jetës shpirtërore fetare. Sikur të planifikonit t’i bëni shokë me njëri – tjetrin këtë kategori djemsh... Madje, mund t’ju mbështes edhe ekonomikisht për këto lloj iniciativash. Për shembull, sikur t’u blejmë dhurata që të shkëmbejnë mes njëri – tjetrit, me qëllim që të afrohen me njëri – tjetrin. Mirëpo, mos të na e marrin vesh ata këtë strategji. Le të mbesë mes nesh kjo gjë, si një sekret.” Elhamdulillah, pas pak javësh u vërejt dobia e kësaj iniciative. Të rinjtë filluan t’i shikonin me një sy tjetër namazet dhe veprat e tjera adhurimore.”

Ky është një shembull... Ajo çfarë dua të them është që marrëdhënia në të cilën gjendet i riu i sotëm, veçanërisht në botën e sotme është bërë mjaft e rëndësishme. Ndihej që u duhet dhënë atyre është një detyrë që bie përsipër fillimisht mbi prindërit e vet, pastaj mbi vëllezërit dhe motrat më të mëdha, mbi mësuesit dhe mbi organizatat vullnetare përkatëse.

Sot shkolla zë thuhet 1/3 e jetës së një njeriu. Pra, hauzet rinore tashmë janë shkollat. Ndaj dhe duhet t’u kushtojmë vëmendje këtyre foleve, që shërbejnë për t’i dhënë formë rinisë. Një nga çështjet që si shtet dhe popull duhet t’i kushtojmë më shumë kujdes është edukimi dhe shkolla.

Shkolla/universiteti nuk është thjesht ndërtesa. Është një institucion që duhet vlerësuar si i tërë, me mësime dhe personelin në përgjithësi, ambientin dhe situatën e studentëve brenda. Kështu që, mësuesi të cilit ia dorëzojmë të riun është mjaft i rëndësishëm, ambienti i shkollës është shumë i rëndësishëm, cilësia e studentit është po ashtu shumë e rëndësishme. Duhet që t’i zgjedhim ata dhe të ndjekim ecurinë e edukimit të tyre. Pasi cilësia e jetës përbëhet nga cilësia e zgjedhjeve.

Gjatë periudhës së rinisë roli-modeli për ta është

*Marrëdhënia
në të cilën gjendet i riu i sotëm,
veçanërisht në botën e sotme
është bërë mjaft e rëndësishme.
Ndihej që u duhet dhënë atyre
është një detyrë që bie përsipër
fillimisht mbi prindërit e vet,
pastaj mbi vëllezërit dhe motrat
më të mëdha, mbi mësuesit
dhe mbi organizatat vullnetare
përkatëse.*

shumë i rëndësishëm. Në kulturën tonë ekziston një element mjaft i rëndësishëm që lehtëson rritjen e shëndetshme të të rinjve, një pikë reference për sjelljet dhe shprehjet e tyre, që është vëllai i madh dhe motra e madhe. Kjo, gjithashtu është një nga suportet më të bukura që mund të bëjnë organizatat vullnetare për rininë. Mundet që të jetë shumë më e rëndësishme sesa prindërit, mësuesit apo personeli i punës sociale, psikologët.

Njëri nga njerëzit e mëdhenj thoshte: *“Përpiqu që të angazhosh nefsën me të vërtetën. Nëse nuk e bën këtë, atëherë vjen e shëmtuara dhe vendoset këmbëkryq në zemrën tënde.”* Gjatë periudhës së rinisë cytjet e nefsit dhe të shejtanit janë më evidente dhe më dinamike. Ndaj dhe i riu duhet impenjuar me gjëra të duhura dhe duhet ruajtur që të mos bëhet lodër në dorën e nefsit dhe shejtanit. Në këtë kuptim, mënyra më e zgjuar është që të rinjtë t’i angazhojmë me role dhe detyra në këto projekte të vullnetarizimit.

Vetmia është dobësi. Shejtani dhe nefsi njeriun e vetëm, njeriun e vetmuar, e nxjerr më lehtë nga rruga. Shumica e gjynaheve bëhen kur njeriu është vetëm. Ndaj dhe, duke u nisur nga qëllimi për të përfituar nga fuqia udhëheqëse dhe tërheqëse e psikologjisë së turmës, vendosja e të rinjve në grupe të sinqerta dhe besnike dhe bërja e tyre anëtarë të këtyre organizimeve është një strategji edukative mjaft e rëndësishme.

Gjatë periudhës së rinisë, njohja me vlerat fetare, madje dhe unifikimi me këto vlera, është një domosdoshmëri që njeriu të arrijë deri në një pikë që të fitojë pëlqimin e Allahut. Veçanërisht një besim i shëndoshë përbën themelin e të gjitha vlerave. Duhet vendosur në zemër aq fort besimi në Allah, në profeci dhe në Botën Tjetër, sa të mos krijojë asnjë pikë dyshimi. Pasi të gjitha domosdoshmëritë e të qenit rob i Zotit, vendosen mbi këto themele.

Marrëdhënia me fenë nuk është thjesht një aksesor, por raporti me fenë duhet parashtruar si

një sistem që përfshin të gjithë jetën. Veçanërisht vetëdija e namazit duhet vendosur mirë në zemër gjatë kësaj periudhe dhe duhet bërë pjesë e pandashme e jetës për të rinjtë. Veçoria e faljes së pesë kohëve të namazit tek një i ri, është një tregues i rëndësishëm i vetëdijes islame. Në këtë kontekst, namazi është një shenjë e një shkalle të lartë.

Rinia sot duhet të marrë masa për të mbrojtur qëndrimin e saj dhe nderin e saj me dinjitet. Kjo gjë varet nga zhvillimi i personalitetit që ai përpiqet të bëjë. Kjo gjë varet po ashtu edhe nga profesioni, karriera dhe profesionalizmi që përpiqet të krijojë tek vetja e tij, me qëllim për të zënë vendin e merituar në shoqëri. Prandaj dhe ne duhet të bëjmë përpjekjen maksimale që të rinjtë e sotëm të pajisen me ato nevoja dhe pritshmëri të kohës që ata jetojnë. Disa prej tyre janë: diplomat, certifikimet, gjuhët e huaja, patenta, dëshmi aftësimi dhe njohjeje të teknologjisë dhe informatikës etj. Nuk duhet synuar një rini që ecën me bastun, si i ati apo farefisi, por duhet të bëjmë qëllim që të rrisim breza që ecin me këmbët e tyre, madje edhe që vrapojnë drejt së ardhmes.

Njeriun e ri nuk duhet ta rrisim dhe edukojmë duke e mbyllur brenda, duke e mërztur apo duke i treguar pushtetin që kemi mbi të, por përmes aktivizimeve cilësore, përmes udhëheqjeve të ndryshme, duke i ngarkuar punë e shërbime vullnetare, duke i dhënë detyra e përgjegjësi. Rinia që do ta sistemojë botën në linjën e vullnetit të Zotit dhe që të përfaqësojë dinjitetin e ymetit islam, është e detyruar të jetë një rini me kokën lart, që t’i besojë vetes, e kujdesshme dhe e suksesshme. Nuk ka nevojë për një rini që s’ka aftësi, që s’ka ambicie, që ka humbur vetëbesimin, që është bërë pjesë e rëndomtë e turmës, gjoja e edukuar, pasive, por nevojitet një rini me liderë që do t’i japin drejtim kohës që jetojnë. Për t’u rritur një rini e tillë, detyra që bie mbi të gjithë ata që janë në postet përgjegjëse është që të krijojnë dhe të zhvillojnë ambiente, atmosfera dhe mundësi të mira që mund t’u shërbejnë atyre.

Njeriun e ri nuk duhet ta rrisim dhe edukojmë duke e mbyllur brenda, duke e mërztur apo duke i treguar pushtetin që kemi mbi të, por përmes aktivizimeve cilësore, përmes udhëheqjeve të ndryshme, duke i ngarkuar punë e shërbime vullnetare, duke i dhënë detyra e përgjegjësi.



Rinia jonë dhe

RINIA E MEDRESEVE

Adem Tahir Jëllmaz

RINIA DHE ARSIMI

Rinia zë një vend të veçantë në popullsinë tonë. Rinia është një urë lidhëse mes së shkuarës dhe së ardhmes. Të rriturit dhe të moshuarit janë në përpjekje të vazhdueshme për t'u dhënë formë të rinjve. Kurse të rinjtë dhe të rejat po mundohen që me çdo kusht të realizojnë dëshirat e tyre. Çdo i rritur dhe i moshuar përpiqet për të rritur të rinj dhe të reja sipas rinisë së kohës së vet, sipas atij mentaliteti dhe botëkuptimi. Dhe pikërisht këtu nis ajo përplasje e heshtur apo edhe ndonjëherë e zhurmshme. E ardhmja që përpiqet të përgatitet për këta të rinj është në fakt ajo çfarë imagjinojnë të rriturit për ta. Ky brez është ajo gjeneratë që, ndërkohë që marrin këtë formë që u ofrohet, përpiqen gjithashtu të qëndrojnë drejt përballë mendimeve dhe veprimeve që janë në kundërshtim me atë çfarë ndjejnë ata se duhet të realizojnë.

Kur i hedhim një sy sures Kehf, se si e përshkruan psikologjinë e të rinjve, vërejmë se bëhet fjalë për një lloj rezistence dhe kundërveprimi: “...**Ata ishin**

djelmossa që besonin në Zotin e tyre dhe Ne i forcua në rrugën e drejtë. Ne i forcua zemrat e tyre, kur u ngritën e thanë: “Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe i Tokës. Ne nuk do t’i lutemi asnjë zoti tjetër, përveç Tij, sepse atëherë do të thoshim një gënjeshtër të madhe.”

(Kehf, 13-14) Pra, bëhet fjalë për një lloj qëndrimi të patundshëm të të rinjve me tërë vetëdijen e tyre drejt së vërtetës. Të rinjtë janë një brez që mbrojnë të drejtat duke marrë përsipër çfarëdolloj sakrifice që u kërkohet atyre. Ndonëse duket i vështirë edukimi nga ky aspekt, por është një brez që mund të merren rezultate në varësi të sakrificës që bëjnë ata për veten e tyre. Kur bëhet fjalë për arsimimin e të rinjve tanë, kurrë nuk duhet të harrojmë këtë anë të tyre. Nëse duhet t’i hedhim një shikim me sy kritik kësaj çështjeje, atëherë problemet themelore lidhur me arsimimin e të rinjve mund të trajtohen në disa kategori:

- Familjet që nuk e kuptojnë ose që nuk mund ta kuptojnë botën e të rinjve;
- Veprimet negative të individëve dhe qarqeve që

përpiqen të shtojnë fuqinë ekonomike nëpërmjet tyre dhe që përpriqen të përdorin të rinjtë për qëllimet e tyre;

- Një mjedis edukativ dhe stafi mësimor që vonohet në përditësimin e vetes dhe që nuk u flet pritshmërisë së të rinjve;

- Një mjedis akademik që nuk bën përpjekje të thellohet më tej në fushën e edukimit të të rinjve dhe që nuk zhvillon politika mbi të rinjtë;

- Mungesa e veprimtarive dhe mjediseve artistike, letrare, mediatike dhe botuese, gjëra të cilat formësojnë jetën e të riut mbi vlerat e besimit dhe qytetërimit islam;

- Hedhja në plan të dytë e edukimit të personalitetit dhe karakterit dhe përparësia e planifikimit të karrierës;

- Dhe më e rëndësishmja, mungesa e njerëzve sakrifikues, njerëzve shpirtërorë dhe organizatave civile, që mund të organizojnë të rinjtë rreth një ideali, që mund t'i nxisin ata dhe që mund t'i përsosin ata...

MEDRESETË, INSTITUCIONET EDUKATIVE TË TË RINJVE

Medresetë¹ janë shkolla që janë hapur për arsye të kërkesave të popullit. Populli ynë deshi që të jepet arsim fetar nën kontrollin e shtetit, ndaj dhe që kur u hapën pati një lloj frekuentimi të gjerë. Që kur arsimi i detyruar u bë 12 vite në shtetin tonë, iu shtua shkollimi i ciklit të mesëm dhe kjo rritje e natyrshme ashtu sikurse në të gjitha ciklet e mesme, po ashtu ra në sy edhe në medrese. Rritja e numrit të nxënësve në medrese vazhdonte në mënyrë të natyrshme deri në vitin 1997 – 1998. Me mbylljen e ciklit 8-vjeçar në vitin 1997 dhe me zbritjen që i bëri qeveria e atëhershme numrit të maturantëve të medreseve për të hyrë në universitete, nisi një frenim i nxënësve, madje pati një pakësim të tyre në regjistrimin në medrese. Kjo ndalesë dhe pakësim i nxënësve në medrese vazhdoi derisa në vendin tonë u hoqën pengesat dhe u vendos drejtësia. Veçanërisht me heqjen e koeficientit pengues dhe me hapjen e shkollave 8-vjeçare të medreseve nisi sërish një rritje e numrit të nxënësve të medreseve, pas afro 10 viteve ndalimi dhe pengimi të rritjes së medreseve.

Prej vitesh pritej prej popullit tonë të hapeshin 8-vjeçarët e medreseve dhe pas këtij interesimi u hapën një sërë medresesh të ciklit 8-vjeçar. Rritja e numrit të nxënësve të medreseve ishte pasoja e natyrshme e hapjes së pengesës së një uji që rridhte.

Kjo dyndje lindi nevojën e ndërtesave të reja dhe të stafit të ri. Krahas kësaj, në shkollat 8-vjeçare, që më pas u bënë 9-vjeçare dhe në ciklin e mesëm bëri që të shtohet nevoja e mësuesve të lëndëve të Kuranit Famëllartë dhe të Njohurive Themelore të Lëndës së Besimit, të cilat ishin si lëndë me zgjedhje. Mospasja e studentëve të diplomuar nga Fakultetet Teologjike Islame, si pasojë e mospasjes së kontingjentit të studentëve të vetëdijësuar për një periudhë të caktuar, veçanërisht ka sjellë në aktualitet nevojën imediate të një stafi të aftë mësimdhënës veçanërisht të lëndëve fetare. Ndaj dhe në vitin 2014 fakulteteve teologjike islame u është dhënë kontingjent mbi dhjetë mijë dhe po merren masa për të plotësuar hapësirën e krijuar të mësuesve të lëndëve fetare.

Një tjetër çështje e arsimit të sotëm është edhe cilësia e arsimit. Ky problem pikësepari zgjidhet duke nxjerrë mësimdhënës cilësorë. Fakultetet e edukimit dhe institucionet që nxjerrin mësues nuk i kanë të përditësuar programet sipas brezit të ri, ndaj dhe nuk arrijnë dot të nxjerrin mësimdhënës që mund të edukojnë njerëzit e së ardhmes. Raporti mes kurrikulës apo metodologjisë së arsimit që jepet apo duhet dhënë në shkolla me ato të universiteteve nuk është në nivelin e duhur. Duke e parë këtë çështje në këndvështrimin e edukimit fetar, në fakultetet teologjike islame është dobësuar ndjeshëm mundësia e nxjerrjes së mësuesve kandidatë idealistë. Rritja e studentëve me vetëdijen “njeriu i kauzës”, siç thoshin të vjetrit, që duhet të kishin studentët e mësuesive si mision, është kaluar në plan të dytë dhe tashmë u jepet përparësi pritshmërisë akademike. Pasi, dituria është vetëdije, gjendje, edukatë e mirë dhe veprim.

MISIONI I MEDRESEVE DHE PËRGJEGJËSITË QË U BIEN PËRSIPËR BARTËSVE DHE SHËRBYESVE TË KËTJË MISIONI

Medresetë janë institucione origjinale në vendin tonë, që praktikojnë programe përgatitore për profesion të caktuar dhe për shkollë të lartë. Që në ditën kur janë krijuar deri në ditët e sotme, këto shkolla, të cilat janë një manifestim i tërësisë popull-shtet është dhënë një edukim i shëndetshëm fetar dhe janë praktikuar programe që synojnë t'u mësojnë fëmijëve besimin e duhur, diturinë e duhur dhe sjelljet e duhura. Si përfundim i këtij procesi, duke marrë si referencë dy burimet themelore të fesë islame, Kuranin dhe Sunetin, kanë dalë breza të tërë të kujdesshëm ndaj ekstremizmave, që kanë përbrendësuar vlerat etike dhe shpirtërore, që kanë vënë në plan të parë idealin e të qenit të dobishëm për njerëzimin, që u

1. Autori i shkrimit i referohet gjithmonë sistemit arsimor të medreseve (Imam Hatip Okullari/Liseleri) në Turqi. (përkthyesi)

japin përparësi kritereve njerëzore dhe islame dhe që kanë një mendim origjinal. Nga këto shkolla kanë dalë sa e sa liderë dhe breza shembullorë, që i kanë shërbyer vendit tonë dhe njerëzimit. Nga mesi i tyre kanë dalë njerëz që kanë kryesuar që të kuptohen dhe komentohen shkencat islame sipas nevojave të kohës sonë, dijetarë që kanë koncept mbi qytetërimin, hoxhallarë, që me fjalët e profesor Hajredin Kahramanit, njerëz që kanë vetëdijën e “ringjalljes dhe rindërtimit të qytetërimin tonë”; liderë të popullit tonë, biznesmenë, drejtues të të gjitha sferave dhe falë Zotit edhe kryeministri dhe presidenti i vendit kanë dalë po ashtu nga sistemi i medreseve të Turqisë.

Sot përballemi me një tjetër gjendje të edukimit fetar dhe të medreseve në vendin tonë. Sipas analizës që qeveria aktuale i ka bërë kërkesës së popullit tonë, jemi dëshmitarë të gjithë që populli ynë po i kthehet edukimit fetar, gjë e cila perceptohet si e drejtë e tyre, e parashikuar edhe në kushtetutë. Interesimi i jash-tëzakonshëm i popullit tonë ndaj cikleve 8/9-vjeçare dhe cikleve të mesme të medreseve, si dhe ndaj lëndëve me zgjedhje lidhur me Religionin, Etikën dhe Vlerat Islame të shkollave të tjera të përgjithshme, ka treguar se sa nevojë ndjejnë njerëzit tanë dhe se sa të interesuar janë ata ndaj një edukimi fetar të shëndetshëm. Tashmë, në vend që të flasim mbi kujtimet dhe problemet e së shkuarës, kemi arritur në një pikë që të bëjmë plane dhe projekte mbi edukimin e shëndetshëm fetar që duhet të marrin fëmijët. Ajo që bie si detyrë mbi prindërit e nxënësve është që të çojnë në medrese fëmijët e tyre që kanë vullnet për të mësuar, që këto shkolla të kenë përparësi për ta.

Sot medresetë nuk shikohen si fëmijë të njerikut. Por ato po ndërtohen sikurse shkollat e tjera, përmes mundësive shtetërore. Tashmë të njëjtat përpjekje të mundimshme që janë bërë në të shkuarën për ndërtimin e këtyre shkollave, duhen bërë gjithashtu mbi realizimin e projekteve origjinale për të rritur kualitetin, duhet rinovuar planet dhe programet mësimore dhe politikat arsimore, duhen planifikuar

veprimtari që rrisin njerëz që janë të dobishëm, aktivë, dinamikë dhe të drejtpërdrejtë dhe nuk duhet harxhuar energji dhe kohë me programe sallonesh të padobishme, si dhe duhet punuar në mënyrë intensive për të bartur me përgjegjshmëri amanetin e bartjes së emrit “medrese”.

Detyra më delikate bie mbi stafin mësimdhënës të medreseve, pasi atyre u janë lënë amanet breza të tërë. Një edukues që njuh periudhën në të cilën jeton, që njuh pritshmëritë e nxënësve, që vazhdimisht zhvillon veten për të rritur fëmijë duke i pajisur me ato çfarë kanë nevojë për kohën që fëmijët po rriten, ashtu siç e shpreh edhe sociologu i ndjerë Nuredin Topçu: “Rini! Dera që hyhet duke e menduar është vetëm dera e klasës. Besomëni që asnjë çlirim (fetih) në këtë botë nuk të jep më shumë nder sesa të hapësh derën e klasës”, kësisoj, “ai që hyn në klasë është sikurse të hyjë në derën e tempullit...”

Nxënësit tanë që mësojnë në medrese, duhet të qëndrojnë besnikë ndaj emrit që bart shkolla e tyre dhe ndaj sinqeritetit të atyre që kontribuan për medrese.




SHPRESA E SË ARDHMES: NXËNËSIT E MEDRESEVE

Nxënësit tanë që mësojnë në medrese, duhet të qëndrojnë besnikë ndaj emrit që bart shkolla e tyre dhe ndaj sinqeritetit të atyre që kontribuan për medrese. Nxënësit e medreseve duhet të mos jenë indiferentë ndaj botës që jetojnë, por të ftojnë në mirësi dhe mbarësi, të përpiqen t'i japin tërë botës zërin e fuqishëm të Islamit, me vetëdijën e të qenit lider, të bëjnë qëllim që të përcjellin mesazhin e paqes në zemrat e të gjithëve dhe të tregojnë që janë të rinj që përpiqen të edukohen si të rinjtë e së ardhmes. Pasi këta shpirta të

pastër e të çmuar, përfaqësojnë ata njerëz që do të shpjen më tutje kauzën e pejgamberëve.

Nxënësit e medreseve, krahas suksesit profesional dhe akademik nën dritën e Kuranit dhe Sunetit, janë nxënës që zhvillojnë veten e tyre edhe në fushat sociale, kulturore dhe artistike. Ata zhvillojnë karakterin e tyre bashkë me planifikimin e karrierës, pjekjen e personalitetit, me fjalët e të ndjerit profesor Sabahaddin Zaim-it: “ata janë të rinj në përpjekje për t'u bërë njerëz të mirë”.

Të analizosh periudhën e rinisë



Allahu i Madhëruar në Librin e Shenjtë ka thënë: **“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin engjëj të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato.”** (Tahrim, 6) Zoti kërkon nga ne që të ruajmë veten, pastaj bashkëshorten, pastaj fëmijët tanë nga sprovat e kohës. Ky synim kaq sublim realizohet vetëm atëherë kur mësohet siç duhet feja jonë, atëherë kur ka një edukim cilësor fetar. Detyra jonë primare është që të pajisim të rinjtë tanë me dijet e nevojshme përmes institucioneve të specializuara të edukimit fetar. Për të arritur këtë qëllim duhet që medoemos të hapen institucione që mësojnë Librin tonë të shenjtë dhe fenë tonë të bukur. Imam Rabbani, si një nga sufitë që kupton rëndësinë e çështjes në fjalë, tregon se mirësitë që bëhen në shërbim të njohjes dhe përhapjes së çështjeve islame (sher'i) janë më të rëndësishme se gjithçka tjetër. Ai e sqaron në këtë mënyrë:

Të shpenzosh me miliona florinj (para) në rrugën e Allahut nuk është e njëjtë me mbështetjen dhe përhapjen e njëres prej çështjeve islame. Pasi këtu bëhet fjalë që të mbështetësh dhe të bësh bashkëpunim me peygamberët, që janë më të virtytshmit e gjithësisë. Ajo çfarë dihet me siguri është që, megjithëse shpenzimi prej miliona florinjsh u ka takuar njerëzve të tjerë, jo peygamberëve, sevapet më të mëdha i kanë marrë peygamberët. (Letra e 48-të)


Megjithatë, nuk është aspak e lehtë ta kryesh me sukses këtë punë. Pasi mësimi dhe përhapja e shariatit është diçka që nuk e dëshiron nefs:

Të kryesh urdhrat e shariatit bie ndesh plotësisht me

nefsin. Pasi sheriati ka ardhur në kundërshtim me nefsin. Nganjëherë nefsi mund të pëlqejë shpenzimin e pasurisë. Të harxhosh pasuri me qëllim që të mbështetësh sheriatin dhe të përhapësh fenë është tregues i një shkalle të lartë shpirtërore. Të shpenzosh një argjend me këtë qëllim është njësoj sikurse të shpenzosh me mijëra florinj për qëllime të tjera. (Letra e 48-të)

Veçanërisht në kohën kur myslimanët dhe Islami ndodhen nën trysni, këto lloj institucioneve edukative pësojnë goditjen e parë dhe mbështetja që u duhet dhënë këtyre institucioneve në kohë të vështira është detyrë e secilit prej nesh. Miqtë e Zotit dhe njerëzit e tasavvufit, ngaqë kuptojnë rëndësinë e këtyre institucioneve, i kushtojnë vëmendjen e duhur edukimit fetar dhe bëjnë sakrificat të mëdha për të hapur institucione fetare ku mësohet Islami.

Nuk mund të ketë tasavvuf pa dituri, siç pandehin



disa. Në krye të të gjitha gjendjeve shpirtërore është njohja. Ndaj dhe Imam Rabbani motivon të gjithë besimtarët me në krye të rinjtë të mësojnë dituri:

Dituritë e këtij grupi (sufive) janë dituritë e gjendjes. Gjendjet janë përfundimi i veprave. Gjendja që është tek një njeri, është rezultati i diturive, është kryerja siç duhet dhe me meritë e veprave. Të kryesh detyrat siç duhet realizohet atëherë kur njëh veprat dhe kur di çdo veçori të veprave; kur njëh namazin, agjërimin dhe farzet e tjera, muamelat-in (marrëdhëniet mes njerëzve), nikahun, divorcin, dituritë e marrëdhënieve etj. Këto dituri arrihen duke u përpjekur dhe mësuar dhe askush nuk duhet të qëndrojë indiferent duke mos i mësuar ato. Edhe dituria ndodhet mes dy përpjekjeve: e para, përpjekja për të mësuar, para se të mësosh dituri. E dyta: përpjekja për të përdorur (vepruar) diturinë, pasi ta kesh mësuar. (Letra e 29-të.)

Ndonëse qëllimi i edukimit sufist është më shumë aplikimi i diturisë, por kjo gjë pikësisht është e varur nga njohja e urdhrave dhe ndalesave. Allahu i Madhëruar kërkon që kryefamiljarët të jenë të durueshëm gjatë procesit të kryerjes së urdhrave fetare dhe gjatë kohës së mësimit të tyre. Pasi kjo punë është një proces i gjatë që kërkon të jesh i durueshëm.

Fatkeqësisht sot shumica e kryefamiljarëve i kanë harruar këto përgjegjësi dhe mendojnë sikur janë përgjegjës vetëm për ushqyerjen e familjes. Ndërkohë furnizimi i njerëzve është një dhuratë pa shpërblim që u ka dhënë atyre Allahu i Madhëruar. Zoti i Madhëruar këtë çështje na e kujton në këtë mënyrë: **“Urdhëroje familjen tënde, që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë! Ne nuk të kërkojmë ty ndonjë ushqim: jemi Ne që të ushqejmë! Përfundimi i lumtur qëndron në frikën ndaj Allahut.”** (Taha, 132)

Ashtu siç janë duke u sprovuar prindërit lidhur me orientimin e fëmijëve drejt edukimit fetar, po ashtu edhe vetë të rinjtë janë duke u sprovuar në këtë pikë. Rinisë së sotme i është tërhequr mjaftueshëm vëmendja nga edukimi, pasi që në moshë të re ata fillojnë të

përballen me lloj-lloj vështirësish duke u përgatitur për universitet, për të gjetur vendin e tyre të punës, për të ardhmen. Ndërkaq, edukimi fetar është konsideruar si humbje kohe. Nefsi dhe shejtani urrejnë çdo lloj edukimi që njeriun e bën të afrohet më pranë Allahut:


Nefsi dhe shejtani, që janë kryearmiqtë e njeriut, gjatë periudhës së rinisë vijnë tek njeriu dhe merren me të. Në rini pak adhurim është i mjaftueshëm për t'u dalë në ballë me sukses atyre. Ndërkohë që ibadetet e bëra disa fish më tepër në pleqëri, ngaqë nuk ekziston një rrezikim i tillë nga nefsi dhe shejtani, është më pak i dobishëm se ai pak adhurim që bëhet në rini. Sipas rregullores së luftës, atëherë kur armiku sulmon dhe të rrethon, një lëvizje apo përpjekje sado e vogël e ushtarit është shumë e rëndësishme. Por një gjë e tillë nuk është aq e vlefshme në kohë paqeje apo atëherë kur është siguruar se nuk ka rrezik nga armiku.

Biri im! Njeriu, si esenca dhe thelbi i të gjitha krijesave, nuk është krijuar për argëtim, për lojëra, për të ngrënë e për të pirë apo për të fjetur. Por është krijuar për të kryer detyrën si rob i Zotit, duke adhuruar Zotin, duke treguar thjeshtësi, duke rrëfyer paaftësinë, duke u mbështetur tek Ai dhe duke iu përgjyruar Atij... (Letra e 73-të, v. I)

Në këtë kohë kur argëtimi dhe lojërat ndikojnë në jetën e të rinjve, të respektosh këtë thirrje, me sa duket është më e vështirë sesa dikur. Porse, ashtu siç shprehet edhe Imam Rabbani, shpërblimi që merret për shërbim ndaj Islamit në kohë të vështira është shumë më i madh sesa çdo herë tjetër.

Si përfundim, nuk janë vetëm të mëdhenjtë ata që kalojnë këtë sprovë, njëkohësisht janë të gjithë të rinjtë që kanë hyrë në periudhën e pjekurisë që përballen me sprovë të ndryshme. Në këtë kontekst, përgjigja që i jep Aliu Muhamedit (a.s.), duke i besuar, duhet të na hapë sytë e veshët që të gjithëve. Pejgamberi i nderuar (a.s.), kishte ftuar në Islam djalin e vogël të xhaxhait, Aliun dhe i kishte rekomanduar që të konsultohet me të atin, Ebu Talibin për këtë çështje. Aliu, duke qenë aq i vogël në moshë, i pati kthyer këtë përgjigje kaq të urtë: “Kur Allahu më krijoi mua, mos vallë u konsultua me të?! Atëherë pse vallë të konsultohem unë me babain për t'i besuar apo mos i besuar Zotit?!”

Allahu i Madhëruar u dhëntë suksese në këtë sprovë të madhe, si të rinjve, ashtu edhe të rriturve. Ndërkohë që marrim përsipër sprovë kaq të mundimshme në këtë botë të shkurtër, Zoti na ruajtë nga përtesa dhe ngadalësia për t'u përgatitur për botën tjetër të përjetshme. Amin!





GËRRYERJA NJERËZORE përkundruall parimeve parake

.....
❧ *Nuredin Nazarko* ❧
.....

Sot ne e konsiderojmë jetën si një fakt të rëndomtë, madje aq të rëndomtë saqë vëmendja jonë është tërësisht e përqendruar në përmirësimin e kushteve të jetës, përmirësimin e standardeve të jetës, por jo dhe në kuptimin e jetës. Ne jetojmë, lindim dhe vdesim, punojmë dhe ushqehemi, sigurojmë komoditete, harxhojmë të ashtuquajturën kohë të lirë në argëtime të tipit, “shtyjmë kohën”. Jemi kaq të zënë dhe e kemi kohën kaq të mbushur me veprimtaritë e përditshme, saqë pothuajse nuk e hetojmë fare, sesi rrëshaqasin me hov ditët, javët, muajt, vitet, dekadat. Madje, edhe kur kemi mbërritur pranë fundit të udhëtimit (gjithsesi gjithmonë jemi një frymëmarrje pranë), mendojmë se çfarë trashëgimie materiale do t’iu adresojmë

pasardhësve. Të përfshirë kokë e këmbë me kësilloj përfytytrimesh, vështirë të besosh se përgjatë jetës, jemi shqetësuar për ndonjë gjë tjetër veç komoditetit. Të përfshirë nga ky shqetësim, thelbësor për shumë syresh, është lënë jashtë vëmendjes, jashtë sferës së interesit çështja e rëndësishme e rolit të parimeve parake në jetën e njeriut.

Çështja e njohjes, pranimit dhe ndjekjes së parimeve parake nuk është nga ato çështje të cilat mund të lihen në harresë, pasi që këto parime janë shenjuese të vetë kuptimit të jetës, kuptim i cili, për njeriun bashkëkohor duket të jetë më i vështirë se kurrë. Edhe përkaj rëndësisë së tyre në jetën e njeriut, njeriu bashkëkohor ka vendosur të hapërojë në një

rrugë diametralisht të kundërt me atë çfarë shenjojnë këto parime, dhe rrjedhimisht janë lënë jashtë kujtesës, përderisa nuk janë bashkëudhëtarët e pandashëm të qenies njerëzore në përkohësi. Edhe pse shpeshherë mund të dëgjojë, mund të shohë modele të gjalla të jetësimit të këtyre parimeve, indiferenca dhe pavëmendshmëria që e shoqëron njeriun bashkëkohor ndaj gjithësa joshqisore, e sjell në gjendjen e mosreflektimit rreth asaj që e përqarkëson, duke i cilësuar ngjarjet me origjinë parake, legjenda të hershme, gjëra pa logjikë, gjëra që një njeri me mend nuk mund t'i besojë. Ky dyshim mohues nuk mund të jetë gjë tjetër përveç se prodhim i disa faktorëve, të cilët rrënjëzohen nga thelbi i humanizmit. Vetë ky i fundit është propoganduar masivisht si rikthyesi i legjitimitetit të dinjitetit njerëzor, që mesjeta e kishte varrosur në errësirën e saj.

Duke e kthyer perceptimin e botës dhe njeriut, si të qenësishëm vetëm nëpërmjet optikës humaniste, çdo këndvështrim tjetër jashtë kësaj sfare do të delegjitimohej, derisa sita e optikës humaniste ta saktësonte si një element, që edhe mund të merret në konsideratë. Por ky lloj vlerësimi nuk vlente për vetë optikën humaniste, pasi që ajo tashmë besohet si aksiomatike. Ky aksiomatizim i optikës humaniste, derivoi deri në përskaaj, aq sa nuk i lejonte askujt që binte në kontakt me të, të mendonte mbi parimet parake, pasi që këto parime ishin përcaktuar si gjeneratorë të rënies së njeriut në pozita nënshtruese dhe skllavëruese ndaj botëkuptimit mesjetar. Ky atakim, i qartë dhe i hapur ndaj parimeve parake nuk mund të konsiderohej i pashkak, por dhe i paqëllimtë gjithashtu.

Forca e superioritetit të kësaj optike, u përzgjedh të jetë kryekëput dimension i material, brenda të cilit gjëlojnë shumëllojshmëri mënyrash për të shijuar jetën, sikundërse pretendon kjo optikë. Gërshetimi dhe ndërthurja e thellë midis aspektit ideor të optikës humaniste dhe arritjeve materiale të prekshme nga pikpamja shqisore, e ndezulluan njeriun humanist, sa që parimet parake tashmë nuk mund të konsideroheshin vetëm pjesë e sferës së legjendave të hershme, por një rigjallërim i tyre do të ishte një mallkim dhe një rrezik evident për vetë optikën humaniste. Për të mos lejuar këtë, optika humaniste i rrethoi parimet parake me një sërë mjegullnajash, me ngjyra nga më të errëtat, me shpifje nga më të ndryshmet, me akuza nga më të ultat, vetëm e vetëm që në sytë e njerëzve autoriteti i parimeve parake të goditej paqshëm, të gërryhej qenësishëm, dhe në të njëjtën kohë vetveten e rrethoi me lëvdata, kurora triumfaliste, me ngjyra nga më të ndezurat, në mënyrë që në sytë

e njerëzve të dukej si këndvështrimi i shpresës dhe i mirëqënuri për të zbërthyer ngjyrat e jetës. Duke ndjekur këmbëngultazi këtë linjë të ecuri, ngriti në pedestal autoritativ atë që duhet të ishte njohës dhe ndjekës i parimeve parake.

Pamja e përmbysur e parimeve parake ofruar nga optika humaniste, krijoi një ushtri të tërë syresh që nuk dëshironin të braktisnin shumëllojshmërinë e ngjyrave jetësore spërkatur me esenca humaniste, përballë ngjyrave të errëta apo të zbehta të parimeve parake, ngjyra të cilat ishin thjesht stisje, për të legjitimuar logjikën e optikës humaniste.

Kësisoj, një lukuni e tërë syresh, me apo pa dëshirë, u nënshtrua më në fund përpara logjikës së optikës humaniste, duke shpërfillur paq vlerat dhe rëndësinë e parimeve parake në qëndrueshmërinë dhe paqtimin e jetës së njeriut. Ky nënshtrim, sollti pashmangshmërisht fuqizimin e gërryerjes së njerëzores tek njeriu, duke sjellë në skenën e zhvillimeve njeriun që përpiqet të jetë Zot dhe që në marshimin për të arritur këtë, është i gatshëm të shtypë dhe asgjësojë çdokënd dhe çdogjë që është apo kthehet pengesë për këtë marshim. Rrjedhimisht, parimet parake dhe virtyte që rrjedhin prej tyre si mëshira, dashuria, keqardhja, thjeshtësia, sakrifica për të mirën, i lëshuan vendin akullzimit, ashpërsisë, brutalitetit, përçmimit, mendjemadhësisë. Tashmë, njeriu i ri, u gatua. Ai nuk ngurron ta shfaqë veten kudo dhe kurdo, nuk ngurron aspak të jetë në anën e negatives, madje shpesh këtë e shpreh edhe me mburrje, duke u krenuar me të keqen, duke përçmuar dhe cilësuar të marrë, të çmendur ata që sakrificën më sublime kanë nënshtrimin e vetvetes me përlulje ndaj parimeve parake, për të fituar statusin qenie njerëzore. Dhe t'i shpëtosh gërryerjes së njerëzores tek njeriu është sot sfida më torturuese, sidomos kur kjo gërryerje mbështetet nga 1001 instrumente.

A duhet të ndihen të shqetësuar ata që kërkojnë të ruajnë të paprekur njerëzoren duke u strehuar tek parimet parake?

Është e natyrshme që duhet të jenë të shqetësuar, pasi që njeriu është i paparashikueshëm, por nuk do të ketë vend për panik, nëse sinqeriteti i zemrës është gurthemeli fillestar i ndërtimit të jetës, që përnjështohet me atë çfarë parimet parake kërkojnë nga njeriu, që të mbetet njeri dhe rrjedhimisht të ketë fatin e madh të kthehet i ngazëllyer në shtëpinë e tij të parëhershme.



Nostalgjia është njohje

Edison Çeraj

Gjithnjë më ka interesuar të kthehem e të rikthehem nëpër vende dhe objekte të braktisura, për të “koleksionuar” ato “frymë të vdekura” dhe gjurmët e tyre në entropi e sipër. Janë gjurmë që komunikojnë pa folur, çdonjëra me historinë e vet. Të turpshme si petalet në ag. Të heshtura si hija e një lisi.

Edhe ajri në të tilla vende është tjetër nga ai i zakonshmi që thithim çdo çast; një ajër për të cilin nuk mund të thuash se ka mbetur pezull,

por mbase nuk qarkullon normalisht dhe si i tillë depërton më shumë, më thellë; i njej poret tona më mirë se çdo aromë; ajër që shkruan pashirra mbi lëkurë.

Edhe koha madje është një befasi më vete në këto vende: sikur i ka braktisur, sikur ka mbetur pezull, por edhe sikur u rikthehet beftë duke lënë ndonjë shenjë në kufijtë e të mistershmes. Nuk e shquan dot këtë kufi. Ai shënon kalimet tona nga faza në fazë, nga gjendja në gjendje.

Është e vërtetë se kur i rikthehesh një vendi të tillë pas një kohe pak a shumë të gjatë, çdo gjë të duket më e vogël, por ky është vetëm përjetimi i parë, pasi më pas je ti ai/ajo që zvogëlohesh e pështjellohesh njëkohësisht nën peshën e kujtimeve. Kujtime të papërballueshme, që afrohen nga nuk e di se ku e mandej ikin sërishmi; që afrohen për të mbjellë një farë, duke të vënë në provë se a do kujdesesh që ajo farë të mbijë. Ti ke frikë nga ajo çfarë do mbijë. Ndihehesh i pasigurt. Dija nuk të shërben aspak në këtë pështjellim. Mos e përdor dijen, se pështjellimi shndërrohet në makth.

Mund të dëgjohen zëra apo fjalë në ajrin enigmatik, dhe kjo varet nga forca e dëgjimit pa veshë. Veshët nuk bëjnë punë, madje mund të të shkëpusin. Prandaj, veshët janë një mundësi daljeje për atë që nuk rri dot në këto ambiente.

“Kujtesa për gjërat e së shkuarës nuk është e rëndësishme të jetë kujtesë për gjërat siç kanë qenë.” (Proust)

Është peshë kjo gjendje; e atillë sa nuk e mban dot për gjatë, përpos disa çasteve, të cilat e shpluhurosën me aq vrull Tjetrin brenda nesh, deri në atë pikë sa pothuaj mezi e njohim. Këtu është rasti të krahasojmë Tjetrin e dikurshëm me veten e tanishme: çfarë kemi humbur e çfarë kemi fituar; cilët ishim e cilët jemi; sa peshonte bota brenda nesh e sa peshon tani; si ka ndryshuar afrimiteti me njerëzit; po buzëqeshja, po çiltërsia, si dhe shumë pikëpyetje të tjera.

Sikur të arrihej të shprehej me fjalë një gjendje e tillë, do ishte rrëfimi më tronditës, dhe si i tillë i papërballueshëm. Mbase pikërisht për këtë nuk është e mundur të kyçet në fjalë kjo gjendje.

Me gjasë, ka shumë vepra letrare që kanë marrë shkas nga kjo flakë e brendshme, por ato mbeten vetëm shkëndijat e saj dhe përsëri ia dalin të na ndriçojnë, por duke na mbërthyer.

Ndonjëherë duket sikur nostalgjia është kryeshkaku i letërsisë dhe i artit në tërësi, që si fillim përvijohet brenda autorit si nostalgji në lidhje me diçka konkrete, domethënë, të identifikueshme;

por, në thelb, arti mbetet nostalgji për diçka që e kapërcen konkretin e identifikueshëm; nostalgji për diçka që kemi humbur, që lidhet me rëniën apo me flakjen e njeriut në ekzistencë. Duke pasur parasysh këtë, mund të thuhet se arti është një rikthim i përhershëm.

Diçka të kësaj natyre shpjegon edhe Kundera: “Në greqishten klasike, “rikthimi” shënjohej me fjalën *nostos*. *Algos* nënkupton “vuajtje”. Kështu, nostalgjia është një vuajtje e shkaktuar nga një dëshirë e zjarrtë e paqetuar për rikthim.”

Ndërsa, nëse do parafrazonim Camus-në, mund të themi se çdo akt artistik shpreh nostalgjinë për pafajësinë dhe përbën një apel për thelbin e qenies.

Arti mund të merret pikërisht si një apel për thelbin e qenies, thelb i cili ndodhet vazhdimisht nën trysinë e botës ku ka rënë. Me dhjetëra e qindra shtresa e mbulojnë atë në këtë udhëtim në botë. Pra kërcënohet pa pushim nga harresa. Ja përse arti është kujtesë: se njeriu nuk është një mundim i kotë, se ai është i mundur, por jo këtu dhe tani, sepse nostalgjia nuk shuhet asnjëherë as këtu e as tani. Secili ka “prova” për këtë. Kujtesë se fjalët, pamjet dhe tingujt janë një përvojë krejt e ndryshme nga përvojat e zakonshme, duke qenë se shënjojnë një tjetër botë. Kujtesë se hëna për të cilën flasin astronautët është krejt tjetër nga ajo që përshkruajnë poetët. Kujtesë se njeriu është më shumë nga sa flasin të gjitha shkencat e marra së bashku. Kujtesë...

Në sajë të nostalgjisë për atë që kemi humbur, kemi edhe nostalgjitë konkrete, që na shoqërojnë aq shpesh, të cilat lidhen me njerëz, vende, ngjarje ose sende të caktuara. Kjo do të thotë se këto nostalgji kanë kuptim e përjetim përtëritës për aq sa na lidhin me burimin, në të kundërt ato bëhen të papërballueshme.

Në vend që ta sfidojmë veten, është më mirë të shtojmë përpjekjet për ta njohur atë. Nostalgjia është një portë e hapur drejt kësaj njohjeje.





Letër NËNËS

Neslihan Nur Turk

*Nuk mjafton ta lindësh, fëmijën ta sjellësh në jetë,
mos ia beso të tjerëve, edukoje vetë!*

Të moçmit thonë shpesh: “Dikur mjaftonte t’i shihnim në sy fëmijët dhe ata e kuptonin se ç’donim të thoshim”. Kurse tani ne habitemi me mosbindjen dhe mosrespektin që shprehin të rinjtë e sotëm. Nëpërmjet kësaj letre do të përpiqemi të bëjmë dallimin mes nënave të dikurshme dhe atyre të sotme.

O nënë e shtrenjtë, që nën këmbët e tua është shtrirë tërë Xheneti!

Edukimi i karakterit tek fëmijët fillon që me përpjekjen që bëjnë vetë prindërit për të përmirësuar karakterin e tyre. Ndihma më e mirë që mund t’i jepni fëmijës suaj, që para se të bjerë në mitrën e nënës, është të pajisni veten tuaj shpirtërisht dhe të keni synime që ju bëjnë të afroheni më pranë Allahut. Tani, le t’i lexojmë dhe t’i përbrendësojmë për hir të Zotit rreshtat poshtë:

Dikur nënat krahas pesë vakteve, falnin edhe namaze nafile, merrnin abdest, përveshnin mëngët dhe nën shoqërinë e duasë së tahijjatu-s dhe salavateve përgatisnin brumin. Me këtë brumë piqnin bukën që do të hante familja, madje dhe shpërndanin prej saj fqinjëve dhe të afërmve. Jo vetëm njerëzit, por edhe qentë apo macet që ndjenin aromën e bukës, arrinin të përfitonin nga kjo bukë. Kështu, begatia nuk mungonte në shtëpi.

Po tani? Buka është gati, keku po ashtu, si dhe byreku. Xhepat tashmë kanë para dhe gratë marifetin e tyre e shprehin pikësëpari duke u furnizuar nga dyqanet dhe marketet. Koshat në markete mbushen me ushqime që shumica e tyre janë të pashëndetshme dhe

të dyshimta. Tashmë është shtuar numri i zonjave të shtëpive që mysafirët i presin me ushqime të përgatitura nga jashtë, duke telefonuar picerinë apo duke i ftuar miqtë në restorant dhe jo duke ua përgatitur vetë ushqimet. Sot shumë nëna nuk kanë kohë të bëjnë brumin e bukës, të bëjnë gjellë, të nxënë kosin... Rrobat dhe enët tashmë i lajnë makineritë; mirëpo sërish janë shumë të zëna. Fëmijët ushqehen me po ato ushqime të gatshme. Fëmijët rriten duke pirë lëngje frutash nëpër kuti, koka-kola dhe çaj të ftohtë dhe nuk ushqehen me produkte natyrale; komposto, hoshaf apo dhallë. Për arsye se sofrat për mysafirë shtrohen me qëllimin për të rënë në sy, ndaj dhe janë shtuar të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe është pakësuar sinqeriteti. Era e mishit në mangall është përhapur kudo; mirëpo nuk arrijnë të marrin atë që u takon atyre që u shkon era e mishit në hundë. Iku begatia.

Dikur nënat merrnin copën e kumashit në dorë, e prinin me bismilah dhe i qepnin vetë rrobat e veta. Veshjet e vogëlushëve, perdet e shtëpisë, mbulesat e divaneve, të gjitha këto ishin produkt i duarve të tyre të arta. Kështu, edhe ishin më të kursyer edhe ia dinin më shumë vlerën. Qepnin, qëndisnin dhe thurnin vetë dhe ua mësonin vajzave të tyre. Ata fëmijë që kanë shijuar vetë se si prodhohet, kultivohet, ndërtohet vetë diçka, nuk mund të bëhen prej atyre që presin gjithçka të gatshme. Të atëhershmit dinin punë artizanale aq sa të nxirrnin të ardhura të paktën sa t’u mjaftonte për veten e tyre. Rrobat e shqepura i qepnin me duart e veta dhe, nëse

ishte e nevojshme edhe i arnonin vetë.

Po tani? Fundi është gati, bluza gati, fustani gati. Xhepat tashmë kanë para dhe gratë menjëherë u drejtohen qendrave tregtare. Ç'nevojë ka që të merremi edhe me këtë punë! Duke qenë gjithçka gati. Tashmë nënat po arrijnë të kenë në duar gjëra pa shumë mundim, po e arrijnë rahmetin pa zahmet. Është shqepur? As që ka nevojë të merresh me të. Hidhen në kosha çorape, ndonëse vetëm maja e tyre është hapur pakëz. Trikoja që i është zbehur pak ngjyra, tashmë nuk përdoret. Fëmijët që janë rritur duke blerë thujse çdo javë nga një rrobë, bëhen të paepur ndaj dëshirave të tyre dhe s' dinë si ta komandojnë kapriçon e tyre. Edhe tubimet fetare madje janë kthyer në pasarella veshjesh. Tashmë janë shtuar gra të fiksuara për të ndryshuar mobilitet çdo vit dhe për të ndryshuar shamitë e kokës me dy të përdorura. Fëmijët janë rritur në ambiente pa gjilpërë e pa shtiza.

Dikur, të ishe nënë, ishte ideali kryesor i çdo femre. Femra dikur dëshironte që të kishte një vello të bardhë, një shtëpi ku të fuste kokën dhe të kalonte jetën e pastër dhe mezi ç'prisnin që të bëheshin nëna. Burri punonte dhe fitonte nga hallalli dhe gruaja vetëmjaftohej dhe ishte gjithmonë mirënjohëse ndaj gjendjes. Nënata dikur edhe kur ushqenin fëmijën me gji, e ushqenin me vetëdijen e ibadetit.

Po tani? Ndërkohë që mendon se do të arsimohesh, do të bësh karrierë, do të fitosh lirinë ekonomike, vitet shkuan tek tridhjeta, tek dyzeta. Nënata e reja, shpeshherë i këshillojnë vajzat e tyre, në këtë mënyrë: “Mos shih xhepin e burrit! Ki profesionin tënd, ki rrogën tënde. Nëse të mërzi, iki, eja tek unë, do të më kesh mua pranë teje.” Kështu janë vajzat, nëse u mësohet të jenë të padurueshme dhe egoiste, atëherë vërtet është e vështirë t'u gjenden burra të përshtatshëm për to, që të mund t'u përgjigjen nevojave të tyre dhe që të tolerohen tekta e tyre. Fëmijët që janë mësuar me ushqim të gatshëm, me rrobat të gjetura gati dhe me një jetë egocentriste, ndonëse janë të rritur në moshë, ata kanë mbetur ende të vegjël. Vendi ynë është mbushur me djem dhe vajza që nuk duan të marrin përsipër përgjegjësinë e martesës. U është paraqitur sikur të qenit nënë është një pengesë për të qenë e lirë. Të jesh me një fëmijë konsiderohet qytetërim dhe të kesh shumë fëmijë konsiderohet prapambetje. Janë pikërisht disa prej atyre nënave që thërassin: “Dua të jetoj jetën time!”, ato që i marrin shpirtin me duart e tyre fëmijës që sapa i është dhënë shpirti. Ato nuk ushqejnë me gji fëmijën, sepse kështu mund t'u prishen linjat fizike.

Dikur nënat respektonin burrat e tyre. Nuk iu drejtonin thjesht duke i thënë: “Burrë!”, por “Zotëri!” apo “Efendi!” Kështu burrat vërtet e ndjenin veten si zotëri. Edhe fëmijët respektonin baballarët e tyre. Së bashku u bënë ballë sa e sa shqetësimeve dhe vështirësive, jetonin duke bërë durim, ndërmjet tyre kishte respekt dhe dashuri, ndaj dhe ishin njerëz të qetë. Edukata

mbretëronte kudo, në derë, në sofër, në bahçe, në dhomë... Dikur nënat ishin nënat e fëmijëve. Fëmijëve nuk u drejtonin “Hë, mami!”, por “biri im!”.

Po tani? Me botëkuptimin e arsimit përmes tolerancës, nënat mbështesin bijat e tyre në përpjekje për t'u bërë të veçanta dhe moderne. Në një farë forme, bëhen bashkëfajtores. Punët që Kurani dhe Suneti nuk i pëlqejnë, justifikohen me fjalë “vajza ime është ende e vogël!” Fëmijët tashmë e mësojnë nga nënat e tyre veshjen firmato, bisedimet në internet, shkëputjen nga shoqëria me telefon në dorë. Të thuash “Aman mor baba!”, është kthyer në një qëndrim i fëmijëve, i mësuar nga nënat e tyre. Nga nënat që lënë mangët respektin ndaj bashkëshortit, dalin fëmijë të paedukatë. Tashmë erdhën kohë që njerëzit nuk durojnë dot njëri – tjetrin dhe për bajrame tashmë nuk vizitojmë të afërmit, por vizitojmë lokalet e restorantet.


Dikur nënat me ditë të tëra vuanin dhe ashtu e lindnin fëmijën e tyre. Edhe fëmijët që lindnin ishin të durueshëm, guximtarë dhe punëtorë. Dikur nënat e fshihnin mirë barkun e tyre, aq sa as pjesëtarët e familjes nuk e dinin se ishte shtatzënë.

Po tani? Është shtuar çezariani, janë shtuar vuajtjet artificiale, madje është krijuar një sistem që quhet shtatzëni pa dhimbje. Ata që nuk morën përsipër pakëz zahmet, iu iku rahmeti i përhershëm. Nga nënat që nuk mund t'i përballojnë dhimbjet kanë dalë breza që u pëlqen rehatia dhe që vetëm shikojnë se ç'është e gatshme. Për shkak të metodave të lindjes që preferohen vetëm për hir të rehatisë, trupi i tyre u bë një depo ilaçesh. Ndaj dhe është shtuar numri i fëmijëve të palumtur që kur kanë lindur, nëna të palumtura që kur kanë bërë lindjen. U pakësua turpi dhe kujdesi ndaj nderit. Dadoja e re e fëmijëve u bë televizori dhe interneti.

Tani ne do të përmendim nënat e dikurshme dhe të rrimë kështu ulur, këmbëkryq? Apo duhet t'i japim vetes dhe të përpiqemi për lumturinë e dy botëve të vetes sonë dhe të trashëgimtarëve tanë, duke u bërë një nga ato nënat e dikurshme, të pavjetëruara aspak?

Kujdes! Edukimi fillon me kafshatën prej hallalli, vazhdon me zbulimin dhe zhvillimin e direktivave të jetës, kurorëzohet me një jetë të përshtatshme me natyrshmërinë hyjnore dhe ndriçohet me respektin, durimin dhe edukatën.

Ndërkohë që po i japim fund letrës sonë, sa mirë do të ishte që ta varnim vath në vesh thënien: **“Nuk mjafton ta lindësh, fëmijën ta sjellësh në jetë, mos i a beso të tjerëve, edukoje vetë!”** Kushedi, ndoshta na bëhet risk që të ndikojmë tek të tjerët me një shikim, ashtu si nënat e dikurshme.



Nokta-i SUVEJDA

Prof. dr. Et'hem Xhebexhiollu

Sikur t'u hedhin një sy burimeve të periudhës së hershme të Tasavvufit, do të vërehet se fatkeqësisht nuk ka ndonjë informacion të gjerë rreth Nokta-i suvejda-së.¹

Unë, brenda mundësive të mia modeste, po përpiqem të shtjelloj duke mbledhur ato pjesëza të dhë-nash që gjenden andej e këndeje.

Në këtë artikull do të përpiqemi të analizojmë nën dy tituj mendimet e të nderuarit Ibrahim Hakki Erzurumit mbi “**Nokta-i suvejda**”.

NOKTA-I SUVEJDA, SI NJË REAGIM I ZEMRËS

I nderuari Ibrahim Hakkiu (k.s.), në veprën e tij Marifetname, cek nokta-i suvejda-në e zemrës.³ Pa dyshim që çdo njeri, potencialisht bart të vërtetën njerëzore, përtej kohës dhe hapësirës. Ndonjëri e shfaq këtë potencial përmes sejri suluk-ut, pra edukimit sufist dhe ndërkohë që bëhet **Insan** (Njeri i ndriçuar) ndonjëri mundet që të mos e kinetizojë, që do të thotë se mundet që të mos arrijë dot ta nxjerrë në pah “humanitetin” e tij, të vërtetën e tij njerëzore, jeton si i vdekur, jeton pa lindur për së dyti dhe vdes mbi të njëjtën gjendje, porsì një zemër e vdekur.

I nderuari Ibrahim Hakkiu (k.s.), duke u bazuar në hadithin: “*Ekziston një copë mishi në trupin e njeriut, që kur ajo është mirë, i gjithë trupi është shëndosh*

e mirë. Kur ajo është e prishur, i gjithë trupi është i prishur. Vini re! Ajo është zemra!”⁴, bën këtë konstatim:

Kjo do të thotë që rregullimi i zemrës është më primar dhe më i rëndësishëm se gjithçka tjetër. Pasi zemra është mbretëresha, së cilës të gjithë organet e tjera i binden dhe i shërbejnë. Nëse zemrës i hiqen veset e këqija dhe nëse pajiset me veçori të mira, atëherë arrin shëndetin e vërtetë. Thënë më shkqitur, shpëtimi i vërtetë arrihet atëherë kur u bindemi fjalëve, sjelljeve dhe edukatës së Pejgamberit (a.s.).⁵

Zemra e ringjallur manifeston humanitetin që gjendet në mënyrë të natyrshme brenda secilit dhe si rrjedhojë është zemër e hapur ndaj humanizmit.

I nderuari i ndjerë Sami Efendiu (k.s.), lidhur me këtë çështje theksonte këtë fakt:

“Hyni në varr si njerëz. Ne ju japin këto mësi-me shpirtërore, me qëllim që të fitoni përjetësinë. Pasi, ata që janë njerëz të vërtetë nuk vdesin, pra ashikët!..”⁶

I nderuari Ibrahim Hakkiu (k.s.), nokta-i suvejda-në e vendos në zenitin e “humanizmit”.

Mirëpo, para së gjithash, *veled-i kalb* duhet të vijë në këtë botë, pra *fëmija zemër*, duhet të çajë vezën e vet dhe të dalë. Këtë proces ai e quan lindja e dytë.

Sipas tij, zemra e njeriut, kur bashkohet me *ruh-i*

*izaf*⁷, arrin në jetën e përhershme, kështu, duke kaluar të gjithë stadet, *hajavan* dhe *melek* (të ulëta dhe sublime) për t'u bërë *insan-i kamil* (njeriu absolut/përsosur). Pra, "insan/njeri".⁸

Dhe vazhdon në këtë mënyrë, i nderuari Ibrahim Hakkiu (k.s.):

Ndaj dhe Isai (a.s.), ka thënë: "Asnjeri nuk mund të hyjë në *melekat*, në qiej dhe në shoqërinë e engjëjve, pa lindur dy herësh!"⁹

Lindja e parë për të cilën e ka fjalën Isai (a.s.), është ardhja jote në këtë botë nga mitra e nënës. Pra, shpëtimi nga ajo ngushticë dhe errësirë e barkut të nënës. Është pastrimi yt nga ato ujërat e gjakosura të barkut të nënës dhe zënia e një vendi të posaçëm në botën materiale. Është lindja jote, i pajisur me ndjenja dhe fuqi të caktuara.

Kurse lindja e dytë, për të cilën bën fjalë është pastrimi nga veçoritë e ulëta (*hajavani*) dhe të shëmtuara. Është fitimi i veçorisë së *meleku*/engjëllit, përmes pastrimit shpirtëror, duke shpëtuar nga errësirat dhe turbullimet. Kështu hyhet në botën e zemrës dhe kështu gjen rrugë drejt afinitetit me Zotin. Kësaj, në atë botë shpirtërore, vëren nivelet e zemrës duke qenë një njeri i zemrës. Arrin të ftohesh, porsai Musai (a.s.), duke u pjekur në *atvar-i seb'a*, pra në shtatë gjendjet dhe stadet e zemrës.¹⁰

Pikërisht këtu Ibrahim Hakkiu me atë *fëmijën zemër* që ka ardhur në këtë botë, kupton që kalon nga shtatë stadet e pjekurisë së zemrës; foshnjëria, fëmijëria, adoleshënca, rinia, mosha mesatare, pleqëria dhe nokta-i suvejda, pra vdekja. Stadi të fundit të këtyre i vendos emrin "**ama**" (reja e errët), nokta-i suvejda, pra të vdesësh para se të vdesësh, që kësaj i thotë "siddikjet".¹¹

Resulullahu (a.s.), pati thënë: "Ai që dëshiron të shohë ndonjë të vdekur para se të vdesë, le të shohë Ebu Bekir Siddik-un."¹²

I nderuari Ibrahim Hakki Erzurumi (k.s.), përpiket të kërkojë shtatë gjendje/stade për zemrën dhe pastaj e shpjegon në këtë mënyrë zhvillimin e zemrës deri tek nokta-i suvejda. Dhe secilës gjendje ia vendos emrin stad.

1. Ibrahim Hakkiu (k.s.), thotë që në gjendjen/stadin e parë të zemrës bëhesh "mu'min" (besimtar), atëherë kur përdor mendjen dhe arrin të dallosh të vërtetën nga e shtrembra. Pra, sipas tij, gjendja më primitive, më e përgjithshme dhe më gjithëpërfshirëse është stadi i imanit.¹³ Pra, këtu zemra nis rrugëtimin.

2. Stadi i dytë është **sadrul-kalb**. Në këtë stad tek

njerëzit që meditojnë krijohet kënaqësia *sherh-i sadr/inshirah-i sadr*.¹⁴ Pra, ky nivel është gjendja e ndriçimit të të fshehtave të marifetit hyjnor në zemër dhe e shijimit të kënaqësisë dhe entuziazmit nga meditimi (tefekkur).¹⁵


3. Stadi i tretë i zemrës është **hubbetul-kalb**. Kur zemra arrin në këtë formë të pjekurisë, harron mërzitjen dhe gëzimin, fluturon sipas dëshirave të botës shpirtërore, kapërcen hapësirat. Pra, është neutral si ndaj gëzimit ashtu edhe ndaj mërzitjes. Në Kuran, ajeti: "(Këtë paracaktim e kemi bërë) **që ju të mos dëshpëroheni për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë**".¹⁶ tregon për këtë nivel të stadi neutral të zemrës.

4. Stadi i katërt i zemrës është **muhxhetul-kalb**.¹⁷ Pra është shpirti i zemrës. Zemra në këtë stad arrin të shquajë manifestimin *xhemali* që vjen nga Allahu me manifestimin *xhelali* që vjen nga nefsi.¹⁸

5. Stadi i pestë i zemrës është "**shegaf**".¹⁹ Në këtë stad, Zoti të merr nga vetja jote, të shpëton nga dashuria e kësaj bote, arrin në gjendje që të qeshësh pak: urdhri në ajetin "**...qeshni pak e qani shumë...**"²⁰ tregon pikërisht këtë stad.

6. Zemra në këtë stad merr emrin "**fuad**".²¹ Në këtë gjendje, në zemër nga Rahmani rrjedhin *varidat* dhe shpëton nga cytjet e nefsit, si dhe meriton *xhemal*-in. Atëherë realizohet: **Thuj:** "**Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve...nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt) e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve...**"²²), që gjendet në ajetin kuranor dhe kjo zemër meriton *xhemal*-in.

7. E shtata është "**Suvejda**". Pra, pika e errët. Nëse arrin në këtë stad, bëhesh prej *siddik-ëve*²⁴ me vërtetësi dhe besnikëri. Zemra të bëhet pasqyra e *xhemal*-it dhe vendshikimi i Zotit. Mbushesh me nur, me prehje, me lumturi. Pikërisht këtu, i nderuari Ibrahim Hakki Erzurumi (k.s.), bën shpjegimin më të rëndësishëm të *nokta-i suvejda*-së, këtu njeriu



Rregullimi
i zemrës është
më primar dhe më i
rëndësishëm se
gjithëcka tjetër. Pasi zemra
është mbretëresha,
së cilës të gjithë organete tjera
i binden dhe i shërbejnë.
Nëse zemrës i hiqen veset
e këqija dhe nëse pajiset me
veçori të mira, atëherë
arrin shëndetin
e vërtetë.

arrin në gjendje **“la zamani ve la mekani”**, pra përtej kohës dhe hapësirës, ashtu sikurse sufistët e tjerë. Sipas tij, përtej kësaj *suvejda*-së, lartësohesh në renë e zezë, **sema-ji ama**²⁶, në qiellin më të lartë, në atë qiell ku nuk ka ajër as poshtë e as lart. Në prani të Allahut të Madhëruar, të Plotfuqishmit, në *mak'ad-i sidk* (vendin e të sinqertëve) bashkë me pejgamberët. Aty gjen prehje deri në pafundësi.²⁸

Ibrahim Hakki Erzurum e ndan zemrën në këto shtatë stade: iman, sadrul-kalb, hubbetul-kalb, muhxhetul-kalb, shegaf, fuad dhe suvejda, porsì një ndërtim në evolucion.

Në zemrën e çdo njeriut ekzistojnë këto shtatë stade. Mirëpo, në zemrat e paevoluara këto stade ekzistojnë si potencial. Pra, shfaqja e tyre ndodh përmes kinetizimit të kësaj strukture potenciale, për të dalë profili i një robi të Zotit, që zotëron cilësinë **“siddik”**.

E habitshme është që sufistët e tjerë *nokta-i suvejda*-në e konsiderojnë pikënisje, kurse i nderuari Ibrahim Hakki Erzurum e shikon si fund, si përmbyllje.

Në fakt, që të dy mendimet mund të shikohen si plotësues të njëri-tjetrit. Shpirti vazhdon udhëtimin e vet, si një genie e pavarur nga koha dhe hapësira, përtej stadi *suvejda* të zemrës, pra drejt *ama*-së, drejt së vërtetës njerëzore.

Për shembull, Ibn Berrexhan-i, **“kalb”** quan drejtimin pa kohë dhe pa hapësirë që hap zemra, kurse drejtimin me kohë dhe hapësirë e quan **“fuad”**.²⁹

Edhe Hallaxhi në Kitabul-Tavasin, *suvejda*-së i vendos emrin e drejtpërdrejtë **“derë”**. Pra, ky drejtim i zemrës që quhet **“suvejda”**, ashtu siç shihet edhe tek Ibn Arabiu dhe tek Imam Rabbani është dera e pa kohë dhe e pa hapësirë, që hapet drejt origjinalitetit (dhati) të Allahut, vendi ku bëhet dhikri, shfaqja e *mushahede*-së së fillimit të gjithçkaje që është shpallur, vdekja, një derë e hapur drejt ahiretit.

Ndonëse përgjithësisht duket hermetike, por tekefundit, përtej kësaj *nokta-i suvejdase/pikës së zezë/vrimës së errët*, ekziston **“Ama”**³⁰, ashtu sikurse shprehet edhe Ibrahim Hakki Erzurumi (k.s.). Dhe kjo pika më e lartë është stadi i **“siddik”** i gradës së imanit...

Ashtu siç dihet, një ditë sahabët shkuan tek Pejgamberi (a.s.) dhe e pyetën:

- O Resulullah! Kjo gjithësi, në fillim fare ku ishte?

Pejgamberi (a.s.), kthen këtë përgjigje:

- *Ishte në “Ama”, aty ku nuk ka ajër as poshtë e as lart (pra, në pakohë dhe pahapësirë)...*³¹

Ama do të thotë re e errët dhe ka njëkohësisht edhe kuptimin e verbërimit të plotë. Pra, *ama*-ja është një vend qenieje, të cilin mendja nuk mund ta perceptojë, ku mendja mbetet tërësisht e errët para saj... Pra, më parë, e tërë gjithësia, ishte tek e panjohura/verbërimi/errësira. Kur Allahu i Madhëruar tha **“Bëhu!”**, atëherë gjithësia, pra gjithçka u shfaq prej aty.³² Që do të thotë se *nokta-i suvejda* dhe menjëherë pas saj, *ama*-ja, është vendi ku u shfaq gjithçka, sipas asaj çfarë shpjegojnë sufistët.

Në këtë *pikë (nokta)*, që është zeniti i evoluimit shpirtëror sipas Ibrahim Hakki Erzurum, *mushahede*-ja bëhet e plotë dhe e pjekur. Njeriu, në këtë nivel të përsosmërisë, ashtu siç shprehet edhe në hadithin e *Ihsan-it*, arrin të shohë Allahun. Pikërisht këtu realizohet: **Eshhedu enla ilahe il-lall-llah**. Pra, shehadeti këtu merr kuptim: unë besoj sikur e shoh me sy që nuk ka zot tjetër përveç Allahut të Madhëruar.

Shkurtimisht, Ibrahim Hakki Erzurum (k.s.), *nokta-i suvejda*-në e konsideron si stadi i zemrës, përtej kohës dhe hapësirës, ku robi i drejtohet Allahut të Madhëruar.³³

Shënimet: 1) Shih: el-Kushejri, Risâle, Kajro 1966; Huxhvîri, Keshfu'l Mahxhûb, Tahran 1338; Serraxh, el-Luma', Kahire, 1960; Ebu Talib Mekki, Kûtu'l Kulub, Kajro 1961 etj. **2)** A'raf, 179; Haxhxh, 46; Muhammed, 24. **3)** Erzurumlu ibrahim Hakki, Ma'rifetname, istanbul 1310, f. 292-304; veçanërisht shih: Ma'rifetname, thjeshtësuesi: Dr. Kerim Kara, Cafer DurmuS, Erkam Yayınları, istanbul 2011, f. 315-349. **4)** Buhârîu, iman, 39; Nesâi, Bujû', 2; Muslimi, Musâkât, 107; Tirmidhîu, Bujû', 1; Xhamiû's-Sagir, 3856. **5)** Erzurumlu ibrahim Hakki, Ma'rifetname, v. II, f. 318. **6)** Ethem Cebecioglu, Mahmud Sami Ramazanoglu, Evliya Menkibeleri, nr: 9, f. 117. **7)** Süleyman Uludag, Tasavvuf Terimleri Sözlüğü, istanbul 1991, f. 400-402. **8)** Suad el-Hakîm, el-Mu'xhemu's-Sufî, el-Hikmetu fi Hudûdi'l-Kelime, Bejrut 1981, f. 158-168. **9)** Shih: Suhreverdi, Avârif (në qoshe të ihjâ-së), v. II, f. 18 dhe vazhd.; Hânî, el-Bexhetü's-Senijje, f. 3, 30. **10)** Merjem, 52. **11)** Erzurumlu ibrahim Hakki, Marifetnâme, II, f. 329-30. **12)** Shih.: Cebecioglu, Tasavvuf Terimleri, f. 497. **13)** Ma'rifetname, v. II, f. 330. **14)** Uludag, Tasavvuf Terimleri Sözlüğü, f. 409. **15)** Për Elem NeSrah shih: ismail Hakki Bursevî, Ruhû'l Beyan, istanbul 1389, v. X, f. 461-2. **16)** Hadîd, 23. **17)** Nexhmuddin-i Dâje Razî, Mirsâdu'l-iibad, Tahran 1453, f. 110. **18)** Ma'rifetname, v. II, f. 330. **19)** Jusuf, 30. **20)** Tevbe, 82. **21)** Shih veçanërisht: Alusi, Ebu'l Beka, Kullijja, Kajro 1273, f. 278. **22)** Kushejri, er-Risâle, f. 43. **23)** Nas, 1, 4, 5. **24)** Xhurxhânî, et-Ta'rîfat, s. 138; Sulemi, Tabakâtu's-Sûfijje, f. 20, 96, 144, 203, 378. **25)** Ethem Cebecioglu, Tasavvuf Terimleri Sözlüğü, f. 391-392; iskender Pala, Ansiklopedik Divan Siiri Sözlüğü, istanbul 2013, f. 284. **26)** Është transmetuar nga Ebu Rezin, el Ukajli, Cürçânî, et-Ta'rîfat, f. 157. **27)** Kamer, 55. **28)** Erzurumlu ibrahim Hakki, Marifetnâme, v.II, f. 330. **29)** ibn Berrexhan, el-irshâd ilâ Sebili'r-Reshâd, v. II, f. 311. **30)** Muhjiddin ibnu'l-Arabî, Futûhât-ı Mekkiye, v. II, f. 310. **31)** Uludag, Tasavvuf Terimleri Sözlüğü, f. 40. **32)** Jasîn, 82. **33)** Erzurumlu ibrahim Hakki, Marifetnâme, v. II, f. 330.

TELLAL-ËT VULLNETARË

Xhemal Nar

Tellal-ët janë ata të punësuar në tregje që ftojnë klientët në mes të rrugës për të shkuar tek dyqani i tyre që është më tutje. Por kemi edhe plot *tellal-ë* vullnetarë, të cilët përpiqen të ftojnë e të çojnë njerëzit tek shehlerët e tyre. Pa menduar fare se sa mund të jenë të përshtatshëm ata për një gjë të tillë, por nuk reshtin, ftojnë pavarësisht nëse e kupton apo jo ai se ç'është të thotë myrid... Por mjaftohen me një mendje të lehtë, duke thënë: "Edhe nëse s'është i përshtatshëm, bëhet pastaj. Jemi në kohë të vështira, si do qofshin, le të vijmë njerëzit. Me kalimin e kohës pastaj, kalojnë nga *imani taklidi* në atë *tahkiki*, inshallah!"

Eh!.. Ç'të themi, inshallah ashtu ndodh!.. Hë, se pastaj s'mund të ankohemi apo të justifikohemi pa vend, duke thënë: "Tani s'para rriten myridë. Dikur ishin ndryshe punët."

Po, dikur vërtet ishin ndryshe këto punë. Vetë njerëzit arrinin në përfundimin se u ka ardhur koha që të bëheshin myridë, por nuk pranoheshin nga shehlerët. Shehlerët bënin naze për t'i pranuar, u jepnin detyra, përgjegjësi. Të paktën u kërkohet istihare... I nderuari Habibullah Mahzari i pati thënë Abdullah Dehleviut:

"Ky është vendi ku lëpohen gurët pa kripë. Shko, gjeji vetes vende që të kënaqin." Ndërsa kërkuesi, në rastin në fjalë, Dehleviu, iu përgjigj:

"Pikërisht këtë kërkoi edhe unë, që të lëpij gurë pa kripë."

Dikur nuk mblidheshin njerëzit nga rruga. Njerëzve u thuhej: "Nuk mund të kërkoni këtë rrugë ata që duan kënaqësitë e kësaj bote, ata që janë të dhënë pas epshit, pas dëshirave të nefsit."

Ia kujtonin luftën me nefsin, xhihdin ekber. Nuk toleronin aspak mangësitë në detyrat e dhëna. Atëherë, nëse dëshironte hynte, nëse i donte zemra.

Si përfundim, myridi shprehte dëshirën, kurse murshidi bënte naze. Dëshira e myridit ishte në plan të dytë, ai as që kishte arsye të krekosej pse po kërkonte një stad të tillë, përkundrazi, rrinte kokulur dhe i vëmendshëm shumë. Pasi, pranimi i tij si myrid,

ishte krejtësisht në dorën e murshidit, nëse bindej, nëse i ngrohej zemra.

Pata dëgjuar këto nga Mizrakçi Mehmet Emmi Marashliut:

"Pata marrë mësim nga i nderuari ynë Mahmud Sami Ramazanogllu. Nuk arrija dot të ngopesha nga ashku dhe entuziazmi i kësaj jete të re. Në këtë rrugë ftova këdo që mendova se është i përshtatshëm. Një ditë shkova në Stamboll për t'i bërë një vizitë të nderuarit tonë.

Gjatë bisedës fetare, u përkul dhe më tha lehtë në vesh:

- Mizrakçi Efendi, ne ty nuk të kemi bërë *tellal* në Marash.

U ngriva i tëri.

Po, kam përshtypjen se do të ishte mjaft mirë të ndërhyjnë shehlerët, ashtu sikurse bëri Sami Efendiu, pasi myridët e papjekur e prishin imazhin. Tani duket sikur askush nuk pyet për këtë, sa vërtet janë të përshtatshëm njerëzit që të nisin një rrugë të tillë shpirtërore? A kanë dëshirë dhe vullnet për një gjë të tillë? A janë të gatshëm për një detyrë të tillë? Pa i kushtuar aspak rëndësi kësaj ane të medaljes, thujse po i fusin tërë njerëzit nga rruga në dergjah. Mirë që i çojnë ata që i çojnë, po ata që i japin *ders-in*, vallë si ia japin?

Pastaj, me kaq përfundon lidhja me këta pothuajse-myridë. Askush nuk i di ku janë këta njerëz tani, çfarë bëjnë, a zgjohen natën, a falin tehexhahud, a i bëjnë dhikër Allahut të Madhëruar, a i kanë hallall ato çfarë hanë e çfarë pinë, me kë rrinë, ku rrinë etj. Nëse do t'i zësh pak ngushtë, e kanë justifikimin në majë të gjuhës: "Kështu duhet të ishin. Jemi në kohë të këqija. Nuk është koha për të parë absoluten, por është kohë për të shpëtuar imanin. Ndoshta për hir të dashurisë që kanë për evlijanë, ftojnë shpëtimin e amshuar."

Nuk është ky qëllimi që duhet të ketë një rrugëtar i tasavvufit! Nuk i jep dobi kësaj rruge thjesht rritja e numrit! Po le të bëjmë gjithçka për të shpëtuar imanin e njerëzve. Por, pa prishur ndonjë vlerë tjetër, inshallah!



KUJDES NGA RËNKIMI I ATIJ QË I ËSHTË BËRË PADREJTËSI

✦ Ismail Lutfi Çakan ✦

Ngjarjet e kohëve të fundit tregojnë se bota islame po vuan edhe më shumë se më parë. Tashmë thuajse në të gjitha trevat islame kjo gjendje alarmante ka arritur përmasat marramendëse, megjithatë ka mbretëruar një heshtje absolute acaruese ose disa institucione ndërkombëtare që pretendojnë të shërbejnë në emër të humanizmit duket qartë se mbajnë qëndrim pro mizorëve. Pamjet e dhunës që shkatërrojnë zemrën e çdo njeriu, të shfaqura në media dhe në instrumente të tjera komunikimi masiv, shpeshherë s'të lënë fjalë për të thënë. Ekziston një aprovim i heshtur i të gjithëve që tashmë kemi mbërritur në një pikë ku mbaron fjala. Shkurtimisht, në një kuptim të përgjithshëm, kohët të vështira për myslimanët nuk kanë reshtur kurrë.

Allahu i Madhëruar përmes pejgamberëve ka përmirësuar aktualitetet e kohëve të vështira që ka pasur njerëzimi dhe i ka drejtuar ata drejt horizonteve të reja. Vështirësitë e aktualitetit tonë sërish mund të zgjidhen përmes së njëjtës metodë. Meqë pas Pejgamberit (a.s.), nuk do të vijë ndonjë tjetër pejgamber, atëherë udhëzimin e Pejgamberit tonë (a.s.), ta bartim në aktualitetin tonë përmes udhëzimit dhe orientimit që ai bën përtej kohës. Me siguri kjo është si domosdoshmëri paraprake e të qenit **“i Dërguari i ymetit”**.

Ashtu siç dihet, Pejgamberi ynë (a.s.), kur po udhëzonte njerëzimin dhe ymetin, ka përdorur metodën e motivimit (tergib) dhe të qortimit/paralajmërimit (terhib). Përgjithësisht ka qenë e tillë radhitja e përdorimit të metodave, por ndonjëherë mundet të ketë fituar epërsi qortimi ndaj motivimit.

Duke u nisur nga kjo ide, kemi planifikuar të ndajmë me ju një buqetë me hadithe që përfshijnë qortimet “Kujdes/Ruajuni!” të Resulullahut (a.s.), nën titullin e përgjithshëm “Qortimet nga Njeriu Shembullor – i Dërguari i fundit”. Këshillën dhe qortimin e tij: “Kujdes nga rënkimi i atij që i është bërë padrejtësi”, e zgjodhëm si temë të parë të kësaj serie si diçka të rëndësishme, shumë të rëndësishme e thënë kundrejt shtypësve të të drejtave dhe atyre që i mbështesin ata, atyre që pëlqejnë në mënyrë të fshehtë apo të hapur cenimin e së drejtës së tjetrit.

Rivajeti i hadithit, i cili përbën thelbin e temës sonë, është në këtë mënyrë:

Sipas asaj çfarë transmetohet nga Abdullah ibn Abasi (r.a.), Pejgamberi (a.s.) kishte emëruar (si vali), Muadh-in (Ibn Xhebel), në Jemen. (Sipas udhëzimit që i kishte dhënë, në fund) thoshte kështu:

- (O Muadh!) Kujdes nga mallkimi i atij që i është bërë padrejtësi! Pasi mes rënkimit të atij që i është shtypur e drejta dhe pranimit të atij mallkimi nga Allahu nuk ka asnjë pengesë.¹

Fjalja e fundit është transmetuar edhe si “nuk ka asnjë pengesë mes atij që i është bërë padrejtësi dhe Allahut (pranimit të asaj duaje)².

Tirmidhiu, në fund të transmetimit, pasi ka thënë: “lidhur me këtë çështje ekzistojnë edhe transmetime të Enesit, Ebu Hurejres, Abdullah bin Omerit, Ebu Saidit”, përcakton gjithashtu se hadithi është “hasen”³.

Thuajse në të gjithë transmetimet e hadithit, është mjaft interesant fakti që koha kur është bërë kjo vërejtje është viti i nëntë i hixhretit, atëherë kur Pejgamberi (a.s.) Muadh bin Xhebelin e emëron vali në zonën Xhened të Jemenit, pasi e kishte këshilluar që kur të mblidhte zekatin, në mesin e mallrave që do mblidhte si zekat, të mblidhte ato të mesmet dhe pastaj i kishte tërhequr vëmendjen përmes këtij paralajmërimi që cituam më lart. Kësisoj, në çfarëdo lloji situatë dhe rrethana që të jetë njeriu, keqpërdorimi i pushtetit të shtetit konsiderohet zullum, padrejtësi, shtypje e të drejtave të tjetrit.

Udhëzimi “*kujdes nga rënkimi i atij që i është bërë padrejtësi*” në fakt është në kuptimin “kujdes se mos të bësh padrejtësi”. Pasi, rënkimi i atij që i është bërë padrejtësi, është një përfundim i çfarëdo lloji padrejtësie që atij i bëhet. Por, mallkimi që bëhet pa i ushtruar njeri padrejtësi, nuk konsiderohet “rënkimi i atij që i është cenuar e drejta”.

Padrejtësia për të cilën bën fjalë hadithi është padrejtësi materiale. Edhe shprehja e Pejgamberit (a.s.), “Matlu’l-ganijji dhulmun = Ai që ka mundësi dhe që e vonon huanë bën zullum”⁴, në marrëdhëniet ekonomike përbën një konstatim dhe kërcënim mjaft me rëndësi.

Kuptohet qartë se mallkimi i atij që i është cenuar e drejta, në çfarëdo lloji situatë le të jetë padrejtësia/zullumi i bërë, nuk përbën ndonjë pengesë mes atij dhe Allahut. Atëherë, paralajmërimi kryesor këtu është që të përqendrohemi në pikën e asaj që të mos i japim shkas një situatë të tillë, pra të mos shtypim të drejtat e tjetrit.

Në një tjetër hadith të Pejgamberit (a.s.), masën që ndërmerret në Ahiret e shpjegon në këtë mënyrë: “*Kini kujdes se mos cenoni të drejtën e ndonjërit. Pasi padrejtësia shndërrohet në errësirë në Ditën e Kiametit.*”⁵

Në fakt nuk ka njeri me mend në kokë që ta dëshirojë që, brenda tmerrit që e karakterizon vetë Ditën e Kiametit, të rrish edhe në errësirën e krijuar në sajë të padrejtësive që ke bërë kur ishe në botë. Zgjidhja e kësaj është: përpjekja për të qëndruar larg çdo lloji padrejtësie të mundshme ndaj tjetrit.

TRE DIMENSIONET E PADREJTËSISË

Dijetarët myslimanë, të cilët janë përpjekur të bëjnë shpjegime lidhur me këtë temë, padrejtësinë e ndajnë në tri pjesë të ndryshme:

1. Padrejtësia mes njeriut dhe Allahut: shirku, kufri, nifaku dhe isjani.

2. Padrejtësia mes njerëzve: padrejtësia, vrasja, shpifja dhe gjynahe të ngjashme.

3. Padrejtësia mes njeriut dhe vetes së vet: padrejtësia që njeriu i bën vetvetes duke mos kryer detyrat ndaj Allahut dhe duke u bërë padrejtësi të tjerëve.

Çdo gjynah është një padrejtësi e bërë ose ndaj vetes ose ndaj tjetrit. Padrejtësia që i bëhet tjetrit në fakt është një padrejtësi që njeriu bën njëkohësisht edhe kundër vetes së vet. Ai do të japë llogari për të dhe do të ndëshkohet.

PADREJTËSIA ËSHTË PRODUKT I PAAFTËSISË

Të paaftit dhunojnë. Ndonjëherë padrejtësia forcohet dhe përhapet në mënyrë marramendëse. Mirëpo, mund të zhduket po ashtu papritur dhe pamenduar.

Kurrë nuk do të mbetet pa përgjigje padrejtësia dhe zullumi i ushtruar kohëve të fundit kundrejt gjithë popujve myslimanë. Pasi mes duave – dëshirave të të shtypurve dhe Allahut nuk ekziston perde. Rënkimet e tyre mbërrijnë direkt tek Allahu. Kurse Allahu i Madhëruar mundet që ta shtyjë (ta vonojë) dënimin që do u bëjë dhunuesve.

Në një hadith kudsit thuhet kështu:

“O njerëzit e mi! Unë ia kam ndaluar vetes padrejtësinë. Ashtu sikundër kam ndaluar edhe për ju bërjen e padrejtësisë ndaj njëri – tjetrit. Kësisoj, mos i bëni padrejtësi njëri – tjetrit.”⁶

Në një ajet kuranor thuhet: “**...Mallkimi i Allahut goftë mbi të padrejtët!**” Kjo do të thotë që Allahu i Madhëruar do t’i mbajë larg mëshirës së Vet ata që bëjnë padrejtësi. Të qenit larg mëshirës së Tij është

dënimi më i madh dhe më i rëndë që mund t'i jepet një njeriu.

Në një hadith thuhet kështu: *“Mallkimi i atij që i është cenuar e drejta do të marrë përgjigje medoemos.”*⁸ Nuk duhet harruar që një nga çështjet për të cilën Pejgamberi (a.s.), ka kërkuar mbrojtjen e Allahut është *“rënkimi/mallkimi i atij që i është cenuar e drejta.”*⁹

Ekzistojnë edhe dy transmetime që sqarojnë më tutje këtë postulat të dalë nga hadithi i lartcituar, të cilët tregojnë se për t'u pranuar shqetësimi i tyre mjafton që ata të jenë vërtet të shtypurit.¹⁰ Që do të thotë se, edhe nëse është gjynahqar apo afetar ai që ndaj tij është bërë padrejtësi, nuk ndikon aspak në pranimin e rënkimit/mallkimit të tij:

“Mallkimi i atij, kundrejt të cilit është bërë padrejtësi, qoftë ai edhe gjynahqar, do të pranohet. Të qenit gjynahqar është për veten e vet.”

“Mallkimi i atij, kundrejt të cilit është bërë padrejtësi, qoftë ai edhe gjynahqar, do të pranohet. Pasi mes atij që i është bërë padrejtësi dhe realizimit të duasë së tij nuk ekziston asnjë lloj pengese.”

Në fakt padrejtësia që i bëhet tjetrit është një faj. Kundrejt kujt do që të bëhet një gjë e tillë, ajo asnjëherë nuk është legjitime nga aspekti islam. Ndaj dhe është thënë: *“Nuk është e lejuar padrejtësia ndaj tjetrit, qoftë edhe ndaj femohuesit.”*¹¹

TRI DUATË E PRANUARA

Ndërkohë, ekzistojnë tri kategori lutjesh – mallkimesh që pranohen:

*“Ekzistojnë tri dua që me patjetër do të pranohen: dua e atij që i është bërë padrejtësi; dua e mysafirit dhe dua e prindërve për fëmijën.”*¹²

Ata që bëjnë mallkime, ndërkohë që nuk janë pjesë e njëres prej këtyre tri kategorive, dëmin ia bëjnë më shumë vetes sesa tjetrit. Është një fakt që Pejgamberi (a.s.), ka mallkuar mushrikët mekas, të cilët u bënë shkak që, gjatë betejës së Hendekut, myslimanët të linin për kaza namazin e ikindisë: *“Allahu i mbushtë me zjarr shtëpitë dhe varret e tyre! Na penguan që të falnim namazin e ikindisë derisa të perëndonte dielli.”*¹³

Po ashtu, dihet se Pejgamberi (a.s.), ka mallkuar parinë e mushrikëve, si Sefvan b. Umejjen, Suhejl b. Amrin dhe Haris bin Hishamin, duke u përmendur emrat, si dhe për një muaj rresht ka mallkuar fiset Ri'l, Zekvan dhe Usajj, duke kënduar kunutin pas ruku-së së rekatit të dytë të namazit të sabahut, pasi u kishin përgatitur kurth dhe i kishin vrarë thirrësit islamë në Bi'r-i meune. Pastaj, nëpërmjet ajetit **“Ti nuk ke asgjë në dorë, nëse do t'ua pranohë Ai pendimin apo do t'i dënojë, se ata janë vërtet keqbërës.”**¹⁴, është ndaluar një praktikë e tillë.

Këtu, Allahu i Madhëruar bën të ditur që dënimi apo shpërblimi i njerëzve është tërësisht në dorën e Tij. Gjithashtu në këtë ajet duket qartë tërheqja e vërejtjes edhe ndaj Pejgamberit (a.s.), lidhur me këmbënguljen e tij përmes mallkimeve për t'i ndëshkuar Zoti ata.

Kjo pikë duhet bërë mjaft kujdes. Kjo do të thotë që, të çohet dikush dhe të mallkojë disa myslimanë të tjerë, ashtu kuturu, haptazi, publikisht dhe të vetëkategorizohet si viktimë e padrejtësisë, kjo gjë është e diskutueshme, madje e papranueshme se sa është **“rënkim i atij që i është bërë padrejtësi”**. Kësisoj, mundet që të mos jetë ashtu siç pretendohet. Pasi ajo çfarë është përcaktuar në hadith është që të ruhet prej mallkimit të atij që vërtet i është bërë padrejtësi.

Allahu i Madhëruar i ruajtë të gjithë myslimanët nga padrejtësia e tjetrit dhe nga padrejtësia ndaj tjetrit!

Shënimet: **1)** Buhâri, Medhalim 9; Xhihad 180; Megazi 60; Muslimi, Iman 29; Ebu Davud, Zekat 5; Nesâi, Zekat 1, 46; Tirmidhiu, Birr 68; Ibn Mâxhe, Zekâ 1; Muvatta, Davetu'l-madhlum 1; Ahmed b. Hanbel, Musned, I, 223; III, 153. **2)** Buhari, Megazi 60. **3)** Tirmidhiu, Birr 68. **4)** Buhariu, Havâlât 1, 2; Istikrâz 12; Muslimi, Musâkat 33. **5)** Muslim, Birr 56. **6)** Muslim, Birr 55. **7)** Hud (11), 18. **8)** Buhari, Xhihad 180. **9)** Shih. Ibn Ebi Shejbe, *Musannef*, X, 359. **10)** Ahmed b. Hanbel, Musned, III, 153; VI, 353 (Për këto dy transmetime, Shuajip el-Arnavudi thotë se janë “me isnad të dobët”) **11)** Muvatta, (Kopja e Hasen esh-Shejbani) III, 261. **12)** Ibn Maxhe, Dua 11. **13)** Buhari, Xhihad 98; Megazi 29; Tefsiru sure 2, 42; Muslimi, Mesaxhid, 202-206; Ebu Davud, Salat 5. **14)** Al-i imran (3), 128.



Testi i inteligjencës dhe Ahireti

Nuredin Jëlldëz

Testet e inteligjencës që u bëhen fëmijëve i vlerësojmë si shumë të rëndësishëm për të ardhmen e fëmijëve. Në një kohë që diploma dhe pritshmëritë lidhur me diplomën konsiderohen si sukcesi i vetëm i jetës, kuptojmë arsyen se përse prindërit i kushtojnë kaq shumë rëndësi përcaktimit të inteligjencës së fëmijës së tyre. Mos vallë po shkojmë drejt një shoqërie që po ndan individët e saj në inteligjentë dhe jointeligjentë? Ashtu sikur ndahen njerëzit në “të bardhë” dhe “të zinj”, tashmë kemi nisur të ndajmë njerëzit në “inteligjentë” dhe “jo-inteligjentë”. Nuk është e nevojshme të theksojmë se është i papranueshëm klasifikimi që u bëhet njerëzve sipas ngjyrës së lëkurës së tyre, sipas pasurisë apo zgjuarsisë që kanë apo nuk kanë. Testi i inteligjencës bëhet në një shkollë me qëllim që të përcaktojë cilësinë e edukimit të klasave, por një klasifikim i tillë që bëhet mes njerëzish, është po aq shqetësues sa klasifikimi i bardhë – i zi. Përderisa nuk mund të pretendojmë që të gjithë njerëzit të ishin të zgjuar, të qenit i kënaqur me atë se si e ka krijuar Allahu është pjesë e besimit tonë.

Kur shohim me syrin e një besimtar investimet e bëra për përgatitjen dhe zbatimet e testeve të inteligjencës vërejmë një detaj që nuk duhet neglizhuar. Zakonisht testet e inteligjencës aplikohen mbi njohjen e shifrave matematikore të fëmijëve, aftësisë dhe refleksive konceptuale të gjërave të përgjithshme. Interesimi i fëmijës ndaj matematikës, perceptimi i tij ndaj familjes dhe rrethit të afërm dhe të largët vlerësohet me disa pikë.

Ne si njerëz besimtarë nuk mund ta pranojmë si të mjaftueshëm një test të tillë të inteligjencës që aplikohet mbi fëmijët tanë. Ekzistojnë mjaft mangësi në atë testim. Për shembull, kur një fëmijë dhjetëvjeçar i aplikohet testi në fjalë, është lënë në heshtje totale raporti i atij fëmijë me botën tjetër, Ahiretin. Nuk ka se si të jetë i kënaqshëm rezultati i një testi që bëhet mbi lidhjen e fëmijëve vetëm me shifrat dhe raportet e tyre me atë çfarë e rrethon atë, krahasuar me një test që përfshin edhe ndjesitë e fëmijëve ndaj llogarisë në botën tjetër. Familjet besimtare që kuptojnë peshën e jetës së kësaj

bote me të asaj tjetrës, nuk presin ndonjë vendim të llojit “është inteligjent/nuk është inteligjent”, kur kanë parasysh se këto teste janë përgatitur në ambiente që nuk pranojnë apo që gjysmë-pranojnë Ahiretin.

Edhe këtë duhet thënë: meqë ne ekzistojmë për Ahiretin ose çdo fjalë është e ndërtuar në shërbim që njeriu të pranojë këtë të vërtetë, si mund ta respektojmë këtë test kur ai nuk e merr në konsideratë Ahiretin? Fëmijët që po i përgatisim për të qenë të gatshëm që të përballen me Ahiretin, si mund t'i motivojmë apo demotivojmë duke u thënë: “mirë, shumë mirë, mrekullueshëm, mangët, gabim”, duke u nisur nga një provim ku përfshihen thjesht shifra matematikore? Kjo nuk është asgjë tjetër veçse diçka për të kaluar kohën.

Ekziston një perceptim i gabuar që medoemos duhet ndrequr. Në fakt, për ata që jetojnë për këtë botë, nuk ekziston asnjëfarë shqetësimi, për ata që mjafton diploma, punësimi, fitimi, mjafton gjithashtu edhe testi i inteligjencës. Kurse ne kemi shqetësimin e botës së përtejme. Ne kemi shqetësim xhenetin, xhehenemin, siratin, mizanin, mahsherin. Qëllimi ynë është që fëmijët tanë të vënë për qëllim njohjen e Ahiretit. Testi ynë duhet të jetë sikurse perceptimi ynë. Testet që përgatiten në tavolinat e të tjerëve, nuk kanë si të pasqyrojnë vlerat tona.

Edukimi dhe standardi i fëmijës që do të jetojë një jetë të tërë duke u bazuar mbi besimin në Ahiret përcaktohet sipas saj. Edhe në projektet e rritjes së të rinjve besimtarë si me hafizllëk dhe të tjera, mjetet matës, nëse do të përcaktohen si mjete të rëndomta, si përfundim mundet të mos ketë të rinj që përllogarisin punët e tyre për Ahiretin.

Ne ekzistojmë për Ahiret, po ashtu edhe investimet tona do të shkojnë për Ahiret. Llogaritë tona bëhen në bazë të Ahiretit, që ahireti të zërë vendin e shpresave tona.

MREKULLITË E Kur'anit



MREKULLIA QË NDODH KUR DËGJON KURANIN

Valët e zërit nga recitimi i Kur'anit të Shenjtë aktivizojnë qelizat e trupit dhe shërojnë sëmundjet posaçërisht sulmin në zemër dhe kancerin.

Allahu thotë:

“Kur lexohet Kurani, ju dëgjojeni atë (me vëmendje) dhe heshtni, në mënyrë që të fitoni mëshirë.” (Araf, 204)

A e keni ditur?

Dëgjimi i Kur'anit të Shenjtë për tre orë çdo ditë e rritë sistemin tuaj të imunitetit, e mbron zemrën dhe trurin tuaj, dhe i ri-programon qelizat tuaja ...

Valët e zërit nga recitimi i Kur'anit të Shenjtë aktivizojnë qelizat e trupit dhe shërojnë sëmundjet posaçërisht sulmin në zemër dhe kancerin.

STREHE E SIGURTE!

Në Kuran, Allahu na tërheq vëmendjen ndaj një vetie mjaft interesante të qiellit:

Qiellin e kemi bërë si strehë të sigurtë e të mbrojtur... (Junus, 61)

Kjo veti e qiellit është vërtetuar prej kërkimeve shkencore të kryera në shekullin XX.

Atmosfera, e cila rrethon tokën, kryen shërbime jetike për të siguruar vazhdimësinë e jetës. Duke shkatërruar mjaft meteorë të mëdhenj e të vegjël gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur tokën, ajo i ndalon ata që të përplasen me tokën dhe të dëmtojnë gjallesat.

Për më tepër, atmosfera filtron rrezet e dritës që vijnë nga hapësira, të cilat janë të dëmshme për krijesat e gjalla. Fakti më interesant është se vetëm rrezet e padëmshme e të nevojshme - drita e tejudukshme, rrezet e shkurtra ultraviolet dhe valët e radios - janë në gjendje të përshkojnë atmosferën. I gjithë ky rrezatim është i domosdoshëm për jetën. Atmosfera lejon kalimin vetëm të një pjese të rrezeve të shkurtra ultraviolet, të cilat janë mjaft të domosdoshme për procesin e fotosintezës te bimët dhe për ekzistencën e të gjithë gjallesave. Pjesa më e madhe e rrezeve të gjata ultraviolet të lëshuara nga dielli filtrohen prej shtresës së ozonit në atmosferë dhe vetëm një pjesë e kufizuar dhe esenciale e tyre arrijnë në Tokë.

Atmosfera mbron gjithashtu tokën prej të ftohtit ngrirës të hapësirës, i cili arrin deri në minus 270 gradë celcius.

Nuk është vetëm atmosfera ajo që e mbron Tokën nga efektet shkatërruese dhe dëmtuese të hapësirës. Së bashku me atmosferën, brezi Van Alen, një shtresë, e cila krijohet si rezultat i fushës magnetike të Tokës, gjithashtu shërben si një fushë mbrojtëse kundër rrezatimeve të dëmshme, të cilat kërcënojnë planetin tonë.



“Atë, xhenetin ua kemi përcaktuar atyre që nuk dëshirojnë madhështi dhe nuk bëjnë arrogancë në tokë. Përfundimi i këndshëm u takon atyre që i frikësohen Allahut.”

(Kasas, 83)

Mendjemadhësia është vlerësimi i tepruar i aftësive personale, ndërsa mendjemadh është ai të cilit i pëlqen shumë mendja e vet dhe nuk pranon e nuk përfill mendimin e të tjerëve, por shfaq sjellje arrogante ndaj tyre. Përkundrajt kësaj qëndron përulësia, butësia dhe modestia. Mendjemadhësia mund të shfaqet në forma të ndryshme, si për shembull origjina, përkatësia fisnore, pasuria, fuqia, forca fizike, bukuria, të mësuarit e dituria, statusi social e arritjet personale. Madje mendjemadhësia mund të shfaqet edhe në shërbimin e tepruar ndaj Zotit. Tipi më i keq i kryelartësisë është ajo që shprehet ndaj Zotit, ndaj të Dërguarit të Tij dhe ndaj fesë.

Në ajetin e mësipërm shprehet qartë se një nga kushtet për të fituar xhenetin është të mosqenit mendjemadhënj e arrogantë ndaj njerëzve. Kjo arrihet duke besuar Allahun në mënyrën më të sinqertë dhe duke iu bindur pa asnjë mëdyshje urdhërave dhe vullnetit të Tij, duke mos shpalosur as më të voglën shenjë madhësie ndaj Allahut dhe krijesave të Tij. Ishte pikërisht kjo ndjenjë madhësie, ajo që shfaqti shejtani, i cili për këtë arsye meritoi mallkimin e Allahut, duke e humbur kështu njëherë e përgjithmonë mundësinë për t'u përfshirë nga mëshira e Allahut. Në një ajet tjetër, duke na urdhëruar që të mos mburremi, Allahut thotë:

“Dhe mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, se Allahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet.” (Lukman, 18)

Kur njeriu e zbraz zemrën nga ndjenja

e besimit që ekziston në mënyrë të natyreshme në zemrën e tij, ai fillon të pushtohet nga ndjenja e madhësisë dhe kryelartësisë, aq sa çdo të mirë që zotëron, si fjala vjen pasuria, fuqia, pushteti, bukuria, ia dedikon aftësive të veta personale. Sikur të arrinte të kuptonte se të gjitha ato të mira i janë dhënë nga Allahu, në mënyrë që të bëhej i vetëdijshëm për pafuqinë dhe dobësinë e tij përballë fuqisë së Allahut, do të sillej në mënyrë modeste me njerëzit, pa treguar as shenjë më të vogël të mendjemadhësisë. Kush e harron këtë fakt të rëndësishëm, nuk bën gjë tjetër vetëm se përsërit gabimet që kanë bërë faraoni dhe Karuni, të cilët jepën si modele dhe shembuj të këqij sa i përket shfaqjes së mendjemadhësisë dhe të arrogancës në tokë. Allahu i dha Karunit begati të shumta, si pasuri dhe pushtet, por në vend që të falënderonte Allahun për mirësitë e dhëna dhe t'i shpenzonte për bamirësi, ai u përfshi nga ndjenja e madhësisë dhe arrogancës.

Por si ishte përfundimi i tij? Allahu thotë në Kuran:

“Dhe për këtë arsye, Ne e fundosëm thellë në tokë atë edhe pallatin e tij, dhe nuk pati askënd që ta ndihmonte dhe as veten e tij nuk mundi të mbronte përballë Allahut.” (Kasas, 81)

Përfundimi i këndshëm dhe i lumtur është për ata që janë modestë dhe të sjellshëm me njerëzit.

Allahu ka thënë në Kuranin famëlar-të: “...e s’ka dyshim se te Allahu, më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat)...” (Huxhurat, 13)

Nevas ibn Sem'ani tregon: e pyeta Pejgamberin a.s., për të mirën dhe mëkatin. Ai më tha:

"E mira është e gjitha moral i bukur, kurse mëkat është çdo vepër që brengos zemrën dhe urren që ta dinë të tjerët."

(Buhari)

Pejgamberi (a.s.), e ka përkufizuar mirësinë në mënyrë të përmbledhur si moral i bukur. Me këtë aforizëm na tregon që prej njeriut të virtytshëm ka vetëm mirësi.

Pajisja e njeriut me moral të bukur është nga pikësynimet parimore të fesë islame. Morali i lartë arrihet duke zbatuar me përpikëri të gjitha urdhëresat hyjnore. Ai që i kryen me sinqeritet detyrimet ndaj Allahut, ndaj vetes dhe ndaj shoqërisë arrin përsosmërinë shpirtërore. Njerëzit që arrijnë këtë gjendje shpirtërore fitojnë respektin e gjithë shoqërisë dhe janë nga njerëzit më të nderuar. Njerëzit mahnitën me mirësjelljen e tyre, sepse prej tyre nuk mund të vijë asnjë e keqe.

Për t'u bërë i mirë njeriu duhet të sakrifikojë në aspektin material dhe shpirtëror duke sakrifikuar interesat personale për t'ua kushtuar të tjerëve. Padrejtësia që i bëhet dikujt s'duhet ta çojë atë në sjellje mizore, por të jetë në gjendje ta falë atë.

I pasuri, duke shpenzuar pasurinë

në dobi të shoqërisë, pushtetari duke e përdorur pozitën, autoritetin në shërbim të komunitetit, mësuesi duke arsimuar dhe edukuar rininë, mund të arrijnë shkallën më të lartë të moralit dhe për këtë arsye fitojnë mëshirën e Allahut dhe vendosen në xhenetet më të larta.

Pejgamberi (a.s.), ka vendosur një kriter të qartë për të gjithë, në mënyrë që të bëjnë dallimin midis së mirës dhe së keqes.

Nëse vepra që kryhet shqetëson dhe vret ndërgjegjen dhe njeriu nuk dëshiron t'i dalë në pah, padyshim që është e keqe. Sepse njerëzit në përgjithësi, kur bëjnë një të mirë, dëshirojnë që t'u dihet nga të tjerët. Ky është një kriter i qartë që funksionon për të gjithë. Për t'u distancuar nga një veprim mjafton vetëm dyshimi që shkakton në ndërgjegje. Prandaj për çdo veprim njeriu duhet të pyesë ndërgjegjen, sepse një ndërgjegje e pastër nuk gabon kurrë.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Pikësynimi që duhet të arrijë njeriu është morali i mirë.
2. Njeriu duhet të mësojë çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe.
3. Virtyti, ndershmëria dhe të gjitha sjelljet që pranojnë të mira janë moral i bukur.
4. Njeriu duhet të kuptojë dhe të largohet prej veprimeve që i shqetësojnë ndërgjegjen.



TË ARRISH PËRSOSMËRINË PËRMES KURANIT DHE SUNETIT DO TË THOTË TASAVVUF

TA TEPROSH ME DASHURINË...

Thesari i vërtetë i zhvillimit shpirtëror në Tasavvuf është **dashuria**. Kurse manifestimi i saj është **kujdesi ndaj edukatës, moralit**. Thesari i vërtetë i lidhjes shpirtërore me *murshid-ët kamil*, pra i **rabita**-së, është gjithashtu dashuria. Porse, ashtu sikurse në çdo çështje, edhe në dashuri, teprimi e shpie njeriun në rrugë të gabuara.

Kështu që, ajo çfarë është gabim në *rabita* është: lartësimi i dashurisë ndaj njerëzve në gradën e dashurisë hyjnore. Të nderosh deri në atë gradë sa thuajse t'i atribuosh hyjnitet një njeriu që është udhëheqës shpirtëror, ta respektosh përtej kufijve dhe të krijosh një lidhje të verbër, deri në fanatizëm, të drejtohesh drejt një sjelljeje që nuk e aprovon as Kurani e as Suneti. Më shumë sesa dobi, kjo gjë i shkakton dëm atij njeri që e bën këtë veprim, madje ia rrëshqet këmbët nga rruga e drejtë.

Nuk duhet harruar kurrë që *murshid*-i për *myrid*-in është vetëm një **“mësues”**. Ta teprosh me dashuri ndaj mësuesit dhe ta bësh atë **“qëllim”** më vete, në atë moment i hap derën shirkut. Ata që bëjnë veprime të tilla të tepruara forcojnë kundërshtarët e

Tasavvufit dhe dëmtojnë *istikamet*-in e rrugës, pjesë e së cilës janë.

Rasti i **Ebu Bekrit** (r.a.), i cili e donte më shumë se çdokush tjetër **të Dërguarin e Allahut** (a.s.), por që gjithmonë ishte i kujdesshëm, i matur dhe brenda *istikamet*-it, është mjaft shembullore për njerëzit e Tasavvufit:

Vdekja e **Resulullahut** (a.s.), u pati ardhur mjaft e rëndë sahabëve fisnikë. Të gjithë ishin habitur dhe ishin mërzitur shumë. Pasi tashmë nuk do ta shihnin fytyrën e ndritur të tij dhe nuk do të mund të ngushëlloheshin me qenien e tij, të cilën e donin më shumë se çdo krijesë tjetër. Nga mesi i sahabëve kishte prej atyre që nuk e donin syrin që nuk e shihte më atë,

veshin që nuk e dëgjonte më atë e as jetën pa Resulullahun (a.s.). Kështu nisën të qanin në xhami. Ndërkohë që zemrat ishin tronditur nga kjo dhimbje kaq e fortë, aq sa edhe një njeri që shquhej për autoritet, si **Omeri** (r.a.), madje qe shprehur i hidhëruar:

“Të mos dëgjoj njeri të thotë: ‘Ka vdekur Muhamedi!’ Përndryshe, ia këpus kokën me shpatën time! Profetit (a.s.), i ka rënë të fikët, ashtu sikurse Musait (a.s.)!..”



Ishte aq i dëshpëruar sa goja i shkumbonte tek fliste.

Kur Ebu Bekri (r.a.), dëgjoi lajmin e hidhur, menjëherë i hipi kalit dhe erdhi në Medine. Zbuloi fytyrën e Pejgamberit. Pastaj, duke qarë e puti në ballë dhe tha:

“Pasha Allahun, Resulullahu paska vdekur!

“Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!” (Bekare, 156)

Babai e nëna ime u bëfshin kurban për ty! Beto hem në Allahun, që Ai nuk do të mundësojë për ty dy herësh vuajtjen e vdekjes! Ti vdiqe njëherë dhe tashmë e kalove prapun e përcaktuar të vdekjes! S’ka më vdekje për ty!..

...Ti edhe kur ishe i gjallë ishe i bukur, edhe pas vdekjes po ashtu!..”

Pastaj mbuloi me mbulesë fytyrën e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe doli jashtë.

Ndërsa Omeri (r.a.), vazhdonte të fliste ashtu si më parë, që Pejgamberi (a.s.), ende s’kishte vdekur, Ebu Bekri (r.a.), iu drejtua duke i thënë:

- Ulu tashmë, o Omer!

Por Omeri (r.a.), nuk pranoi të ulej. Ebu Bekri e përsëriti disa herë fjalën e tij dhe në atë kohë aq dramatike, me një burrëri të paparë, bëri këtë fjalim qetësues për njerëzit:

“Allahu i Madhëruar kishte lajmëruar për vdekjen e Pejgamberit që kur ai ishte në mesin tuaj. Ai ka lajmëruar edhe vdekjen tuaj (kur t’ju vijë përcaktimi i Zotit). Resulullahu (a.s.), ka vdekur! Dhe askush

prej jush nuk do të mbesë gjallë (përherë). Kush ka adhuruar Muhamedin, le ta dijë se Muhamedi (a.s.), ka vdekur! Kurse, kush ka adhuruar Allahun, padyshim që Allahu është Hajj, i pavdekshëm!

Allahu i Madhëruar ka thënë:

“Muhamedi është vetëm i Dërguar, para të cilit ka pasur edhe të dërguar të tjerë. Nëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa? Kushdo që kthehet prapa, nuk i bën kurrfarë dëmi Allahut. Dhe Allahu do t’i shpërblejë falënderuesit.” (Al’ Imran, 144)

Kur njerëzit dëgjuan këtë ajet, u siguruan që Resulullahu (a.s.), kishte vdekur. Ishin habitur aq shumë sa, sikur nuk e dinin se ajeti që citoi Ebu Bekri (r.a.), ishte i shpallur me kohë.

Omeri (r.a.), tha:

“Pasha Allahun! Më dukej sikur deri atë ditë s’e kisha dëgjuar ndonjëherë atë ajet! Kur e dëgjova nga Ebu Bekri, mbeta i shokuar. Nuk arrinin dot të më mbanin këmbët. Aq sa vërtet rashë pa ndjenja për tokë.” (1)

Ashtu pra siç duket qartazi, Ebu Bekri (r.a.), i cili e donte Pejgamberin e nderuar më shumë se çdokush tjetër, që e respektonte dhe e nderonte më shumë sesa e respektonin dhe e nderonin të tjerët, kjo dashuri e tij e pashembullt, kurrë nuk i qe bërë shkak për teprime dhe asnjëherë ky respekt nuk e ka drejtuar të bënte ndonjë veprim a sjellje në kundërshtim me të vërtetat e sheriatit. Përkundrazi, ai u bë shkak që të qortonte dhe t’u tërhiqte vërejtje atyre që po e tepronin në këtë pikë.

“Muhamedi është vetëm i Dërguar, para të cilit ka pasur edhe të dërguar të tjerë. Nëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa? Kushdo që kthehet prapa, nuk i bën kurrfarë dëmi Allahut. Dhe Allahu do t’i shpërblejë falënderuesit.”

(Al’ Imran, 144.)

TEPRIMI DHE FANATIZMI

Fjalët si: **“Nëse Shehu im dëshiron diçka, Allahu patjetër ia dhuron...”** të disa myridëve, janë tregues i qartë i tejkalimit të limiteve të lejuara të dashurisë, respektit dhe lidhjes me Shehun.

Pejgamberit (a.s.) madje, duke qenë edhe më i dashuri i Allahut, disa nga duatë nuk i janë pranuar. I Dërguari i Allahut (a.s.), në një hadith, është shprehur kështu:

“Tri gjëra dëshirova nga Zoti im. Dy prej tyre m’i dha, kurse tjetrën nuk ma dha: u luta që Zoti të mos e shkatërrojë ymetin tim përmes një skamjeje të përgjithshme dhe Ai ma plotësoi. Dëshirova që të mos ma shkatërrojë tërë ymetin tim duke ma mbytur; edhe atë Ai ma plotësoi. U luta që të mos luftojë ymeti im mes njëri – tjetrit, këtë nuk ma plotësoi.” (Muslimi, Fiten, 20/2890.)

Kjo do të thotë që Zoti, nëse dëshiron i realizon duatë e pejgamberëve, nëse jo, nuk i plotëson. Kështu që, në çfarëdo stadi qoftë njeriu, ka nevojë si për vepra ashtu edhe për dua që t’i drejtohet Allahut të Madhëruar.

Kjo gjë, duke qenë e tillë edhe për pejgamberët, duhet kuptuar qartë sesa i përfshin pastaj edhe duatë e të tjerëve, qofshin ata edhe *evlija*.

Kësisoj, nuk mund të thuhet kurrë që një njeri që Allahu e do, kur bën dua, dua ja e tij pranohet medoemos apo kur i bën një dua një të sëmuri, ai medoemos do të shërohet. Pasi çështje të tilla, krahas sinqeritetit që duhet të kenë të dy palët, duhet pasur parasysh edhe përcaktimi dhe vullneti i Zotit të Madhëruar, që ajo çfarë dëshirohet të përbushet.

Një tjetër çështje është se si pejgamberëve ashtu edhe *evlijave* u janë dhuruar natyra dhe veti të ndryshme. Si rrjedhojë, veçoria që ka njëri, mund të mos jetë në atë nivel edhe tek tjetri. Ndaj dhe nuk është e drejtë të priten të njëjtat veti nga të gjithë.

Krahas kësaj, kur njeriu bën dua, ndërmjetësimi që bën me pejgamberët dhe besimtarët e devotshëm, pra lutja që bën duke ndërmjetësuar respektin për to

(*tevessuli*), i takon vetëm mëshirës hyjnore. Mirëpo, kur bëhet dua, nuk bëhet duke iu drejtuar atyre, por duke iu drejtuar Allahut nëpërmjet tyre, pasi vetëm prej Allahut kërkohet diçka dhe vetëm duke iu drejtuar Atij bëhet dua.

Kështu, në ajetin kuranor thuhet:

“A nuk e dinë ata se Allahu është Ai që pranon pendimin dhe bamirësinë nga robërit e Vet dhe se Ai është Pranuesi i pendimeve dhe Mëshirëploti?” (Teube, 104)

Disa të tjerë bëjnë gabime aq të mëdha, sa që i hapin shteg shirkut në mënyrë të drejtpërdrejtë duke iu drejtuar besimtarëve të devotshëm në mungesë apo ndërkohë që vizitojnë varrezat: **“O filan! Më shëro! Më ndihmo lidhur me këtë çështje!”** Medoemos duhet shmangur ky gabim i rëndë dhe duhet bërë kujdes i jashtëzakonshëm ndaj këtyre fjalëve apo të ngjashmeve, të cilat lëndojnë besimin e *Tevhid*-it. Duhet larguar me forcë nga çdo lloj shprehjeje që bën të ditur sikur është një tjetër përveç Allahut që ka fuqi absolute të menaxhohet shqetësimet materiale apo shpirtërore të njerëzve.

Kjo ngjarje tregon qartë faktin që vetëm nga Allahu duhet kërkuar ndihmë dhe përkrahje:

I Dërguari i Allahut (a.s.) dëshironte dhe ishte këmbëngulës që të bëhej prej myslimanëve mbrojtësi i tij dhe i myslimanëve, i cili ruante për vite të tëra ata në mënyrë sakrifikuase, xhaxhai i Resulullahut (a.s.), **Ebu Talibi**. Pas kësaj këmbënguljeje të nipit të tij, Ebu Talibi iu drejtua duke i thënë:

“Unë e njoh të vërtetën tënde. Mirëpo, nëse unë ty do të të besoj, gratë e Kurejshit mua më turpërojnë!” Pra, të vërtetën që e pranonte në mënyrë të ndërgjegjshme, nuk mundej ta shprehte pasi ishte i mundur para ndjenjës së *racës prioritare*, ndjenjë e cila dominonte në atë kohë. Fjala e fundit e Ebu Talibit drejtuar Resulullahut (a.s.), ishte:

“Unë po vdes mbi fenë e vjetër (fenë e Abdulmuttalib-it). Sikur Kurejshit të mos thoshin

“A nuk e dinë ata se Allahu është Ai që pranon pendimin dhe bamirësinë nga robërit e Vet dhe se Ai është Pranuesi i pendimeve dhe Mëshirëploti?”

(Teube, 104)

se e ndërroi fenë ngaqë kishte frikë vdekjen, do të pranoja fjalët e tua!..”²

Pas kësaj, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Për sa kohë që nuk më pengojnë, unë do të vazhdoj të bëj istigfar për ty!”¹ dhe u nda i mërzhitur nga shtëpia e xhaxhait të vet.

Për shkak se Resulullahu (a.s.), kishte thënë shumë i mërzhitur për xhaxhain: “Do të bëj istigfar për ty!”, në ajetin kuranor u tha kështu:

“Vërtet, ti (Muhamed) nuk mund të udhëzosh kë të duash, por është Allahu Ai që udhëzon kë të dëshirojë. Ai i njëj më mirë ata që janë të udhëzuar.”

(Kasas, 56)³

Kjo do të thotë se përpjekja e vetë pejgamberëve madje, pa ndihmën e Zotit, nuk mjafton për të udhëzuar dikë në fenë e vërtetë. Nëse Zoti i Madhëruar dëshiron, atëherë i dhuron begatinë e ndikimit, bën që të arrihet përfundimi pozitiv, ashtu sikundër nëse Ai nuk dëshiron, atëherë nuk realizohet me përfundim pozitiv.

NËSE ALLAHU NUK E KA CAKTUAR ASHTU...

Sërish disa myridë, brenda një ekzagjerimit të dashurisë ndaj murshidit, me një emocion të shfrenuar, shprehen: **“Murshidi im di gjithçka!”**. Padyshim që edhe ky është një perceptim i mangët dhe problematik.

Ndaj dhe **Pejgamberit të dashur** (a.s.), i bëheshin pyetje dhe Pejgamberi (a.s.), përgjigjej: **“Ai që pyetet nuk di më shumë sesa di ai që pyet.”**⁴

Shejh Sadiu, në veprën e tij **“Gjylistani”**, thotë:

“Një njeri pyeti **Jakupin** (a.s.):

- O Pejgamber me zemër të ndriçuar dhe njeri i zgjuar! Si ndodhi vallë që arrite të ndjesh duke u kthyer nga Egjipti aromën e këmishës së Jusufit dhe nuk arrite ta shohësh atë, ndërkohë që po e hidhnin në pus, mu aty pranë teje?

1. Duke u nisur nga ky istigfar i Pejgamberit, myslimanët nisën të bënin istigfar për etërit e tyre mushrikë, ndaj dhe përmes ajetit 113 – 114 të sures Teube u ndalua një veprim i tillë. (Shih. Taberiu, Tefsir, XI, 31.)

Jakubi (a.s.), përgjigjet:

- Dhuratat hyjnore që na jepen neve, janë si vetëtimat. Të vërtetat, ndonjëherë na shfaqen dhe ndonjëherë na fshihen!”

Pra, nëse Zoti i Madhëruar e hap perden, njeriu shikon, por nëse Ai e mbyll, atëherë njeriu as gropën që gjendet mu përballë tij mund të mos e vërejë. Që do të thotë se në çfarëdolloj stadi shpirtëror qoftë njeriu, ai është i mangët dhe nevojtar. Gjithnjë ka nevojë për ndihmën e Zotit të Madhëruar.

NUK KA NJERI PA GABIME

Sërish disa myridë, duke e tepruar me dashurinë që kanë ndaj murshidit, mund të mendojnë gjëra si: **“Murshidi im nuk gabon kurrë!”** Padyshim që edhe ky është një perceptim i gabuar.

Pasi, edhe **Ebu Bekri** (r.a.), i cili, sipas shumë transmetimeve, konsiderohej si më i miri i ymetit, pas Pejgamberit, në hytben që ka mbajtur pasi u zgjodh Kalif, paraqiti një masë të mrekullueshme ekuilibri:

“O njerëz! Tashmë jam zgjedhur Kalifi juaj, duke mos qenë vërtet njeriu më i mirë në mesin tuaj. Më ndihmoni vetëm nëse do të jem duke e kryer siç duhet këtë detyrë. Nëse do të jem duke bërë veprime të gabuara, tregomani rruqën...”

Për sa kohë që unë ndjek Allahun dhe Pejgamberin (a.s.), edhe ju më ndiqni mua! Nëse unë nuk i ndjek ata, atëherë as ju nuk duhet të më ndiqni mua!..”⁶

Nëse njeriu më i virtytshëm i ymetit shprehet kështu, po ata që duhet ta marrin shembull atë çfarë duhet të mendojnë vallë?

Sërish një nga **murshidi kamil**-ët e mëdhenj, **Maz’har Xhani Xhanan** (rahimehull-llah), përpiquej që çdo punë e tij të ishte në përshtatje me Traditën Profetike. Megjithatë, duke u treguar tejet modest, u shpreh në këtë mënyrë:

“Kushdo që vëren nga unë që bëj punë, të cilat nuk përputhen me gjykimin islam, le të më qortojë menjëherë!”⁷



MOS U MBURR, O NJERI..

Sërish tek disa njerëz, duke e ekzagjeruar dashurinë ndaj rrugës shpirtërore, pjesë e së cilës janë, shprehen: **“Më gjynahqari i rrugës sonë mund t’ua bëjë shefaat dyzet vetëve, kurse ata që kanë kapur nga një cep të rrobës së murshidit, do të hyjnë direkt në Xhenet”**. Këto lloj shprehjesh nuk kanë se si të shpjegohen normalisht me gjykimin e sheriatit, pasi janë të pabaza, janë joburimore, janë plot marrëzi dhe spekulim.

Pikësëpari duhet të bëjmë të ditur këtë: shefaati është i vërtetë. Nëse Zoti do, mund t’ua dhurojë atyre njerëzve që zgjedh Ai. Mirëpo, vetëm Allahu e di se kush dhe kujt do t’i bëjë shefaat. Ashtu siç shprehet edhe në ajetin kuranor:

“...Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij?...” (Bekare, 255)

Edhe ky qortim që i bën **Resulullahu** (a.s.), së bijës së vet, **Fatimes** është mjaft domethënës:

“O Fatime, e bija e Muhamedit, i cili është i Dërguar i Allahut! Bëj punë të mira, të cilat Allahu dëshiron! (Përndryshe, mos u siguro, pse babain e ke peygamber!) Sepse unë, (nëse nuk bëni ibadet), nuk mund t’ju shpëtoj nga ndëshkimi i Allahut!” (Ibn Sa’d, II, 256; Buhariu, Menakib, 13 – 14; Muslimi, Iman, 348 – 353.)

Kësisoj, nëse një njeri është i bindur sikur të ishte një rregull hyjnor që do të ketë shpëtimin e amshuar vetëm pse ndjen dashuri, respekt, përfshirje, pjesëmarrje dhe ndjenja pozitive ndaj besimtarëve të sinqertë (evlijave), kjo gjë e dëmton shpirtërisht atë njeri.

Një nga çështjet që edhe zemrat e evlijaullahut u janë dridhur është frika se do të merren në llogari përpara Allahut për shkak të komplimenteve të tepruara të të tjerëve ndaj tyre. Ndaj dhe Ebu Bekri (r.a.), kur dëgjonte tek e komplimentonte ndonjëri, menjëherë i përgjerohej Zotit të Madhëruar, duke i thënë:

“Allahu im! Ti më njeh mua më mirë se sa e njoh unë veten time. Edhe unë e njoh veten time më mirë se sa më njohin ata mua. Allahu im! Bëmë më të mirë se sa ata mendojnë për mua! Falmi gjynahet e mia,

të cilat ata nuk i dinë dhe mos më merr në llogari për ato çfarë thonë ata!”⁸

Me të njëjtën frikë, i nderuari **Halidi Bagdadi** kishte lënë amanet që të mos shkruheshin komplimente mbi gurin e varrit.

Ja pra, ata njerëzit e vërtetë të Tasavvufit, janë ata besimtarë që u dridhen zemrat.

Kjo nuk duhet harruar kurrë, që të krishterët, duke e tepruar me nderimin ndaj peygamberit të tyre, e prishën besimin e *Tevhid*-it të fesë së tyre dhe i kanë bërë shirk Zotit të Madhëruar. Kështu, **Pejgamberi (a.s.)**, duke i tërhequr vëmendjen ymetit, tha:


“Mos bëni lëvdata të tepruara ndaj meje, sikurse bëjnë të krishterët me Isain, birin e Merjemes. Padyshim që unë jam vetëm një rob i Allahut. Për mua thoni: “Robi dhe i Dërguar i Allahut” (Buhariu, Enbija, 48.)

“Mos më lartësoni më lart sesa grada që kam! Pasi Allahu, para se t’me bënte resul, më bëri rob të Tij.” (Hajthemi, III, 197/4825; Hajthemi, IX, 21.)

As këtë nuk duhet të harrojmë, që: të gjithë njerëzit, përveç peygamberëve, janë të paaftë dhe me të meta. Madje edhe peygamberët, për shkak se janë njerëz, bëjnë ndonjë “lapsus”. Mirëpo, ngaqë i shfaqet orientimi hyjnor, e rregullojnë menjëherë. Urtësi më vete është edhe fakti që edhe vetë peygamberët janë të paaftë, që e kanë të pamundur të përballojnë një fatkeqësi a vështirësi mbi fuqinë njerëzore, pa ndihmën e Zotit, ndaj këshillojnë ymetet e tyre që të bëjnë kujdes lidhur me nderimin e tepruar të tyre.

Kështu që, aq sa është i nevojshëm respekti dhe dashuria ndaj liderëve shpirtërorë, po aq e domosdoshme është kujdesi që duhet bërë që ky respektim të jetë brenda normave të sheriatit. Përndryshe, ata që e teprojnë në këtë pikë, dëmtojnë *istikamet*-in e tyre, si dhe njollosin pastërtinë e rrugës shpirtërore, pjesë e së cilës janë.

Ashtu siç ndodh në çdo fushë, edhe në Tasavvuf janë shfaqur njerëz që kanë abuzuar me vetë mistifizimin islam. Sot, nëse dikush për arsye të egos apo



të ndonjë sëmundjeje shpirtërore thotë: **“Unë jam poli i kohës, jam gavs-i i kohës!..”** Një pretendim i tillë është tejet larg me thelbin e Tasavvufit. Këta janë mburracakë dhe njerëz në kërkim të famës. Gjatë historisë, kritikët kryesorë të këtyre lloj abuzuesish të Tasavvufit, kanë qenë pikërisht njerëzit e vërtetë të Tasavvufit.

Të mos harrojmë se në këtë botë nuk kemi ardhur që të lavdërohem para njëri-tjetrit. Që të gjithë jemi dërguar në këtë botë me qëllim që të kuptojmë pikën e asgjësë (hiçlik) dhe të paaftësisë nga e cila vijmë dhe për të paraqitur robërinë tonë ndaj Zotit të Madhëruar. **Arritja më e madhe në këtë botë ka-limtare është të mund të bëhemi robër të Zotit.**

Pasi të kemi bërë gjithë përpjekjen tonë, i mbështetemi vetëm mëshirës, faljes dhe ndihmës së Zotit tonë lidhur me përfundimin tonë.

TASAVVUFI ËSHTË TË MBASH EKUILIBRIN FRIKË – SHPRESË

Që të gjithë ne duhet të marrim mësim nga kjo ngjarje që ka ndodhur në Epokën e Lumturisë:

Osman bin Muadhi (r.a.), i cili ishte një nga sahabët më asketë dhe të devotshëm, kish-te vdekur në Medine, në shtëpinë e një gruaje që quhej **Ummul-Ala**. Kjo grua tha:

“O Osman! Mund të dëshmoj që tani Allahu i Madhëruar duhet të jetë duke të shpërblyer.”

Resulullahu (a.s.), i ndërhyr dhe i thotë:

“Ku e di ti, se Allahu tani po e shpërblen atë?”

“Nuk e di, pasha Allahun!” – tha ajo.

Atëherë, Resulullahu (a.s.), tha:

“Shikoni, Osmani ka vdekur. Unë vetë po shpresoj që Allahu t’i japë mirësi. Mirëpo, megjithëse jam peygamber, unë nuk e di se çfarë do të ndodh me mua e as me ju.”

Ummul-Ala tha:

“Pas kësaj ngjarjeje, nuk thashë me asgjë (lidhur me të ardhmen e) askujt.” (Buhariu, Tabir, 27.)

Pasi askush përveç peygamberëve dhe atyre që u

është dhënë kjo e dhënë, nuk ka garanci se a do ta përmbyllë këtë jetë me apo pa iman. Ndaj dhe në Kuranin Famëllartë dhe në hadithe, përmenden si ata që dështojnë për të hyrë në Xhenet, duke qenë një pëllëmbë afër, po ashtu edhe e kundërta, ekzistojnë edhe njerëz që do të mëshirohen duke qenë një pëllëmbë para se të hyjnë në Xhehenem.

Nga kjo fjali, kuptojmë edhe atë që ka ndodhur me Bel’am bin Baura, pasi ai kishte mbërritur në stadin që kishte mundësi të shikonte dhe të lexonte edhe Lehvi Mahfudhi-n, porse ai duke u mundur nga nefsi i vet, pësoi disfatën e tmerrshme.⁹ Ky shembull nuk duhet harruar kurrë.

Edhe Karunit Allahu i Madhëruar i kishte dhënë plot mirësi, asketizmin dhe devotshërinë. Madje ishte njeriu që e lexonte më së miri Tevratin dhe që e komentonte atë. Mirëpo, kur Allahu i dha thesare plot me pasuri, si një provë, në vend që kjo pasuri ta afronte më pranë Allahut, e largoi atë nga Zoti i tij. Si përfundim, u varros në fundin e dheut, bashkë me thesaret e tij, që i kishte besuar aq shumë.

I nderuari Halidi Bagdadi pati thënë:

“...Nuk dihet se kush do të shpëtojë në frymën e fundit. Sa e sa *fasikë* e *faxhîrë* ka që janë bërë të tillë pasi ishin veli të përsosur! Sa e sa njerëz të drejtë kishte që u bënë më të poshtëruarit...” (10). Në shumë letra të tij, Halidi Bagdadi bënte dua që ta jepte me iman frymën e fundit.

Pra, në rrugëtimin shpirtëror nuk ekziston ndonjë gjë si: **“Tashmë unë kam arritur përsosjen”**, apo t’i atribuosh vetes ndonjë gradë shpirtërore, duke u treguar mendjemadh dhe kryelartë. Përkundrazi, ajo çfarë duhet është që të shikosh veten gjithnjë si një njeri me të meta dhe që ke plot aspekte për të ndrequr. Ndaj dhe njerëzit e mëdhenj *arif-ë* kanë thënë: “Nuk mund të ketë *irfan* më sublim sesa të dish të metat e tua.”

Edhe peygamberët që kishin garancinë hyjnore madje, lidhur me ahiretin i janë mbështetur vazhdimisht mëshirës hyjnore që të jenë mes **“havf ve rexha/frikë dhe shpresë”**. Për shembull, **Ibrahimi**



(a.s.), i cili ishte *miku/halil* i Allahut, kaloi sprovat e pasurisë, jetës dhe fëmijës, megjithatë ai përgjerohej i frikësuar:

“Mos më turpëro në Ditën, kur do të ringjallen njerëzit.” (Shuara, 87)

Ndonëse njeriu i dashur i Allahut, **Muhamedi (a.s.)**, i kishte të falura të gjitha gabimet, të shkuara apo që do të bënte, ai sërish bënte istigfar gjithë natën, gjer në mëngjes.

Asnjëri nga **“ashere mubeshshere”**, pra nga sahabët e përgëzuar me Xhenet qëkur ishin në këtë botë, nuk kanë pakësuar adhurimet ndaj Zotit, duke u bazuar në këtë përgëzim, kurrë s’kanë shprehur asnjë shenjë krenarie e as mburrjeje. Përkundrazi, kanë kaluar një jetë të tërë shembullore, plot ibadete.

Sa shembull i bukur që është kjo ngjarje për të treguar se sa të kujdesshëm ishin sahabët:

Selman Farisiu (r.a.), ishte një personalitet aq i rrallë dhe i shkëlqyer në çdo aspekt, por veçanërisht ishte aq sakrifikues në rrugën e Allahut, sa ensarët dhe muhaxhirët thoshin:

“Selmani është prej nesh.” Ata nuk donin t’ia linin njëritjetrit, saqë nisën të diskutonin në këtë pikë. Resulullahu (a.s.), për të qetësuar këtë situatë dhe për ta gëzuar Selmanin (r.a.), tha:

“Selmani është prej nesh, prej Ehli Bejtit!” (Hakimi, III, 691/6541; Hejthemiu, VI, 130; Ibn-i Hishami, III, 241; Ibn-i Sa’d, IV, 83.)

Me gjithë këtë përgëzim profetik, ai sahab i nderuar ka jetuar brenda një atmosfere plot modesti dhe zemra e tij gjithnjë i është dridhur nga frika ndaj botës tjetër.

Një ditë, kur dy persona i dhanë selam **Selmanit** (r.a.) dhe i thanë:

“A je ti sahabiu i Resulullahut (a.s.)?”

Ai qe përgjigjur:

“Nuk e di.”

Ndërkohë pyetësit u habitën se mos kishin ngatërruar njeri, por s’kaloi shumë dhe Selmani (r.a.), u

shpjegua në këtë mënyrë:

“-Unë kam parë Resulullahun (a.s.). Kam qenë pjesë e tubimeve të tij. **Mirëpo, sahab i vërtetë është ai njeri që hyn bashkë me të në Xhenet.**” (Hajthemiu, VIII, 40 – 41, Dhehebiu, Sijer, I, 549.)

Kështu pra, sahabët e nderuar nuk ishin vetëm sahabë me fjalë, por edhe në thelb dhe në vepra. Në çdo gjendje, ishin të lidhur me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Megjithatë, kurrë nuk e kanë konsideruar veten si të shpëtuar dhe vazhdimisht kanë qenë të dhënë pas ibadeteve. Kjo gjendje e tyre duhet të jetë shembull për të gjithë besimtarët.

Vlera shpirtërore e njeriut në mënyrë të vërtetë do të shfaqet në botën tjetër. Dhe ajo çfarë i bie përsipër njeriut është të vazhdojë të bëjë adhurime brenda ndjenjës së të qenit asgjë dhe i paaftë. Ne duhet që çdo frymë të jetës sonë ta përjetojmë nën dritën e Kuranit dhe Sunetit si fryma e fundit dhe nuk duhet ta harrojmë duanë e Jusufit (a.s.), i cili përgjerohej:

“O Zoti im! Ti më ke dhënë pushtet dhe më ke mësuar shpjegimin e ëndrrave! O Krijues i qiejve dhe i Tokës, Ti je Mbrojtësi im edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër! Bëj që të vdes si mysliman dhe më shoqëro me punëmirët (në botën tjetër!)” (Jusuf, 101) Nuk duhet ta harrojmë se në çfarë-

dolloy stadi që të jemi, jemi të paaftë të përcaktojmë fundin e të tjerëve dhe të vetes sonë. Në këtë çështje kemi nevojë për mëshirën, faljen dhe ndihmën e Zotit Fuqplotë.

Le të na bëjë fundin tonë të mirë Zoti ynë...

Amin!..

Shënimet: 1) Ibn-i Sa’d, II, 266-272; Buhârîu, Megâzî, 83; Hejthemiu, IX, 32; Abdurrezâku, V, 436. 2) Buhârîu, Xhenâiz 81, Menâkibu’l-Ensâr 40; Ibn-i Sa’d, I, 122-123. 3) Buhârîu, Tefsîru’l-Kur’ân, 28/1; Muslimi, Iman, 39, 41-42; Ahmed ibn-i Hanbeli, *Musned*, V, 433. 4) Shih. Muslimi, Iman, 1. 5) Shih. Ali el-Muttakî, *Kenzu’l-Ummâl*, XI, 549/32578; Ibn-i Mâxhe, *Mukaddime*, 11/106; Ahmedi, I, 127, II, 26. 6) Ibn-i Sa’d, III, 182-183; Sujûtîu, *Târîhu’l-Hulefâ*, f. 69, 71-72; Hamîdullah, *islâm Peygamberi*, II, 1181. 7) Abdullah Dehlevî, *Makâmât-ı Mazharije*, f. 43. 8) Sujûtîu, *Târîhu’l-Hulefâ*, s. 104. 9) Shih. el-A’râf, 176. 10) Es’ad Sâhib, *Bugjetu’l-Vâxhd*, f. 120-121, nr: 16.

*“O Fatime,
e bija e Muhamedit,
i cili është i Dërguar i Allahut!
Bëj punë të mira, të cilat
Allahu dëshiron! (Përndryshe,
mos u siguro, pse babain e ke
pejgamber!) Sepse unë, (nëse
nuk bëni ibadet), nuk mund
t’ju shpëtoj nga ndëshkimi i
Allahut!”*



Bota

Sipas transmetimit të **Ebu Said el-Hudra**-së (r.a.), Pejgamberi ynë i dashur ka thënë:

“Kam frikë që pasi të iki unë nga kjo botë, ju do të lidheni shpirtërisht pas dhuntive të kësaj bote.”

Pas kësaj, njëri nga sahabët e pyeti:

- O Resulullah! Pse keni kaq frikë, ndërkohë që qetësia ekonomike dhe bollëku nuk kanë pse të sjellin gjëra të këqija?

Ndërsa Pejgamberi (a.s.), i ktheu këtë përgjigje:

“Vërtet pasuria nuk sjell fatkeqësi; por bëhet shkak për një gjë të tillë. Vini re! Në mesin e barërave që mbijnë në pranverë, ekziston një lloj helmues i tyre. Kafsha që ha prej saj, ngordh ose shkon drejt ngordhjes. Por bari jeshil nuk është i tillë. Nuk ekziston rrezik ngordhjeje për kafshën që ushqehet me të. Ajo kafshë ushqehet me atë bar jeshil, ha derisa ngopet, sillet nga dielli dhe merr rreze, pastaj lehtësisht bën jashtëqitjen dhe më pas sërish sillet dhe nis të hajë bar.”

Kështu joshës dhe i ëmbël është edhe malli i kësaj bote. Sa njeri i mirë që është myslimani që këtë pasuri e fiton në rrugë të lejuar dhe një pjesë të saj e ndan vetëm për hir të Allahut, me jetimët, nevojtarët dhe me ata që kanë mbetur në rrugë! Ai që nuk e fiton nëpërmjet rrugës së lejuar, është si një llupës që nuk di të ngopet. Kjo pasuri e tij në Ditën e Kiametit do t'i sillet përreth qafës dhe do të dëshmojë kundër tij.”

Nga **Abdullah bin Omeri** (r.a.), transmetohet:

Njëherë, Resulullahu (a.s.), më kapi në dy supet dhe më tha:

“O Abdullah! Në këtë botë ji porsì një i huaj, porsì një udhëtar kalimtar.”

Njëri nga ravi-të e këtij hadithi, **Lejsi**, tha që: **Ibn Omeri** më tha kështu:

- O Lejs! Kur mbërrin mbrëmjen, mos shih mëngjesin. Kur mbërrin mëngjesin, mos prit mbrëmjen. Një pjesë të kohës kur je mirë me shëndet ndaje për kohën kur je i sëmurë. Një pjesë të jetës, ndaje për vdekjen.

Thuhet se, Iblisi (mallkuar qoftë), çdo ditë e çon dynjanë me dy duart e tij dhe thotë:

- Kush e blen prej meje këtë dynja, që njeriut i bën dëm, që nuk i bën dobi, që e mërzit dhe që nuk e bën të lumtur?

Njerëzit e lidhur pas dynjasë i thonë:

- E blejmë ne.

- Mos nxitoni. – u thotë Shejtani, pasi ajo ka disa gjynahe.

- S'ka gjë. - i thonë.

- Nuk e ka çmimin kundrejt disa dirhemëve apo dinarëve. Por, kundrejt Xhenetit tuaj. Pasi unë këtë e kam marrë kundrejt katër gjërave: mallkimit dhe zemërimit të Allahut si dhe kundrejt shkëputjes së lidhjes së Tij prej meje. Si kundërvlerë të këtyre shes Xhenetin.

Njerëzit e dhënë pas botës, i thonë:

- Jemi dakord, pranojmë.

Pas kësaj, Shejtani thotë:

- Dua që të më jepni pak qar prej tyre. Dhe kjo është: të veçoni një vend në zemrën tuaj për këtë botë dhe të mos e nxirrni kurrë atë nga zemra.

Sërish ata pranojnë. Pastaj Shejtani shton këto:

- Sa tregti e shëmtuar që është kjo! (Fatiha Suresi Tefsiri, Mahmud Sami Ramazanogllu)

Padyshim që për një rrugëtar të së vërtetës, kur të pastrojë zemrën e tij të butë, ajo do të jetë vatra e dashurisë.

Ata që i hedhin në praktikë parimet e fesë, bëjnë që hap pas hapi të ngjiten lart dhe të mbushin zemrat e tyre me nurin e urtësisë.

Ebu Bekir es-Siddik-u bënte dua në këtë mënyrë:

- Allahu im! Shtroma dynjanë para meje dhe bëmë *zahid/asket* në të. Mos ma zbukuro dhe mos më bëj që të lidhem pas saj!



MALLKUAR QOFSHIN KRIMINELET!

Ali Riza Temel

Cilësia më e keqe për një njeri është cilësia **“vrasës”**. Edhe sikur njeriu të përballët për t’u vetëmbrojtur, me situatën mes të qenit **“vrasës”** apo **“i vrarë”**, njeriu zgjedh të jetë **“i vrarë”**.

Vrasja si veprim nisi me **Kabil**-in, birin e Ademit. Kurse viktima e parë ishte **Habil**-i, fëmija tjetër i Ademit. Besimtari i vërtetë nuk do kurr që të bie në gjynahun e vrasjes. Kur Sad b. Ebi Vakkas-i tha: **“O i Dërguar i Allahut! Nëse në kohë trazirash dikush hyn në shtëpinë time, atëherë çfarë duhet të bëj unë?”**, Resulullahu (a.s.), i tha: **“Bëhu si njëri nga dy fëmijët e Ademit (si Habil).”** (Ebu Davudi, Nr. i hadithit: 4257.) Muhamed bin Musejlemesë, i cili i kishte bërë të njëjtën pyetje, Resulullahu (a.s.), i qe përgjigjur: **“Mbuloje fytyrën dhe rrobën tënde dhe mos u bëj njeriu që vret, por ai që vritet.”** (F. Raziu, Tafsir, II/163.) Një sjellje e tillë është një përpjekje për të mos lënë portretin e fundit si vrasës, pasi të ketë bërë përpjekjen maksimale dhe jo për të braktisur vetëmbrojtjen përballë vrasësit. Kjo është një çështje zgjedhjeje. Fjala vjen, Osmani këtë sjellje ka preferuar, në vend që të vdisnin shumë njerëz, zgjodhi që të ishte ai dëshmor. Edhe Pejgamberi (a.s.), e ka këshilluar një veprim të tillë, por nuk e ka urdhëruar. Kjo sjellje është sjellja prej të devotshmit, është sjellja e Habilit, i cili ishte njeri i devotshmërisë.

Kabili, të cilit nuk iu pranua kurban, iu drejtua Habilit duke i thënë: **“Ty gjithsesi do të të vras”**. Tjetri tha: **“Allahu pranon vetëm prej të devotshmit. Nëse ti ngre dorë të më vrasësh mua, unë nuk do ta ngre dorën që të të vras, sepse, në të vërtetë, unë i frikësohem Allahut, Zotit të gjithësisë.”** (Maide, 27 – 28)

Kjo ngjarje atë e bëri vrasës, ndaj dhe Kabili është i mallkuar deri në Kiamet. Lidhur me këtë çështje, Pejgamberi (a.s.), ka thënë: **“Nuk ka njeri në këtë botë që të jetë vrarë në mënyrë të padrejtë dhe që një pjesë nga gjynahu i vrasësit të mos shkojë për djalin e madh të Ademit (Kabilin), sepse ai është personi i parë që i hapi rrugën vrasjeve.”** (Buhariu, Xhenaiz, 33; Muslimi, Kaseme, 27.) Ashtu siç edhe shpjegohet në hadithe, ata që u hapin rrugë punëve të mira apo të këqija, do të marrin pjesë nga shpërblimi apo ndëshkimi edhe i atyre që i zbatojnë ato mbraja tyre.

Njeriu është vepra e vyer e Allahut, mëkëmbësi i Tij. Gjithçka merr kuptim me njeriun. Çdo njeri është një ekzemplar më vete. Mundet që njeriu të jetë i vogël për arsye të gjynaheve, por brenda tij mban një gjithësi të tërë. Një njeri mund të udhëheqë të gjithë njerëzit. Ndaj dhe të vrasësh një njeri është sikur të vrasësh mbarë njerëzinë. Ky fakt shprehet në këtë mënyrë në Kuranin Famëlartë: **“...kush vret ndokënd, që s’ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve. Të dërguarit tanë u sollën shenja të qarta, por shumë nga ata, edhe pas kësaj, i kaluan tërë kufijtë me të këqija në Tokë.”** (Maide, 32)

Se sa përgjegjësi e madhe është të vrasësh një njeri tregohet kështu në një hadith: **“Sikur krijesat e qiellit me ato të tokës të bëheshin bashkë për të vrarë një besimtar, Allahu ata që të gjithë përnjëherësh do t’i çonte në Xhehe-nem.”** (Tirmidhiu, Dijat, 8.)

Në një tjetër hadith, Pejgamberi (a.s.), tha kështu: *“Vrasja e besimtarit në mënyrë të padrejtë është më e tmerrshme sesa sheshimi i tërë botës.”* (Nesai, Tahrim, 1.)

Vrasja është e ndaluar sipas të gjitha feve hyjnore. Vrasja është në mesin e gjynaheve të mëdha. E drejta për të jetuar është një nga të drejtat themelore të njeriut. **“Mos ia merrni jetën njeriu, gjë që Allahu jua ka ndaluar ta bëni...”** (Isra, 33)

“Ju keni dëgjuar çfarë u qe thënë të lashtëve: **“Mos vrisni!”**; dhe: “Kushdo që vret do t’i nënshtrohet gjyqit” por unë ju them: Kushdo që zemërohet pa shkak kundër vëllait të tij, do t’i nënshtrohet gjyqit...” (Mateu, 5/21-22.)

Mosvrasja është një nga dhjetë urdhëresat e Tevratit/Dhjatës së Vjetër (Eksodi, 20/13). “Mos keqtrajto të huajin dhe mos e mundo, sepse edhe ju ishit të huaj në vendin e Egjiptit.” (Eksodi, 22/21.)

Duke qenë kaq të qarta gjykimet, as bota islame, as ajo e krishterë e as ajo hebraike nuk respektoi urdhrat hyjnore. Zhvillimi që po bëhet në sektorin e armëve asgjësuese në ditët e sotme solli me vete vrasjet dhe asgjësimet masive, ndaj dhe thuajse ky shekull u shndërrua në **“epokë të vrasjeve”**. Në këtë botë gjoja të civilizuar, paratë që po harxhohen për të vrarë, nuk po harxhohen për të jetuar. Sikur një e dhjeta e parave që investohet për t’u armatosur, të shpenzohej për shëndetin dhe për të ndaluar skamjen do të kishim të bënim me një botë më në mirëqenie dhe më të shëndetshme. Në një mjedis ku lulëzon kapitalizmi i egër dhe materializmi i vrazhdë, shtypen të pafuqishmit dhe nuk u vihet veshi atyre. Njerëzit që gjithnjë e më shumë po bëhen përbindësia, për të jetuar në një jetë plot luks dhe israf, as që e përfillin skamjen e tjetrit. Sot ndoshta është ndërprerë raca e kanibalëve që ushqeheshin vërtet me mish njeriu, por kanibalët modernë, të cilët përmes tregtisë së armëve dhe shfrytëzimit të tjetrit, në mënyrë të tërthortë po hanë mishin e njeriut dhe po i pinë gjakun atij janë shtuar shumë.

Dikur, të paktën në sheshet e gladiatorëve kishte dyluf-time trimash. Kishte një rregull mbi vdekjen dhe vrasjen. Kurse sot gjithçka ndodh në mënyrë djallëzore, me plot mashtrime. Po përdoret forcë jo proporcionale. Po bombardohen qytete, pa pyetur nëse janë fëmijë, gra, pleq a të sëmurë, po fshihet një histori e tërë, po shkatërrohen bimët, kafshët dhe çdo gjë e gjallë.

Shkaku përse mora të shkruaj këtë shkrim është arsyeja e tablosë së frikshme që ka kjo situatë, sionistët që vrasin njerëz të pafajshëm, fëmijë, gra, të rinj e të reja, pleq e të sëmurë në Gaza dhe një botë e tërë qëndron e heshtur sikur nuk po ndodh asgjë, pa harruar këtu edhe disa myslimanë të tjerë, që gjoja në emër të Allahut (!) vrasin njëri – tjetrin e njerëz të pafajshëm dhe për inerci të gjitha këto ndodhin në muajin e begatë të Ramazanit.

Ç’faj kanë vallë fëmijët e vegjël të hedhur përtokë, me trup të copëtuar, nga bombat sioniste që u ra papritmas mbi kokën e tyre, ndërkohë që po luanin në bregdetin e Gazas, të cilët po ëndërronin në botën e tyre të ylbertë? Ç’dallim ka vallë mes beduinëve, të cilët në periudhën e

inJORANCËS varrosnin për së gjalli vajzat e tyre dhe gjoja të qytetëruarve të sotëm që vrasin fëmijë me bomba? Hebreu që i dha të pinte fëmijës së vogël benzinë dhe e dogji për së gjalli atë, ç’të drejtë ka vallë të ankohet nga Hitleri që i dogji ata në dhomat e gazit? Deputetja e parlamentit izraelit, e cila i donte të vdekura të gjitha nënat palestineze, me ç’fytirë mund të flasë ajo për viktimizimin e tyre? Ndërkohë që në Tevrat/Dhjatën e Vjetër, thuhet: **“Nuk do të vrasësh!”** “Mos keqtrajto të huajin dhe mos e mundo, sepse edhe ju ishit të huaj në vendin e Egjiptit”, si mund të shpjegohet ky qëndrim ndaj të huajve?

Kushti minimal i të qenit njeri është që të mos dëshirosh për tjetrin atë që nuk e dëshiron për veten. Çdo njeri ka zemër, vuan, mërzhitet. Fëmijët e Ademit/Adamit janë si organet e një trupi të vetëm. Nuk janë njerëz ata që nuk ndjejnë vuajtjen e tjetrit. Një kafshë që vret krijesën e të njëjtit lloj apo një tjetër, nuk ndjen ndjesë e as që e vuan një gjë të tillë. Ata që nuk ndjejnë ndjesë dhe që nuk ndjejnë dhimbjen ndaj tjetrit janë edhe më poshtë sesa kafshët. Pasi kafshëve nuk u janë dhënë veçori njerëzore.

Në rërën e bregdetit të Gazas njëkohësisht me vogëlushët e vegjël u varrosën edhe humanizmi dhe vlerat njerëzore. Si mund të ndalen vallë fuqitë zullumqare që nuk njohin as rregulla e as moral? Cilat probleme mund të zgjidhen vetëm përmes fjalimeve të zbukuruara? Për çfarë shërbejnë Kombet e Bashkuara? Këshilli i Sigurisë shërben për sigurinë e vrasësve apo të njerëzve të pambrojtur, të pafuqishëm dhe të dhunuar? Ashtu sikurse ka thënë edhe **Muhamed Ikbali**, duhet dhënë një formë e re botës. Ç’mund të presim nga hajdutët e qefinëve?

Në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut e drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. (Neni 2) Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese. (Neni 3) Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij. (Protokolli shtesë i Konventës, Neni 1) Po mirë, vallë kush do t’ua mbrojtë të drejtën palestinezëve që u janë marrë pasuritë dhe që janë ende sot nën tortura në burgjet izraelite? Kush do t’i mbështesë e t’i mbrojtë njerëzit e pafajshëm dhe të shtypur, që janë detyruar të braktisin vendet e tyre, për arsye të frikës nga vdekja dhe dhuna? Kush do t’u thotë ndal mizorëve që armët të siguruara përmes taksapaguesve të popullit të tyre, ua drejtojnë njerëzve të pafajshëm palestinezë, u hedhin çatinë mbi kokë dhe u bëjnë lloj-lloj mizorish të tjera?

Allahu, që është Rahman dhe Rahim, do ua marrë hakun në Ahiret, aty do të realizohet drejtësia absolute. Mirëpo, ne që jemi në këtë jetë për të zbatuar drejtësinë në këtë botë, nëse nuk u themi ndal këtyre kriminelëve, nëse nuk tregojmë asnjë lloj përpjekjeje në këtë drejtim, a nuk jemi edhe ne atëherë në stadin e bashkëpunëtorit me kriminelin? A mundet vallë që mallkimi që u bëjmë kriminelëve, pa përdorur mundësinë e ndërhyrjes fizike, të na shpëtojë nga përgjegjësia që kemi ndaj Zotit dhe t’i shpëtojë njerëzit e pafajshëm nga vdekja dhe mizoria?



Xhafer Durmush



Vendosmëria në rrugën e drejtë

“Thuaj: “O Zoti im, më shpjer në një hyrje, të kënaqur, më nxirr nga një dalje, të kënaqur dhe më dhuro nga Ti fuqi, që do të më ndihmojë!” (Isra, 80) Që nga çasti kur kjo lutje iu mësuara Resulullahut (a.s.), jeta e besimtarit është ndritur.

Pasi Resulullahu (a.s.), kishte lexuar këtë ajet, pati thënë: *“Mua më plakën surja Hud dhe të tjerat si ajo.”* (Tirmidhiu, Tefsiru sure, 56, 6.) Ai që gjithë jetën e zburonte me lutje. I mbështetej Allahut që Ai ta mbronte prej atyre që duhej frikësuar. I drejtohej Atij që t’i realizojë atë që dëshironte. Ymetit ia mësoi mbështetjen tek Ai, besimin tek Ai, përgjërimin, shpresën prej Tij, ruajtjen nga hidhërimi i Tij dhe gjithçka që ta bënte shoqërinë islame të ishte e lidhur me Zotin. Dhe ia mësoi njerëzimit që, ndonëse kalon tërë jetën me këtë kujdes, sërish të bëjë së paku njëqind herë istigfar në ditë, në kuptimin “po gabova, më fal, o Zot!”...

Ja pra, një njeri kaq i kujdesshëm, urdhërohet të përgjërohet duke thënë: **“O Zoti im, më shpjer në një hyrje, të kënaqur, më nxirr nga një dalje, të kënaqur”**. Ç’kuptim ka vallë?! Këtë po përpiqem ta kuptoj.

Sipas asaj që shpjegohet në **Ruhul-Bejan**, shprehja në ajetin kuranor është kundërvlerë me hyrjen dhe

daljen në mënyrë të pakënaqur.

Kuptimi i “më shpjer/më nxirr”, ngaqë ka prej atyre që mendojnë se ajeti në fjalë është shpallur në periudhën e hixhretit në Medine, ndaj dhe e komentojnë si hyrje në Medine dhe dalje nga Meka. Pasi edhe ajeti: **“Në të vërtetë, ata po përpiqen të të trembin që të të dëbojnë ty nga vendi, por atëherë, ata do të qëndronin vetëm pak kohë pas ikjes sate.”** (Isra, 76) sikur këtë rast nënkupton.

Mirëpo, shumica kanë preferuar të kenë këtë mendim: “Mundësia që të jep Zoti për të hyrë dhe dalë në/nga një vend apo punë.” Në këtë kontekst, kuptimi i ajetit është: “Zoti im! Kudo që të më bësh të hyj apo të dal, bëmë që të jem mbi të drejtën/vërtetën, mos më bëj prej dyfytirëshve, sepse dyfytirëshi nuk është i sigurt dhe nuk të jep besim.”

Me siguri, kuptimi më i gjerë i kësaj duaie është: “Zoti im! Bëmë të mundur që, çfarëdolloj pune që të filloj, ta filloj me drejtësi/vërtetësi dhe kur të hyj në një vend të hyj me të njëjtën drejtësi/vërtetësi. Bëmë të mundur që, kur të përfundoj ndonjë punë, ta përfundoj me drejtësi/vërtetësi dhe bëmë të mundur që, kur të dal prej diku, të dal po me drejtësi/vërtetësi. Kësisoj, bëmë të mundur që të kryej çdo punë dhe të

them çdo fjalë që Ti ta pëlqesh. Bëmë të mundur që të jem mbi të drejtën në fillim e në mbarim të detyrave të mia. Bëmë të mundur që të jem i suksesshëm, duke punuar me drejtësi dhe vërtetësi në kryerjen e detyrës sime si kumtues i fesë së vërtetë!

Si dhe, më ndihmo që, punët që nis me drejtësi t'i përfundoj me sukses në të njëjtën linjë. Jepu një ndihmë të fuqishëm atyre që punojnë në rrugë të Allahut, përballë kurtheve që armiqtë e tyre u kurdisin. Jepu një fuqi që të mundin planet e dashakeqëve, që femohuesit të shkatërrohen dhe të munden përballë manifestimeve të fuqisë Tënde. Le të triumfojnë besimtarët! Ne kemi besim të plotë që e drejta do të triumfojë dhe që padyshim e shtrembra do të humbë.”

Duhet theksuar fakti që lutjet në fjalë, të cilat përbëjnë edhe temën tonë, vijnë menjëherë pas ajeteve që flasin mbi pesë kohët e namazit dhe tehexhuhdin.

Tani, në sajë të Pejgamberit (a.s.), na urdhërohet që të bëjmë dua në këtë mënyrë dhe të qëndrojmë në këtë linjë: vërtetësia duhet të jetë cilësia më e dallueshme e myslimanit dhe pasuria më e patjetërsueshme. Emri i myslimanit duhet përmendur njëkohësisht me të vërtetën; punët e tij duhet të shquhen nga vërtetësia, pasi cilësitë e tjera të myslimanit duhet të ndërtohen mbi themelin e vërtetë-

sisë dhe vetëm në këtë mënyrë marrin kuptimin e vërtetë. Ndihma e Allahut është mbi ato punë/fjalë që fillojnë e mbarojnë me vërtetësi. Për sa kohë që punën/fjalën e ke të vërtetë, do të presësh ndihmën e Zotit të Madhëruar. Myzhdenë që parashikohet në suren Fussilet, të dhurohet vetëm përmes së vërtetës: **“Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt** (para vdekjes) **e do t’u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.”** (Fussilet, 30)

“Të qenit i vendosur në rrugën e drejtë” për të cilën flitet këtu, nga Ebu Bekri (r.a.), e komentuar si të qenit i drejtë dhe i vërtetë në shprehje dhe sjellje; Omeri (r.a.), e ka komentuar si: të mos bësh dyfytërsi; kurse Aliu (r.a.), e ka komentuar si: kryerja e farzeve. Sihariqi **“mos u frikësoni”**, që vjen nga engjëjt, është thënë se ka të bëjë me jetën pas vdekjes dhe me punët e më përparshme. Kurse sihariqi **“mos u pikëlloni”**, është thënë se ka të bëjë me fëmijët dhe familjen.

Si përfundim, për të merituar ndihmën hyjnore në punët e kësaj jete dhe për të qenë prej atyre që përgëzohen në Ahiret, duhet që gjithmonë dhe kudo të jemi të vendosur në rrugën e drejtë.

Lexo-Mendo

Hapja zemrën vëllazërisë


Në ajetin e dhjetë të sures Huxhuratë, gjendja e besimtarëve ndaj njëri – tjetrit, përcaktohet si **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllazër”**, dhe këshillohet: **“andaj pajtojini vëllazërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni.”** Kurse në ajetin 103 të sures Al’ Imran, duke u thënë: **“...Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqtë, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllazër...”**, bëhet e ditur që shpëtimi nga zjarri i fitnesë në dynja dhe nga dënimi i përhershëm në Ahiret do të realizohet përmes klimës vëllazërore.

Pejgamberi ynë i dashur (a.s.), na e mëson duke e renditur në pika, se si ndërtohet dhe jetohet “shoqëria vëllazërore”: asnjëri nuk duhet t’i cenojë të drejtën tjetrit; edhe sikur të ketë vetë nevojë, ai duhet të preferojë që të ndihmojë më parë tjetrin; kurrë nuk duhet ta lërë pa ndihmë vëllain e tij, edhe sikur të

jetë shtypës apo i shtypur; nuk duhet të lejojë që të flitet për tjetrin në mos prezencë.

Sikur t’i vendosim përpara këshillat profetike lidhur me vetëm këtë çështje, më besoni që mund të arrijmë në një zemër të ngrohtë që do të përfshijë të gjithë gjeografinë islame dhe ndoshta mbarë njerëzimin, duke përjashtuar armiqtë e përbetuar të Allahut. Do të mund të hapim moton e të dashurit të krijesave, për hir të Krijuesit të tyre. Le ta kujtojmë se ne jemi vena kryesore që ushqejmë vetëdijen e ymetit. Le t’i bartim në aktualitetin tonë me një emocion të ri ajetet dhe hadithet që kanë qëndisur vëllazërinë fetare. Jo ato që na bëjnë të ndryshëm, por le t’i zmadhojmë dhe zhvillojmë ato që i shërbejnë unitetit dhe bashkimit.

Aty ku ka ndonjë dhimbje, do të thotë që nuk paskemi arritur të bartim në mënyrë të vërtetë virtutet e Islamit.



Sahabiu "muhaxhir dhe ensar"

ZEKVAN IBN ABDIKAJS

(radijall-lahu anhu)

Zekvan ibn Abdikajs (r.a.), ishte një nga njerëzit guximtarë të parë që u takua me Resulullahun (a.s.), në Akabe dhe që përqafoi Islamin!.. Ishtë një nga sahabët e parë medinas, që kishte vajtur në Mekë dhe ishte bërë mysliman që në ditët e para të Islamit!.. Ai është një njeri fatlum që njihet edhe si muhaxhir edhe si ensar!..

Zekvan ibn Abdikajs (r.a.), lindi dhe u rrit në Medine. I përkiste tribusë së nipërve të Amir ibn Zurejk të fisit Hazrexh. Ai ishte ndriçuar me Islam në këtë mënyrë:

"Me njërin nga aristokratët e Medines, Es'ad ibn Zurare-n, patën diskutuar mbi një çështje dhe nuk patën rënë në ujdi. Për t'i gjetur një zgjidhje vendosën të shkonin në Mekë dhe të caktonin si gjykatës njërin nga paria e mushrikëve atje, Utbe Ibn Rebia-në.

Kur shkuan në Mekë, Utbe bin Rebia i këshilloi në këtë mënyrë: "Nga mesi ynë ka dalë një person me emrin Muhamed. Duke pretenduar se është pejgamber, bëri që të ngatërrohemi me njëri – tjetrin. Ai po përpiqet të na largojë nga rruga e etërve tanë dhe mohon ekzistencën hyjnore të idhujve. Vetëm me atë mos u konsultoni. Fjalët e tij janë pors magji. Qëndrojeni larg atij. Mos flisni me të."

Zekvani dhe Es'adi kishin dëgjuar se kishte ardhur pejgamberi i fundit. Ata ishin kureshtarë dhe të interesuar për këtë çështje. Nuk e dëgjuan porosinë e Utbe-së dhe duke bërë kujdes pyetën për Resulullahun (a.s.), e gjetën dhe shkuan pranë tij. Krenaria e gjithësisë (a.s.), u lexoi atyre pjesë nga Kurani. Bisedoi me ta dhe ua shpjegoi Kuranin. U propozoi atyre që të hynin në Islam.

Zekvan ibn Abdikajs dhe Es'ad ibn Zurare u ndikuan nga biseda që bënë me të Dërguarin e Allahut (a.s.), në zemrat e tyre lindi një ndryshim i papritur. Zemrat e tyre u mbushën me një prehje të thellë. Nuri i besimit hyri në zemrat e tyre dhe pa aspak dyshim përqaftuan Islam, duke thënë shehadetin/fjalën e dëshmisë dhe u kthyen në Medine si myslimanë. (Ibni Sa'd, I, 218.)

Këta dy djem guximtarë të Medines nisën fillimisht të predikonin Islam në fiset e tyre. U përpoqën ta shpjegonin se kush ishte pejgamberi i fesë së fundit. Ata u bënë shkak që shumë njerëz të shkonin në Mekë dhe të takoheshin me Pejgamberin (a.s.).

Zekvan ibn Abdikajs (r.a.), ishte njëri nga grupi gjash-të vetësh që u takua me Resulullahun (a.s.), në Akabe, në vitin 620. Edhe në vitet 621 dhe 622 ishte pjesë e marrëveshjeve të Akabe-ve.

Zekvan ibn Abdikajs (r.a.), ishte njëri nga ata djem guximtarë që e përgatitën Medinen për hixhret. Në ditët e hixhretit, kur erdhën në Medine muhaxhirët e parë, kuptuan se sa sevap i madh është bërja e hixhretit. Për të përfituar edhe Zekvani nga ky sevap kaq i madh, shkoi në Mekë dhe u vendos aty. Për një kohë të caktuar qëndruan aty bashkë me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Pastaj, u bë pjesë e një grupi që po emigronte për në Medine dhe bëri edhe ai hixhret. Kështu, ai u konsiderua edhe prej ensarëve edhe prej muhaxhirëve. Që ato kohë,

në mesin e sahabëve ai njihej si “muhaxhir – ensar”. (Ibn Haxher, II, 338.)

Sipas **Ibn Abbasit** (radijall-llahu anhumas); ashtu si kurse Resulullahu (a.s.), bashkë me Ebu Bekrin (r.a.) dhe Omerin (r.a.), për shkak të mushrikëve mekas, u bënë muhaxhirë duke u shpërngulur nga Meka për në Medine, edhe ata që ishin nga ensarët u bënë muhaxhirë duke shkuar pranë Resulullahut (a.s.), në natën e Akabe-së nga Medina që ishte vendi i shirkut.” (Nesai, Sunen, v. 7, f. 144 – 145; M. Asim Koksall, Islam Tarihi, 2/288.)

Puna e parë e Resulullahut (a.s.), pas hixhretit, ishte që të bënte paktin e vëllazërisë mes ensarëve dhe muhaxhirëve. Gjatë kësaj marrëveshjeje, Zekvan ibn Abdikajs (r.a.), u shpall vëlla me Mus’ab ibn Umejrin (r.a.). Zekvani (r.a.), i ofroi gjithçka kishte për të ndihmuar vëllzërit muhaxhirë. Ai u përpoq t’i ndihmonte ata duke sakrifikuar gjithçka. Madje një pjesë të mallrave që kishte ua shiti muhaxhirëve me një çmim të ulët.

Sa’d ibn Ebi Vakkas (r.a.), bleu “Pusin Sukja” kundrejt dy deveve. Ky pus ishte i shquar në Medine për shijen e ëmbël që kishte. (Islam Ansiklopedisi, v. 44, f. 222; Ibn Shebbel, I, 158 – 159.)

Zekvan ibn Abdikajs (r.a.), ishte një trim që kishte marrë pjesë në Betejën e Bedrit dhe Uhudit. Gjatë Betejës së Bedrit ai pati bërë rojën e çadrës së të Dërguarit të Allahut (a.s.), në Luginën Usejl, po ashtu edhe në Shejhajn gjatë periudhës së Betejës së Uhudit. Këtë shërbim plot dashuri të tij, profesor M. Asëm Këksall e tregon në këtë mënyrë:

“Kur ushtria islame po shkonte në Uhud, natën e kaloi në Shejhajn. Pejgamberi (a.s.), drejtoi faljen e namazit të ikindisë, akshamit dhe jacisë. Në krye të një grupi rojesh prej pesëdhjetë vetësh, vendosi Muhamed ibn Mesleme-në dhe u la atyre detyrë që të rrotulloheshin përreth ushtrisë.

Pejgamberi ynë (a.s.), pasi fali namazin e jacisë në Shejhajn, iu drejtua sahabëve duke i pyetur në këtë mënyrë:

- *Kush na ruan ne sonte?*

Një njeri në errësirë u ngrit në këmbë dhe tha:

- Unë!

Pejgamberi (a.s.), e pyeti atë duke i thënë:

- *Kush je ti?*

Unë jam Zekvan ibn Abdikajs! – i tha ai.

Kurse Pejgamberi (a.s.), i tha:

- *Ulu ti!*

Pas pak, sërish Pejgamberi (a.s.), tha:

- *Kush na ruan sonte?*

Një njeri u ngrit në këmbë dhe tha:

- Unë!

Pejgamberi (a.s.), e pyeti:

- *Kush je ti?*

Unë jam Ebu Seb’i. – tha ai.

- *Ulu ti!* – i tha Resulullahu (s.a.s.).

Sërish Pejgamberi (a.s.), pyeti:

- *Kush na ruan sonte?*

Një njeri u ngrit në këmbë dhe tha:

- Unë!

Pejgamberi (a.s.), e pyeti:

- *Kush je ti?*

Unë jam Ibn Kajs. – tha ai.

- *Ulu ti!* – i tha Resulullahu (s.a.s.).

Pas pak, Resulullahu (a.s.), tha:

- *Le të ngrihen në këmbë që të tre!*

Nga mesi i sahabëve u ngrit vetëm Zekvan ibn Abdikajs (r.a.) dhe erdhi pranë Resulullahut (a.s.). I Dërguari i Zotit e pyeti atë:

- *Ku mbetën shokët e tjerë?*

Zekvan ibn Abdikajsi (r.a.), tha:

- O Resulullah! Që të tri pyetjeve unë iu ktheva përgjigje. Emri im është Ebus-Seb’Zekvan ibn Abdikajs.”

Duke e lavdëruar këtë sjellje me kaq dashuri të tij, Resulullahu (a.s.), i buzëqeshi dhe i tha kështu:

- *Atëherë shko na ruaj! Që Allahu të të ruajë edhe ty!*

Zekvan ibn Abdikajs (r.a.), veshi menjëherë parzmoren, mori shpatën dhe mburojën dhe atë natë bëri rojën e tyre. (Vakidi, Megazi, v.1, f. 216 – 217.)

Resulullahu (a.s.), lavdëroi këtë sjellje plot dashuri të Zekvan ibn Abdikajs (r.a.) dhe mençurinë e tij. Atë e gëzoi me këtë sihariq:

“*Kush dëshiron të shohë nesër një njeri që do të shkelë mbi gjelbërimet e Xhenetit, le të shohë Zekvanin!*” (Ibn Haxher, el – Isabe, v. 1, f. 482; M. Asim Koksall, Islam Tarihi, 4/129 – 130.)

Nga këto fjalë Zekvani (r.a.), kuptoi se do të binte shehid, ndaj dhe vrapoi drejt e në shtëpi. U takua me gruan dhe më fëmijët. U kërkoi hallallin atyre dhe u dha lamtumirën. Deri në mëngjes ruajti Pejgamberin tonë të dashur (a.s.), aty ku ai e kishte përcaktuar. Të nesërmën, në fushëbetejë, ra shehid ndërkohë që po luftonte me trimëri përballë mushrikëve mekas.

Atë ditë, ndërkohë që Resulullahu (a.s.), po pyeste për gjendjen e sahabëve, pyeti edhe për Zekvan ibn Abdikajs (r.a.). **Aliu** (r.a.), i tregoi se Zekvani (r.a.), duke luftuar me trimëri në fushëbetejë u vra nga mushriku i Mekës, Ebul-Hakem Ahnes ibn Sherik dhe që këtë të fundit e kishte vrarë pastaj vetë Aliu. (Vakidi, I, 283.)

Allahu qoftë i kënaqur prej tij. Allahu na dhëntë të gjithë neve nga dashuria, dorëzimi, mençuria dhe shpirti i kumtesës në islam i Zekvan ibn Abdikajs (r.a.). Le të na bëjë shefaat edhe neve në botën tjetër. Amin!



MISIONI OBJEKTIV I THIRRËSIT NË ISLAM

Doç. Dr. Muhamed Mustafi

HYRJE

Realiteti i funksionit të thirrësit nënkupton misionin objektiv të tij, dhe thirrësi nuk do të ishte i suksesshëm sikur të mos ishte i ndërlidhur me synimin objektiv të tij si dhe me përgjegjësinë konkrete ndaj shoqërisë e ambientit ku jeton, gjegjësisht ndaj botës, së cilës i drejtohet gjatë misionit të tij.

Thirrësi (davetxhiu) në Islam, gjatë funksionimit të tij në da'vet, jeton në një jetë reale dhe ballafaqohet me probleme objektive, të cilat duhen elaboruar e zgjidhur. Nëse nuk ekziston ndonjë korelacion në mes misionit të tij dhe realitetit objektiv, nuk mund të thuhet se do ketë ndonjë ndikim crucial e as që mund të bisedohet për sukses eventual në predikimet e tij, sepse, në rast të tillë, njeriu me përgjegjësi të tillë, do të konsiderohet si njeri që merret me çështje fiktive, te cilat në botë njihen me termin ndërkombëtar "fiction".

Thirrësi merret me jetën reale dhe gjatë aktivitetit të tij, asnjëherë nuk funksionon jashtë botës së tillë, sepse në bazë të përgjegjësisë që ka si interpretues

i Misionit Hyjnor në këtë botë, ai frymëzohet nga Kurani Famëlartë dhe nga Suneti i Pejgamberit (a.s.) dhe se çdo zhdukje e lidhjeve të tilla, nënkupton edhe disfunksionimin e misionit objektiv.

Mënyrat e funksionimit të thirrësit janë të ndryshme dhe interdisiplinare, por të gjitha kanë një synim unik dhe përfundimtar fetar.

Thirrësi konsiderohet personazh kryesor në zhvillimin e ngjarjeve kryesore të jetës, kontrollues i lëvizjeve sociale pozitive dhe negative, si dhe kritik i ashpër i çdo ngjarjeje që pengon zhvillimin normal të normavë jetësore, sepse në bazë të Emanetit Hyjnor, njeriu duhet të jetë faktor në ndryshimet shoqërore.

Pra, në këtë kontekst, thirrësi merr përgjegjësinë në proceset e lëvizjeve të njeriut brenda strukturës së parimeve islame dhe sukcesi i tij në një mision të tillë, nënkupton suksesin progresiv në strukturën shoqërore.

Nëse analizojmë botën ku jetojmë, do të vërejmë

se pas çdo ideje që hidhet në masë, ekzistojnë njerëz dhe programe të posaçme, të cilët punojnë që idetë e tilla të jenë sa më të përhapura në mesin e njerëzve. Idetë e tilla kanë natyra dhe synime të ndryshme, por të gjitha janë të krijuara nga mendja e njeriut për të reklamuar diçka që është në interes të kësaj bote, gjegjësisht në interes të ndonjë korporate, kompanie, partie politike, organizate apo shoqate. Idetë e tilla nuk hidhen në mënyrë të rëndomtë para njerëzve, por veprohet në mënyrë strategjike dhe të mirë paraprogramuar, sepse asnjë ide nuk mund të depërtojë pa studimin e realitetit.

Shuma të mëdha të financave dhe një numër tejet i madh i studiuesve punojnë në përgatitjen e terrenit për të fituar mendjen e njeriut. Duke e parë rëndësinë e metodës së tillë, ose thënë më mirë, duke e studiuar realitetin objektiv, vërejmë se të gjithë njerëzit e tillë merren me mision objektiv për interesa të caktuara, por jo edhe për diçka mbinjerëzore, sepse iniciativat e tyre vijnë nga interesi konkret objektiv.

Në botën e tillë të konflikteve në mes ideve, del në pah roli i njeriut gjegjësisht roli i propaganduesit në botë.

Për ne, si myslimanë, kur ballafaqohemi me gërshetimin e ideve të tilla në sipërfaqen e tokës, menjëherë rikujtojmë misionin që e kemi obligim nga Zoti i Madhëruar e që theksohet shumë qartë në ajetin Kuranor: **“E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e Allahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: ‘Unë jam prej myslimanëve?’”** (Fussilet, 33)

Pra, obligimi i tillë, që nënkuptohet drejtpërdrejtë nga Urdhri Hyjnor, konsiderohet mision konkret me natyrë objektive dhe thirrësi në Islam është i kush-tëzuar me relacionin “mision” dhe “vepër”, sepse në të kundërtën, do të ishin vetëm fjalë teorike që s’kanë kurrfarë efekti në shoqëri.

Në gërshetimin e ideve në botë nuk ka ndonjë frymë universale që rrjedh nga Zoti i Madhëruar, përpos thirrësve në Islam, sepse, në rast të tillë, përgjegjësia e thirrësit është ndaj Zotit të Madhëruar.

Thirrësi ka mision objektiv në jetë, që është formuar nga Kurani Famëlartë dhe nga hadithet e Pejgamberit (a.s.). “Mund të themi lirisht se qytetërimi islam është fryt dhe prodhim pikërisht i fesë islame,

sepse ky qytetërim është paraqitur bashkë me paraqitjen e fesë islame. Ngado që ka arritur feja islame, ka arritur edhe qytetërimi. Cilido popull të ketë pranuar fenë islame në gjirin e vet, do të jetë futur edhe ai qytetërim.” (Sami Frashëri, 2002:35)

Misioni i thirrësit në Islam formohet nga feja islame dhe pikërisht për këtë arsye edhe ka përgjegjësi islame. Misioni i formuar gjatë kohës së Pejgamberit (a.s.), ishte përqendruar në formimin e një koncepti të ri islam mbi jetën përkundër konceptit të vjetër idhujtar politeist.


Pra, detyra e thirrësit në Islam është “që të çlirojë mendjen e njeriut nga hutia dhe bestytnitë e idhujtarisë pa përdorur në asnjë mënyrë dhunën, sepse ata ishin të bindur në parimin se Zoti udhëzon atë që do...” (Menufi, 1983:22).

Thirrësi i tillë kishte mision të vazhdueshëm në jetën e tij dhe i njëjti mision që ishte atëherë i suksesshëm, mund të jetë edhe tash, por me kusht, nëse praktikohet ashtu siç u praktikua gjatë kohës së fillimeve të hershme të Islamit.

Misioni i thirrësit në Islam nuk ka periudha të caktuara dhe ndërprerje periodike sezonale, sepse në bindjen e tij mbizotëron parimi se “Islami është aktivitet i vazhdueshëm dhe orvatje e gjatë, dhe për këtë shkak, e sheh se kërkon prej myslimanëve që gjithmonë të punojnë, të orvaten e të jenë aktivë, duke e refuzuar stagnimin e përhershëm dhe ikjen nga lëvizja e puna.” (Nedevi,

1973:254)

Lëvizja e gërshetimeve më herët ishte më e ngadalshme, ndërsa sot flasim për lëvizje që tejkalojnë shpejtësinë e zërit apo të dritës dhe në një botë të tillë, edhe obligimi i thirrësit në Islam është më i komplikuar. Thirrësi në islam ballafaqohet me shumë të dhëna e ide që përhapen me shpejtësi të madhe e që vijnë nga vende të ndryshme për promovimin e ideve dhe mendimeve. Në këtë kontekst, Muhamed Ikbali thotë: “Fenomeni më i rëndësishëm i historisë bashkëkohore është shpejtësia e madhe me të cilën bota islame kthehet nga Perëndimi. Nuk ka asgjë të keqe në këtë lëvizje, sepse kultura evropjane, nga aspekti intelektual, përcjell zhvillimin e fazës më të zhvilluar të kulturës islame. Ne vetëm druajmë se shkëlqimi sipërfaqësor i kulturës evropiane do të



ndalë lëvizjen tonë dhe do të na pengojë për të arritur qëllimin esencial.” (Muhamed Ikbal, 1979:17)

Prej fillimit të shpalljes së Islamit në kohën e Pejgamberit (a.s.), deri më sot, myslimani ballafaqohet me ide të ndryshme dhe me popuj të ndryshëm, prej të cilëve, disa bëhen myslimanë e disa jo. E tërë kjo trashëgimi është formuar nga thirrësit në Islam, e që vepronin në mënyra të ndryshme. Disa prej tyre vepronin drejtpërdrejt me njerëzit, ndërsa disa të tjerë nëpër institucione edukativo-arsimore.

Misionin e thirrësit në fe, si më herët ashtu edhe sot, e shohim si një trashëgimi të formuar shekuj me radhë. Në këtë kontekst, Corbini thotë: “Ndonjë trashëgimi është e gjallë dhe bartet në jetë vetëm në rrethana të rilindjes së përhershme.” (Henry Corbin, 1980:II/132)

I tillë është misioni objektiv i thirrësit në Islam, i gjallë dhe i trashëgueshëm prej gjenerate në gjeneratë, prej shkollë në shkollë dhe prej dijetarit në dijetar... Misioni i tillë është multidisiplinar, sepse thirrësi ballafaqohet me disiplina të ndryshme që kanë synime të ndryshme, dhe nëse nuk është i aftësuar të mbijetojë në valë të tilla, do të çorientohet dhe do të zbehet ndikimi i fjalës së tij.

Në rrethana të tilla komplekse, për thirrësin islam, ka rëndësi të madhe aplikimi i ajetit kuranor: **“Ti (Muhamed), thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira.”** (Nahl, 125)

Në raste të tilla, nëse dështon misioni i thirrësit, atëherë do të zhduket “mundus imaginalis-i”, që i preokuponte me të madhe mendimtarët tanë myslimanë. Me arsye flitet për sulmin perëndimor, që është shkatërrues i strukturës së civilizimeve tradicionale. (Henry Corbin, 1980: II/132)

Detyra kryesore e thirrësit duhet të jetë përgatitja profesionale shumëdimensionale për të qenë i suksesshëm në botën e realtë bashkëkohore. Njeriu i tillë nuk duhet të jetë jashtë suazave të problemeve në shoqëri e as të largohet prej tyre, sepse, në të kundërtën, do të konsiderohet si njeri i fjalëve pa vepra, gjegjësisht do të jetë vetëm ihtar i mendimeve teorike që s’mund t’i aplikojë në jetën praktike. Nëse misioni i tij objektiv formohet në botën iluzore, nuk do të mund të vazhdojë përgjegjësinë që e ka në këtë botë, sepse bota iluzore nuk ka vend në botën e realtë, dhe në rast të tillë, do të cilësohet si orator i bukur por jo edhe funksional. “Për të kuptuar se si realisht manifestohet shpirti islam në thirrje (da’vet), patjetër duhet kuptuar funksioni themelues i artit të tij, që formon forma të jetës së shoqërisë së besimtarëve dhe në këtë mënyrë formon

ambient më të përshtatshëm në rrugën e çdo njeriu në këtë botë dhe në rikthimin e tij te Zoti...” (Pasquier, 1993:108)

Detyra e thirrësit në mesin e kësaj bote të konflikteve të ndryshme, duhet të ofrojë konceptin që e ofroi Islami më herët kur u ballafaqua me të tjerët. Pasiqë misioni i atëhershëm ishte i suksesshëm, jam i sigurt se edhe misioni i tashëm do të te jetë i suksesshëm. Islami ofroi botëkuptime të reja për botën dhe shoqërinë dhe për këtë arsye edhe u pranua si “koncept i ri i funksionit të fesë në jetën e shoqërisë.” (Watt, 1971:179)

Koncepti i ri ishte i ndërlikur ngushtë me realitetin e jetës dhe ofronte një jetë krejtësisht ndryshe për njerëzit. Pjesëmarrja aktive e thirrësit në Islam garanton misionin objektiv në jetën e përditshme njerëzore ngase “çdo gjë që s’ ka lidhje me realitetin, nuk mund të jetë e kapshme për synimet njerëzore.” (Vahidu-din Han, 1973:185)

Pra, misioni i thirrësit në Islam është shumë ngushtë i lidhur me realitetin e jetës dhe në çdo lëvizje të jetës, ai duhet të jetë promotor, mbrojtës dhe udhëzues publik i vlerave të Islamit, që njerëzit të jenë më të suksesshëm në ballafaqimin e tyre me problemet aktuale, të cilat janë tejmas të ndërlikuar dhe shpjen në shturje të përgjithshme.

Misioni i thirrësit në Islam aktualisht nuk është fare i lehtë, sepse ai duhet të jetë i përgatitur për aktivitetin e tij. Në këtë kontekst, “ne duhet të zbulojmë forcat motivuese të të dy qytetërimeve – të Islamit dhe të Perëndimit modern -, e më pas të hulumtojmë se sa larg mund të shkojë bashkëpunimi i mundshëm në mes tyre. Marrë parasysh faktin se qytetërimi islamik, në esencë është fetar, atëherë ne duhet, së pari të orvatemi që të përcaktojmë rolin e përgjithshëm të fesë në jetën njerëzore.” (Muhammad Asad, 1987:10)

Si përfundim, nga të dhënat aktuale që mbizotërojnë sot në botë, thirrësi duhet të ketë njohuri të mëdha mbi aktivitetet dhe lëvizjet aktuale, për shkak se vetëm në këtë mënyrë, misioni i tij, në bazë të përgatitjeve krahasimtare dhe në bazë të të dhënave që i posedon, mund të jetë i suksesshëm dhe mund të ofrojë atë që mungon në anën tjetër dhe ndoshta metoda më e mirë për të korrur sukses në thirrje (da’vet) do të ishte fillimi nga antiteza.



Ndaj dhe rrotullohemi

Ali Byjyçapar

Motivi i imanit duhet të prekë në shtresën e kohës. Kjo punë që duhet të vazhdojë medoemos jo me fjalë, por me vepra të mira është e vërteta e jetës së kësaj botë. Dyert e të fshehtës vetëm kështu do të hapen.

Kjo detyrë sublime nis me pohimin e Muhamedit si pejgamber dhe me besimin në Allah dhe vazhdon me ibadet, moral, drejtësi, ekonomi dhe vlerat estetike që shpjegohen në Kuranin Famëlartë. Nuk ka pikë dyshimi që shpirti i njeriut do të arrijë prehjen, kur të hyjë brenda kufijve të imanit, kur të largohet nga dyshimi dhe kotësia.

Dashuria duhet të jetë për Allahun.

Nëse shoqëria dhe miqësia nuk brumosen me pëlqimin e Allahut, janë jetëshkurtra. Një njeri që nuk arrin dot ta mbajë përsipër urtësinë, nuk mund të bëjë dobi as për vete. Të presësh miqësi dhe besnikëri nga njerëzit që nuk ndejnë entuziazmin e ekzistencës së Allahut, është gabimi më i madh.

Testimi i sinqeritetit është detyrimi më primar dhe human që kemi ndaj vetes sonë. Duhet të jemi nga besimtarët që na dridhet zemra kur përmendet Allahu.

Shpesh përmendet që jeta është një kaos i madh. Vijat e jetës ditore të myslimanit janë të përcaktuara. Ndërkohë që konceptet si farzi, vaxhibi, suneti, mustehabi dhe mubahi kanë ndriçuar rrugën tonë, kurse konceptet si harami, mekruhu dhe mufside përkufizon të këqijat.

Le të mos biem në kurthet e shejtanit.

Kush ka thënë që dija është e lehtë për t'u bartur

në botën e urtësisë dhe për t'u bërë e përsosur zemra me dashuri?

Ibadetet themelore si namazi, agjërimi, zekati dhe haxhi janë aty. Kjo jetë që nuk ka vend për shkujdesje, jetohe vetëm një herë, nuk ka përsëritje. Mos dinë gjë vallë ata që flasin symbyllazi që bota është e rreme? E vërteta që manifestohet tek çdo njeri, nuk duhet të humbasë, nuk duhet çuar dëm mundi.

Duket mjaft qartë se kemi nevojë imediate për një edukim mbi historinë. Nuk duhet të harrojmë që ecin së bashku jeta fetare me realitetin e kohës.

Le të shohim duke marrë mësim gjithçka, duke nisur që nga dita që jetojmë ne vetë dhe duke i hedhur një sy thellësive të historisë. Duke konstatuar të vërtetat e ndryshueshme të shoqërisë, duhet të mendojmë mbi atë se si duhet jetuar feja.

Ku është shpirti i kohës?

Kënaqësia e Allahut është e përhapur në çdo grimcë të jetës; njeriu, porsia një bletë, duhet të rrotullohet sa në një lule në një tjetër dhe të bëjë mjaltë, ngaqë hojet e jetës duhen mbushur plot me vepra të mira.

Frika dhe shpresa i japin fund rendit të vetëm të jetës dhe na shpëtojnë nga shqetësimet e pakuptimita. Me siguri kot nuk përmenden dhuntitë e Xhenetit dhe dënimet e Xhehenemit. Duhet marrë mësim, duhen nxjerrë mësimet, gjithnjë duhet shpëtuar nga paragjykimet negative, për të shkuar drejt gjykimeve pozitive.



ZHVILLIMI MENDOR; PËRTEJ PËRPPJEKJES PËR TË MBIJETUAR...

— ❧ — *Mesut Kaja* — ❧ —

Të hysh në botën e mendimit, ku njeriu në kuptimin e vërtetë të fjalës bëhet njeri dhe të përplasësh flatrat në qiellin e tij, mund të konsiderohet si një proces përsosmërie i qenies njerëzore dhe si një rrugëtim në rrugën e tij.

Titulli i këtij artikulli në fillim u mendua si “Progresi intelektual (fikri terakki)”. Megjithëse edhe “intelekti” apo “intelektualiteti” që përdorim ne, si dhe “progresi” tashmë janë fjalë të natyrshme të gjuhës sonë, ajo gjë që më bëri të heq dorë nga ky titull ishte përpjekja për të përdorur fjalët tona, jo të huaja.

Me sa duket, shkakut kryesor është kuptimi ideologjik që i kemi veshur fjalës “terakki (progres)” dhe qëndrimi im larg saj. Ashtu siç dihet, “progresi” është një nga fjalët magjike të shekullit të 19-të. E njëjtë me arsyen dhe shkencën. Triniteti filozofik që bëri adhurues të rrugës së qytetërimit të Evropës... Në krahun tjetër, janë koncepte që përmbajnë të njëjtën magji tek popujt që ende nuk janë qytetëruar apo që nuk e kanë realizuar procesin përndritës të civilizimit. Pra, si përfundim, “progresi” është një koncept me qendër ligjërimin para-mbrapa, porsì një balsam për gjuhën...

Progresi është njëkohësisht një term i mistikës islame. Përdoret për të treguar zhvillimin shpirtëror të sufiut. Myridi që kryen dhikrin dhe virdin dhe që respekton edukatën dhe rregullat e caktuara, vëren frytet e rrugëtimit shpirtëror; kështu ai bën progres dhe zbulim (inkishaf) shpirtëror. Në këtë kontekst,

ajo fjalë përmban një konotacion pozitiv.

Mirëpo unë, sidoqoftë, parapëlqej të përdor fjalën “zhvillim” në vend të fjalës “progres”. Natyrisht fjala “zhvillim” u bë koncepti populist i kohëve të fundit; na sorollati për një kohë të gjatë dhe nuk na shpuri gjëkund, si dhe pranoj që kjo fjalë menjëherë sjell në mendje “zhvillimin e personalitetit”, që duket se na ka lënë plot lëngata në unin tonë. Ç’e do se unë besoj që shprehja “zhvillim mendor” shpreh siç duhet atë që unë dua të them.

Po mirë, vallë ç’është zhvillimi mendor?

Mendimi është cilësia më dalluese e njeriut. Për të bërë dallimin e njeriut me gjallesat e tjera, janë krijuar përkufizime të llojit “gjallesa që mendon dhe flet” (el-insanu hajevanun natik). E folura është domosdoshmëri e të menduarit. Thënë ndryshe, kur shprehet mendimi, shfaqet qenia. Nuk është e mundur të flitet mbi ekzistencën e një mendimi që nuk është shprehur. Si rrjedhojë, njeriu është një qenie që mund ta derdhë në fjalë mendimin. Le ta kujtojmë anekdotën e Nastradin Hoxhës me papagallin dhe gjelin e detit. Vërtet papagalli flet, por ajo e folur nuk është e vetëdijshme. Gjeli i detit mendon, por ai mendim nuk ka ndonjë vlerë praktike.

Allahu i Madhëruar ka krijuar njeriun, i ka mësuar atij të folurën/shprehjen. (Rahman, 1 – 4) Këtu le të përmendim komentin që bën komentuesi i Kuranit, Zamahsheri: “Këtu Allahu bën të ditur një veçori shquese të njeriut nga gjallesat e tjera; e shprehura. Shprehja është të mund të flasësh në mënyrë të kup-

tueshme, të artikulosh mendimin që mban brenda.” Në një tjetër ajet të Kuranit Famëlartë, bëhet fjalë se Ademiti (a.s.), i janë mësuar të gjitha emrat. (Bekare, 31.) Pra, Allahu i ka dhënë njeriut aftësinë për të menduar dhe për të prodhuar mendim; si rrjedhojë, i ka dhënë njeriut aftësinë për t’u dhënë emër sendeve dhe për të krijuar lidhje mes qenies dhe emrave.

Njeriu, aftësinë për të menduar dhe folur e përdor në çdo fazë të përditshmërisë së tij. Mirëpo, a është vallë ai proces i të menduarit, pikërisht ai që bën dallimin me gjallesat e tjera, për të cilën po flasim ne? Pa dashur ta mohojmë këtë, ajo çfarë është thelbësore është që do të ishte më esenciale sikur të prananim formën e të menduarit që prodhon dituri dhe vlerë. Pasi edhe engjëjt janë gjallesa që kanë dije. Mirëpo, kur iu kërkua atyre që t’i thoshin emrat e sendeve, ata thanë: **“Qofsh i lavdëruar! - thanë ata - Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti.”** (Bekare, 32.). Kjo do të thotë që ajo çfarë e bën njeriun të ndryshëm, është mundësia për të mësuar dije të reja, përtej dijes që i është dhënë dhe mundësia për të shpalosur vijimësinë e prodhimit të dijes. Ndaj dhe këto janë qeniet që i janë përkulur edhe engjëjt para tyre.

Struktura biologjike e njeriut është sikurse e të gjitha krijesave, që nga barku i nënës deri në vdekje gjithnjë në një proces ndryshimi dhe zhvillimi. Edhe mendimi dhe e folura gjatë përditshmërisë, në mënyrë paralele me këtë zhvillim, zhvillohet deri në një farë pike të caktuar. Por mendimi për të cilin po flasim ne, zhvillohet në varësi të një përpjekjeje dhe pune brenda njeriut pas një faze të caktuar.

Kësisoj, zhvillimin mendor mund ta shohim si një domosdoshmëri të qenies njerëzore për gjetjen e së vërtetës, si një përpjekje dhe punë për të prodhuar dituri dhe vlerë. Të hysh në botën e mendimit, ku njeriu në kuptimin e vërtetë të fjalës bëhet njeri dhe të përplasësh flatrat në qiellin e tij, mund të konsiderohet si një proces përsosmërie e qenies njerëzore dhe si një rrugëtim në rrugën e tij.

Duhet të pranojmë që edukimi, rrethi, interesimi dhe prirjet e njeriut ndikojnë tek ai. Edukimi që merr nga familja dhe shkolla përbën një vend të rëndësishëm për të arritur frytet e jetës. Po ashtu edhe rrethi. Mirëpo, një njeri që mendon, ndërkohë që kërkon nga njëra luginë në tjetrën, mund të shohë përreth si një subjekt; vjen koha dhe sheh me një sy kritik edhe edukimin që merr edhe rrethin që e rrethon. Të testosh njohuritë që mëson; të vlerësosh sa të vërteta dhe sa të gabuara janë ato çfarë dimë; të arrish nga e njohura tek e panjohura; të prodhosh dije dhe vlerë, është një rezultat i përpjekjeve personale. Këtu sërish

aktet e njeriut, të pasurit e mendimit cilësor që flitet dhe të vijuarit e të pasurit në dorë është faktori më i rëndësishëm.

Nëse do të duhet ta konkretizojmë, leksionet jepen dhe përpjekjet bëhen në varësi të degës që zgjidhni në universitet dhe në shërbim që të njihni sa më mirë profesionin tuaj. Kur njeriu diplomohet në një universitet të caktuar do të dalë prej aty me profesionin përkatës. Mirëpo, njeriu përtej pretendimit për të pasur një profesion, brenda një kohe të caktuar duhet t’i shtojë shumëçka ekzistencës ontologjike. Ai duhet ta shohë jetën me një sy tjetër, duhet të hyjë në një klimë reflektimi. Kjo gjë ndodh vetëm përmes veprimtarive të ndryshme jashtë fakultetit dhe një leximi alternativ që mund të kontribuojë në zhvillimin mendor të njeriut. Akumulimi intelektual i njeriut, që mund ta thellojë formën e mendimit dhe që mund ta udhëheqë gjatë tërë jetës dhe duke u pajisur me një përpjekje mendore, e cila përbrendëson akumulimin në fjalë. Ndërkohë, përmes leximeve alternative dhe veprimtarive, mundet që të vlerësojë edhe njohuritë që jepen.

Edhe procesi pas saj është shumë i rëndësishëm. Njeriu duhet ta vazhdojë zhvillimin mendor edhe pasi të ketë një punë dhe pasi të krijojë një familje. Jeta mendore që nuk vijon edhe pasi është hedhur në jetë, do të hyjë në një qorrsoak, kështu do të nisë të mbajë erë, nëse mund të themi kështu. Kjo gjë sjell me vete edhe njëfarë përtacie mendore. Për sa kohë që vazhdon të rrjedhë jeta, duhet të vazhdojë po ashtu të rrjedhë edhe mësimi bashkë me mendimin. Meqë ky proces vazhdon, mënyra e shikimit të njeriut kur është 25- vjeçar ndaj një teme të caktuar, me mënyrën e shikimit kur ai është 30 vjeç është mjaft e ndryshme. Kështu që, nëse njeriu procesin e mendimit e vazhdon gjatë tërë jetës, besoj që do ta ndjejë më mirë njerzillëkun brenda vetes së vet, si dhe tek vetja e tij do të ndjejë qëllimin e qenies, kështu mundet të jetë më afër me fuqinë dhe madhësinë e Allahut.

Edhe Kurani e nxit njeriun që të mendojë vazhdimisht. Ky nuk është një mendim i rëndomtë, por është një meditim në kuptimin e të menduarit thellësisht. Për sa kohë që njeriu zhytet në detin e medimit, në dallim me gjallesat e tjera, kësaj ai do ta ndjejë më shumë të qenit më i nderuari i krijesave (eshrefi mahlukat). Të gjitha gjallesat bëjnë përpjekje për të mbijetuar. Ajo çfarë është e rëndësishme është përtej kësaj përpjekjeje, është vazhdimi i kërkimit të së vërtetës; të mund të bëjë përpjekje për një jetë që bart në vetvete besimin dhe fenë, vlerat sublime dhe diturinë.


REVOLUCIONI FRANCEZ I VITIT 1789

Ahmet Meral

BASTISJA E BURGUT BASTIJA

Revolucioni francez, nisur nga rezultat që ka dhënë, është njëri prej uraganeve politikë më të rëndësishëm në historinë botërore. Kryengritja e klasës së mesme, e cila quhet “klasa borgjeze”, filloi në Paris më 14 Korrik të vitit 1789 me mbështetjen e masave të varfra popullore. Askush nuk e imagjinonte atë ditë se ndikimi i saj politik, social dhe kulturor do

të vazhdonte deri në ditët e sotme. Lirimi i shtatë të arrestuarve politikë, të cilët ishin simboli i monarkisë, nga ana e kryengritësve duke e bastisur burgun Bastija dhe uzurpimi i sarajeve të fisnikëve pasi kryengritja e popullit të varfër u shndërrua në një shpërthim zemërimi, nuk u mjaftua me futjen e revolucionit vetëm në një formë të përgjakshme dhe të dhunshme, por trazirat dhe rrëmuajt sociale dhe politike vazhduan për pesëmbëdhjetë vite me radhë. Në këtë mënyrë, revolucioni influencoi të gjithë Evropën me në krye Francën. Të drejtat e



njeriut, liritë individuale, liria e fesë dhe e ndërgjegjes dhe të drejtat themelore, hynë në rendin publik dhe ndezën fitilin e shumë ndryshimeve rrënjësore jo vetëm politike, por edhe sociale, kulturore, fetare dhe ekonomike.

Priftërinjtë dhe punonjësit e kishës me qendër Vatikanin, si nevojë e roleve prej kleriku që kishin marrë përsipër, hynë në bashkëpunim me aristokratët duke i tradhtuar rolet që kishin, ndërkohë që duhej të ishin mbrojtësit absolutë të të drejtave të njeriut dhe drejtësisë. Në këtë mënyrë, institucionet fetare u përçmuan në sytë e popullit. Për pesëmbëdhjetë vite me radhë kishat hynë nën shtypje. Madje, kishat që gjendeshin në qendrat e qyteteve u mbyllën. Institucionet katolike u dëmtuan mjaft ndjeshëm. Fakti që vendet e tjera të Evropës i vendosën bllokazh Francës, në të cilën u përhapën mendimet e reja, nxiti nacionalizmin francez. Mendimi për t'i formuar shtetet sipas parimit të nacionalizmit të tyre, ishte ndikimi më i rëndësishëm i këtij revolucion i lëkundit fort perandoritë e asaj kohe. Më së fundi, mendimet e administrimit të mbështetur te pluralizmi, monarkia dhe republika në udhëheqje, u ushqyen nga ky revolucion dhe akoma funksionojnë si novacione që ndikojnë edhe në ditët e sotme.

HUMNERA NDËRMJET KLASAVE SOCIALE

Nëse studiojmë strukturën e popullit francez të shekullit të tetëmbëdhjetë, populli formohej nga tri klasa kryesore.

1. Fisnikët / aristokratët,
2. Klasa e mesme që quheshin borgjezë dhe;
3. Fshatarët.

Fisnikët mbanin në duart e tyre pozitat shtetërore të niveleve të larta dhe nuk i paguanin aspak taksa shtetit. Mbi të gjitha, aristokratët, si pronarët e tokave që punonin fshatarët, i trajtonin keq shkllëverit e bujqit që ishin të lidhur me tokën dhe silleshin kundrejt tyre si feudalë, duke u bërë të gjitha llojet e padrejtësive.

Ndërsa klerikët katolikë që përbënin një klasë tjetër të privilegjuar, ndërkohë që duhet të zinin vend pranë popullit për ta mbrojtur atë, shumicën e rasteve ishin mysafirët kryesorë nëpër sarajet e fisnikëve të pasur. Mbi të gjitha, një herë në pesë vjet paguanin shumë pak taksa.

Borgjezët, të cilët po pasuroheshin vazhdimisht në vigjilje të revolucionit, sundonin pozitat në tregti, në banka dhe në industri. Përveç të tjerash, edhe klasa e borgjezëve të vegjël, e cila formohej nga nëpunësit, mjekët, avokatët dhe shkrimtarët, do të kishte ndi-

kimin e saj në revolucionin që po afronte dhe do t'u jepte fund epërsive të aristokratëve dhe të klerikëve në formimin e shtetit dhe hierarkinë e shoqërisë. Në të vërtetë, Revolucioni Francez i vitit 1789 ishte një revolucion i kryer nga klasa e mesme dhe për këtë arsye quhet edhe "Revolucioni i Borgjezëve".

DEKLARATA E SHBA-VE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE NDIKIMI I MONARKISË KUSHTETUESE TË ANGLISË

Anglia në këtë periudhë udhëhiqej nga monarkia kushtetuese. Intelektualët francezë, në çështjen e formimit të një monarkie kushtetuese, veçanërisht u ndikuan nga shkrimtarët anglezë. Të qenët e Anglisë një shtet i fuqishëm dhe i pasur, fakti që ajo e kishte realizuar revolucionin industrial dhe arritja e suksesit për t'ia kufizuar autoritetin mbretit që ndodhej në qendër të sistemit politik, ndikonte te teoricienët dhe liderët e revolucionit francez. Beniamin Franklin, në letrën që e dërgoi në Maj të vitit 1777 nga Franca prej së cilës pati ardhur me qëllimin për të siguruar ndihmë dhe mbështetje në SHBA, i shënon kështu zhvillimet që po ndodhnin në Amerikë dhe entuziazmin që ua pati frymëzuar francezëve:

"E gjithë Evropa është në anën tonë. Të paktën, të gjitha duartrokitjet dhe shpresat për sukses janë të lidhura me ne. Ata që jetojnë nën një fuqi despotike, nuk e duan më pak lirinë. Për këtë arsye shpresojnë dhe bien në pesimizëm për ta fituar lirinë në Evropë. Kolonitë tona që kanë fituar lirinë, i lexojnë me dashuri dhe emocion kushtetutat e tyre. E vërteta se kauza jonë është edhe kauza e gjithë njerëzisë dhe se ne luftojmë edhe për lirinë e Evropës, ndërkohë që luftojmë edhe për lirinë tonë, është një fjalë që thuhet nga të gjithë këtu."¹

Nga ana tjetër, lëvizjet e Amerikës për liri dhe Raporti i Pavarësisë së Amerikës që Thomas Jeffersoni e shkroi në vitin 1776, ishin një faktor tjetër i jashtëm që ua hapi rrugën francezëve për t'u vetëdijësuar në çështjen e të drejtave themelore dhe lirisë.

INTELEKTUALËT E VETËDIJESUAN POPULLIN NË ÇËSHTJEN E TË DREJTAVE THEMELORE

Edhe njëri prej shkaqeve që e nxiti Revolucionin francez në vitin 1789 ishte ndikimi i fuqishëm intelektual që shumë shkrimtarë të mëdhenj, mendimtarë dhe burra të shtetit kishin në popull me veprat e tyre në atë kohë.

Veprat kulturore që filluan më Fransua Rabële (1494-1553), në shekullin e tetëmbëdhjetë arritën

1. Historia politike e revolucionit francez, A. Aulard, fq. 35-36, Shtëpia botuese TIK, Ankara, 1987.

pikën kulmore me njerëzit e mendimit dhe të aksionit si Maximilien Robespierre (1758-1794), J. J. Rousseau (1712-1778), Montesquieu (1689-1778) dhe Condorcet (1743-1794) etj. Veprat e këtyre njerëzve që dolën në pah para vitit 1789 formuan bazën kulturore që ishte e domosdoshme për pjekjen e kushteve të realizimit të revolucionit. Përhapja e mendimeve në lidhje me të drejtat individuale, lirinë e ndërgjegjes dhe shpëtimi i udhëheqjes shtetërore nga dëshirat e dikujt, përbënin shkaqet më të rëndësishme që përgatitën këtë revolucion të madh, i cili do të hapte një periudhë të re.


GJENDJA FINANCIARE DHE POLITIKE PARA REVOLUCIONIT FRANCEZ

Franca udhëhiqej nga një monarki absolute dhe ashpër. Mbreti dhe aristokratët patën formuar një bazë politike dhe sociale mbi pabarazinë. E gjithë barra e vendit binte mbi klasën e mesme, e cila formohej nga tregtarët dhe zejtarët, dhe klasën e fshatarëve. Fshatarët jetonin në varfëri dhe skamje të tmerrshme.

Në shekullin e tetëmbëdhjetë Franca ishte në vëshirësi të mëdha financiare. Krahas shpenzimeve të pamatura të sarajit për shkak të garës politike me Anglinë, shpenzimet e luftës që lindnin nga ndihma dhe mbështetja ushtarake ndaj atyre që luftonin për pavarësinë amerikane, i sillnin një barrë të madhe financës. Për ta përballuar këtë situatë, u ngritën taksat. Populli filloi të shtypej nën këto taksat të rënda. Historiani Prof. Scott Trask thotë:

“Po të arrinte monarkia franceze ta ekuilibronte buxhetin e saj, mund të thuhet se revolucionin nuk do të përjetohej aspak... Shkaku i krizës që e nxori në pah Revolucionin Francez ishte kriza e një kredie dhe kriza financiare që e lëkundën autoritetin e monarkisë.”² Në këtë mënyrë, ai tregon se arritja e Francës pothuajse në pikën e falimentimit nga aspekti ekonomik ishte shkak i rëndësishëm i kryengritjes së madhe popullore.

Luigji i 16-të, në vitin 1774, me qëllimin për ta kaluar kolapsin ekonomik dhe për ta rehabilituar Francën nga aspekti financiar, solli në krye të financës Jacques Turgot, i cili ishte njëri prej fiziokratëve. Turgot mendonte se zhvillimi do të ishte i mundur me bujqësinë dhe se ndihmat e shtetit ndikonin negativisht në sipërmarrje dhe prodhim. Në këtë mënyrë, ai i shfaqti mbretit programin e një reforme që kryesisht kishte të bënte me bujqësinë, i cili mbronte



tezën se këtyre ndihmave (ndaj amerikanëve) duhej t'u jepej fund. Në këtë program sugjeroi një shtet federal të caktuar me zgjedhje në një zinxhirë që zgjatej nga fshati në provincë dhe nga provinca në kuvend. Këto reforma u përballën me kundërshtimin e aristokratëve, të cilët mbanin në dorë tregtinë e jashtme, dhe kundërshtimin e klasës së varfër. Përveç të tjerash, Turgot, ishte kundër ndërhyrjes së Francës në luftën e pavarësisë së Amerikës për shkak të financave. Ai ishte i mendimit se mbështetja që mund t'i jepej luftës së pavarësisë Amerikane do të thoshte një luftë e re me Anglinë. Si rezultat, reformat do të ngelnin pa u realizuar dhe shteti do të zvarritej drejt falimentimit. Për këtë arsye, mbretin Luigj e paralajmëroi duke i thënë:

“Shteti do të zvarritet drejt falimentimit me zjarrin e parë.” Por monarkia, siç nuk i mori parasysh shqetësimet e drejta të Turgotit me justifikimin se po bënte krenari popullore dhe politikë të forcës ndërkombëtare, gjithashtu e largoi atë edhe nga detyra e tij.

2. Prof. Scott Trask, Mises Institute, Revista e Mendimit Liberal, nr. 37, viti 2005.



Franca, duke filluar që nga viti 1777, u dha ndihmë të fshehtë me armë përgjatë gjithë luftës amerikanëve që po luftonin për pavarësi dhe ndihmë logjistike. Madje, në vitin 1780 i dërgoi një njësi prej 5000 vetave Rhode Islandit. Në vitin 1881 anijet franceze i ndaluan njësitë ushtarake angleze që ishin nën komandën e Lordit Kornuell që të dilnin nga Jorktauni. Si rezultat i këtyre ndihmave dhe ndërhyrjeve, Amerika u bë e pavarur, por Franca u rrokullis në një krizë edhe më të madhe ekonomike. I gjithë shpenzimi i luftës, i cili kushtoi 1.3 milion lira (livre) franceze, u financua me borxhe.

Mbretëria e Francës nuk u përdori dot mirë shansin e fuqizimit të ekonomisë që arriti ta kapte pas Marrëveshjes së Parisit në vitin 1783, e cila i hapi rrugë lindjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Iniciativa e monarkisë franceze për të formuar një ushtri të përhershme prej 150.000 vetave dhe dëshira e saj për të formuar një flotë që të rivalizonte anglezët nëpër oqeanë, me qëllimin për të arritur

një vend më të mirë në ekuilibrat botërore, e zhyti edhe më shumë në batakun e borxhit shtetin, i cili në fakt ishte i krimbur nga borxhet.

FILLIMI I REVOLUCIONIT QË DO TË ZGJASTE PESËMBËDHJETË VJET

Kur Luigji i 16-të i mblodhi aristokratët dhe kërkoi që të vilesnin taksa mbi pronësinë e tokave, aristokratët kërkuan mbledhjen e parlamentit.

Në Majin e vitit 1789, u hodh hapi i parë i revolucionit duke u hapur parlamenti i tri klasave që përbëheshin nga aristokratët, klerikët dhe populli. Tri sloganet e rëndësishme që thuheshin me entuziazëm nga masat e gjera popullore të revolucionit ishin: “Barazia, Drejtësia dhe Liria.” Robërit deshën të merrnin lirinë. Klasa e mesme që përbëhej nga tregtarët e artistët dhe populli, të cilët ishin të privuar nga politika, mbronin sundimin e popullit, në mënyrë që të arrihej barazia dhe kërkonin drejtësi.

Klasa e mesme, e cila u quajt klasa borgjeze dhe e cila përbëhej nga tregtarët, zejtarët dhe artistët, përbëhej nga një masë që i paguante taksa shtetit, por që kishte të drejta të kufizuara në politikë. Ata kërkuan një ligj të ri që do t’ua hiqte privilegjet aristokratëve dhe klerikëve. Pasi parlamenti nuk i pranoi mendimet dhe kërkesat e klasës së mesme, kjo klasë, pra klasa e borgjezëve filloi lëvizjen dhe me 9 Korrik të vitit 1789, “Parlamenti Popullor” e cilësuan si “Parlamenti Themelues”. Pastaj njoftuan se e kishin lënë jashtë funksioni sistemin e vjetër. Ata vendosën parimet e reja të drejtësisë popullore duke shpërndarë Komunikatën e të Drejtave të Njeriut dhe Atdhetarëve. Nisur nga kjo:

- a) Do të kufizohej autoriteti i mbretit dhe i mbretërisë duke u përpiluar një kushtetutë.
- b) Taksat do të rregulloheshin dhe do të pakësoheshin.
- c) Do të lehtësohej tregtia brenda vendit duke u shembur muret e doganave të brendshme.
- d) Do të sigurohej liria e shtypit.

Reagimi i mbretit nuk u vonua ndaj këtij zhvillimi të rrezikshëm që kërcënonte monarkinë e Francës. Abrogimi i këtij parlamenti duke u shpërbërë nga forcat ushtarake të mbretit i hapi rrugë një kryengritjeje të madhe që do të ndryshonte rrjedhën e historisë. Fshatarët që cilësoheshin si “leckamanët e skamur” të Parisit, masat e gjera popullore dhe klasa e mesme, pra, tregtarët, zejtarët dhe artistët që i prinin këtij revolucionit, i bashkuan forcat dhe bënë kryengritje.



Sulbe të zgjedhura

Naim Drijaj

10 përgëzime për atë që e fal namazin e sabahut me xhemat

Përgëzimi i parë: Dritë e plotë në Ditën e Gjykitimit. Prej momentit që namazliu del nga shtëpia e tij, e rrethojnë mirësitë nga të gjitha anët. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Përgëzoji ata të cilët ecin nëpër errësirë për në xhami me një dritë (nur) të plotë në Ditën e Kiametit.”¹

Përgëzimi i dytë: Ky namaz ka vlerë më të madhe sesa e gjithë bota dhe çfarë ka në të. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Dy rekatet e sabahut (sunet) janë më të vlefshme se e gjithë bota dhe çfarë ka në të”.²

Përgëzimi i tretë: Përfitimi i të mirave. Kur njeriu ulet dhe pret namazin, ai është në namaz. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Atij që del nga shtëpia e tij për në xhami, për çdo hap që bën, i shënohen dhjetë të mira. Ai që ulet në xhami të presë namazin është si ai që fal namazin. Regjistrohet si namazli, derisa të kthehet në shtëpinë e tij”.³

Kush nuk e fal namazin e sabahut me xhemat humb shumë shpërblime të mëdha, si: të mirat e dy rekatëve para namazit të sabahut, shpërblimin e hapave për në xhami, shpërblimin e leximit të Kuranit derisa të thirret ikameti për namaz, shpërblimin e pritjes së namazit në xhami deri në ikamet. E nëse llogarit të gjitha këto të mira, do të bëhen me miliona, ngase një e mirë shpërblehet me dhjetë të mira.

Përgëzimi i katërt: Dëshmia e melekëve. Allahu i Madhëruar thotë: “**Kryeje namazin prej kthimit të Diellit** (nga gjysma e qiellit) **deri në errësirën e natës dhe këndo Kuran në agim; me të vërtetë, falja e mëngjesit është e dëshmuar** (nga engjëjt).”⁴ Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “**Tabohen melekët e natës dhe melekët e ditës në namazin e sabahut**”.⁵

Përgëzimi i pestë: Hyrja në Xhenet dhe shpëtimi nga Xhehneti. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Nuk do të hyjë në zjarr ai që falet para lindjes së diellit dhe para perëndimit.”⁶, bëhet fjalë për namazin e sabahut dhe të ikindisë. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush e fal namazin e sabahut dhe të ikindisë, hyn në Xhenet.”⁷

Përgëzimi i gjashtë: Shikimi i Allahut (xh.sh). Shpresohet se ai që kujdeset për faljen e namazit të sabahut dhe të ikindisë do të fitojë shikimin e Allahut të Madhëruar. Transmetohet nga Xherir bin Abdullahu (r.a) se ka thënë: “Një natë ishim me Profetin (a.s.). Ai shikoi hënën e plotë dhe tha: “Ju do ta shihni Zotin tuaj ashtu siç po e shihni këtë hënë, nuk do të keni asnjë lloj vështirësie në shikimin e Zotit. Përpiquni të mos ju habisë djalli nga namazi (ta anashkaloni atë) para lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij, faleni atë (dhe largojuni intrigave të djajve).” Është fjala për namazin e sabahut dhe

1. Ebu Daudi, Tirmidhiu.

2. Muslimi.

3. Ahmedi.

4. Isra, 78.

5. Muttefekun alejh.

6. Muslimi.

7. Muttefekun alejh.



të ikindisë.⁸ Pastaj lexoi ajetin:.. **"Madhëroje Zotin tënd e falënderoje Atë para lindjes së diellit dhe para perëndimit."**⁹

Hafidh ibn Haxheri, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Kanë thënë dijetarët: "Arsyeja e përmendjes së këtyre dy namazeve me faktin e shikimit të Allahut është ngase namazi konsiderohet nga adhurimet më me vlerë. Është vërtetuar se këto dy namaze janë të vlefshme, sepse në këto dy namaze bashkohen melekët, ngrihen veprat, etj.

Përgëzimi i shtatë: Arritja e shpërblimit të namazit të natës. Nga Uthman bin Afani (r.a) transmetohet se ka thënë: "E kam dëgjuar Pejgamberin (a.s) duke thënë: "Kush e fal namazin e jacisë me xhemat ka shpërblim sikur të falej gjysmën e natës, ndërsa kush e fal namazin e sabahut me xhemat ka shpërblim sikur të falej tërë natën."¹⁰

Përgëzimi i tetë: Duaja e melekëve. Nga Ali bin

Ebi Talibi (r.a) transmetohet se ka thënë: "E kam dëgjuar Pejgamberin (a.s) duke thënë: "Kush e fal namazin e sabahut pastaj qëndron në xhami.., për të luten melekët. Duaja e tyre për të është: "O Allah, fale atë, O Allah mëshiroje atë!"¹¹

Përgëzimi i nëntë: Arritja e shpërblimit të haxhit dhe umres. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush e fal sabahun me xhemat pastaj ulet dhe e përkujton Allahun derisa dielli të lindë, e pastaj fal dy rekatë, ai fiton shpërblimin sikur të ketë kryer haxh dhe umre të plotë, të plotë, të plotë."¹²

Përgëzimi i dhjetë: Mbrojtja e Allahut (xh.sh). Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush e fal namazin e sabahut, ai është në mbrojtjen e Allahut. Të mos marrë guximin askush ta cenojë këtë mbrojtje të Allahut (duke e sulmuar këtë njëri) me asgjë, ngase ndaj atij që merr guximin ta cenojë këtë mbrojtje, Allahu do të hakmerret, e më pas do ta hedhë me fytyrë në zjarr të Xhehenemit."¹³

8. Muttefekun alejh.

9. Kaf, 39.

10. Muslimi.

11. Ahmed.

12. Tirmidhiu.

13. Muslimi.



KONSUMIMI I RRUSHIT MBRON SHIKIMIN

Rrushi është i pasur me antioksidantë që mbron qelizat e shëndetshme. Studimet e fundit, tregojnë se përfshirja e tij në dietën tuaj ushqimore mbron retinën e syrit.

Studimi i ri i publikuar nga prestigjiozja "Daily Mail" tregon se rrushi mbron sytë dhe redukton rrezikun nga një verbëri e mundshme në moshë madhore.

Në këtë studim bëhet me dije se ky frut ka aftësinë të mbrojë kundër një procesi kimik i njohur

me termin "stres oksidativ" i cili lëshon molekula të dëmshme në retinë.

Profesori Abigail Hackam nga Universiteti i Majamit tha se studimi provoi se rrushi mbron funksionet e retinës duke shkatërruar molekulat e dëmshme.

Rrushi është listuar si një nga frutat më të rëndësishme sepse edhe studimet e mëparshme kanë dëshmuar se ai ndihmon edhe në rënien në peshë.

KONSUMONI BORONICA PËR T'U BËRË MË INTELEGJENTË

Nëse konsumoni një tas me boronica për mëngjes mund t'ju ndalojë lodhjen deri pasdite. Kërkimet kanë zbuluar përfitimin e madh të këtij fruti pasi nxit kujtesën dhe përqendrimin deri në 5 orë më vonë.

Nga një studim i bërë, personat të cilët kanë konsumuar lëng boronice në mëngjes, kanë patur një inteligjencë më të zhvilluar dhe të freskët se sa ata që kishin konsumuar një pije tjetër, në testet që atyre u janë bërë.

Shkencëtarët që kanë bërë zbulimin mendojnë se antioksidantët tek boronicat stimulojnë qarkullimin e gjakut dhe oksigjenit dhe mbajnë mendjen të freskët.

Sipas zbulimit, njerëzit mund të përdorin boronicat fruta apo antioksidantë të tjerë për të përmirësuar aftësitë e tyre gjatë provimeve apo gjatë ditëve të gjata dhe të vështira në punë.

Doktori i cili ka kryer studimin, tha se ata që nuk konsumuan lëngun e boronicës patën një rënie të performacës në testet e inteligjencës pas 5 orëve, nga 14 në 21%.



QUMËSHTI I NËNËS ËSHTË UNIK

Qumështi i prodhuar nga trupi i njeriut është unik në të gjithë mbretërinë e kafshëve. Ai përmban rreth 200 lloje sheqernash, dyfishin krahasuar me atë të lopës.

Qumështi i gjirit është i pari produkt që konsumohet nga foshnjat, por shumë nga molekulat e sheqerit nuk i shërbejnë nevojës së fëmijës për ushqim.

Të sapolindurit vijnë në jetë pa asnjë bakter në stomak, por pak ditë nga lindja ata kanë miliona dhe pas një jave, miliarda. Sheqernat e qumështit janë përbërësi i parë, me të cilat ushqehet këto baktere.

”Funksioni i parë i qumështit të gjirit është favorizimi i kolonizimit të stomakut me grup specifike

bakteresh, që të mund të tresin këto molekula sheqeri”.

Qumështi i gjirit ndihmon dhe forcon edhe sistemin imunitar tek fëmija. Ai është i pajisur me antitropa dhe molekulat e tij, ngadalësojnë rritjen e baktereve të rrezikshme dhe koordinojnë aktivitetin e qelizave të bardha.

Një muaj pas lindjes së fëmijës, kur sistemi i tij imunitar fillon dhe përshtatet, përbërja e qumështit të gjirit ndryshon dhe niveli e antitropave në të ulët në 90%. Por gjithashtu një rënie pësojnë dhe disa nga molekulat e sheqerit, ndërsa rritet numri i yndyrave dhe përbërësve që ndihmojnë në rritjen.

MËSIMI I NJË GJUHE TË HUAJ MBRON TRURIN

Deri disa vite më parë të shumtë ishin ata që ishin të bindur, që mësimi i dy gjuhëve mund të gjeneronte ngatërresë. Më mirë të mësoh mirë një dhe të saktë sesa lodhesh më kot, me rrezikun e efekteve anësore.

Por teoritë e reja në lidhje me këtë çështje, tregojnë avantazhet e mëdha që vijnë nga mësimi i një gjuhe tjetër.

FORCON KUJTESËN DHE PËRQËNDRIMIN

Një studimi mbi bilingistikën tregon se mësimi i dy gjuhëve vonon shfaqjen e Alzheimer, deri në 5 vjet tek personat që kanë prezent faktorë rreziku për shfaqjen e kësaj sëmundje. Kërkimet tregojnë se një parandalim efikas i kësaj patologjie është pikërisht mësimi i një gjuhe të huaj në moshë të thyer.

AVANTAZHE TË MIRA DHE PËR TË VEGJLIT

Duket se fëmijët e rritur në një ambient që fliten dy gjuhë, zhvillojnë aftësi mendore më të mëdha se

ata të rritur në një ambient normal. Tek këta fëmijë vihet re një aftësi me e madhe në përlllogaritje dhe në lexim.

Gjithashtu mësimi i një gjuhe të re, mund të ndryshojë edhe mënyrën se si e shikojmë botën. Psh, të mësoh japonisht, që i dallon qartësisht tonalitetin e ngjyrës blu të hapur me blu të mbyllur, mund të ndihmojë për të perceptuar më mirë ngjyrat nga pikëpamja vizive.

GJUHA MUND TË MODIFIKOJË TRURIN

Benjamin Lee Whorf në vitin 1940 hodhi teorinë, sipas të cilit, gjuha plazmon trurin në atë pikë, sa dy njerëz me gjuhë të ndryshme do të jenë gjithmonë të ndryshëm. Kjo sepse do të kenë një mënyrë të ndryshme për të përfaqësuar botën dhe për të jetuar emocionet.

Ashtu siç do të thoshte dhe i madhi Charlemagne, “Të njohësh një gjuhë tjetër, do të thotë të kesh një shpirt të dytë.




TRENI I PADUKSHËM NË JAPONI

Japonia është vendi që padyshim sjell ndryshime në teknologji. Këtë rradhë do të sjellë trenat më të mahnitshëm të së ardhmes. E njohur për trenat plumb apo ndryshe “Maglev Line”, që prej 2 vitesh i ofrojnë udhëtarëve shërbim nëpër gjithë vendin, me një shpejtësi deri mbi 580 km/h, tashmë Seibu Railway Co po planifikon që të ndërtojë një tren që do të jetë virtualisht i padukshëm.

I dizenuar nga arkitekti Kazuyo Sejima nga firma japoneze Sanaa, që së fundmi u vlerësua me çmimin Pritzker, çmimi Nobel për Arkitekturën, treni nuk do të jetë totalisht i padukshëm, por super-reflektues.


Treni do të jetë i ndërtuar me pasqyra që do të bëjnë të mundur reflektimin e çdo objekti që e



rrethon. Gjithashtu dizajni në fjalë do të mund të aplikohet edhe tek trenat ekzistues.

Treni i padukshëm pritet që të jetë gati në 2018-ën dhe do të mbulojë mbi 178 kilometra nëpër Japoni.

ZBULOHEK NJË GJENDJE E RE E MATERIES



Shkencëtarët zbuluan për herë të parë një gjendje misterioze të materies, e parashikuar katër dekada më parë nga studiuesi Philip Warren Anderson, fitues i çmimit Nobel.

Formën e re të materies shkencëtarët e kanë quajtur “tjerrja kuantike likuide”. Në këtë gjendje, elektronet sillen sikur të jenë të “fragmentarizuar”, në kaos të rregullt. Quhet kaos i rregullt pasi nuk përplasen asnjëherë me njëri-tjetrin dhe njëkohësisht janë të lirë të bëjnë çfarë të duan.

Ky kaos, sipas studiuesve, krijon një strukturë magnetike të panjohur deri më tani në natyrë.

“Deri më tani gjendja apo faza e materies e parashikuar nga Anderson nuk ishte riprodhuar asnjëherë. Ky është një rezultat me rëndësi sep-

se është vëzhguar dhe zbuluar një fenomen krejt ndryshe nga ajo që ndodh në natyrë”, thotë Pasquale Calabrese, fizikant në Shkollën e Studimeve të Avancuara në Trieste, pjesëmarrës në studim.

Më konkretisht, shkencëtarët thonë se ky zbulim do të ndihmojë në të ardhmen në krijimin e superkompjuterave ose kompjuterave kuantikë shumë herë më të fuqishëm nga ata që njohim sot.

Tek mikroçipët aktualë informacioni ruhet në formën e 0 ose të 1, ose i njohur ndryshe si sistemi binar. Ky sistem ka funksionuar mirë deri më tani, por lejon procesimin e një numri të kufizuar informacionesh.

Revolucioni mund të nisë nga ky zbulim, pasi lëvizja kaotike (por edhe të mos përplasen) e elektroneve do të mundësonte në të ardhmen gjetjen e materialeve në gjendje që të përdorin njëkohësisht si statusin 0, ashtu edhe 1, apo edhe të dyja bashkë. Për këtë, shkencëtarët thonë se “likuidi i tjerrë kuantik” është kandidati kryesor për të qenë silikoni i së ardhmes.

Zbulimi i takon “Oak Ridge National Laboratory” në Shtetet e Bashkuara dhe u publikua në revistën “Nature Materials”.

5G

RRJETI 5G

Gjenerata e pestë e rrjetit të telefonave 5G është aktualisht sfida më e madhe dhe misteri më i madh në botën e teknologjisë.

Ndonëse është ende herët për të thënë se rrjeti wireless 5G do të jetë gati shumë shpejt, kompanitë po punojnë fort për ta bërë këtë realitet.

Kompani si AT&T e Verizon pritet të nisin testimet e para këtë verë. T-Mobile nuk mbetet prapa, ndonëse dëshiron që konsumatorët të kuptojnë se rrjeti 5G do të dojë ende kohë për t'u prezantuar.

Vetë drejtuesi i kësaj kompanie, Neville Ray për website e teknologjisë "Re/code" tha se ajo

çfarë po mundohen të bëjnë është të ndryshojnë historinë.

Ai premtoi se kompania e tij do të nisë testimin e 5G brenda këtij viti.

Megjithatë, Ray tha se, si kompania që ai drejton ashtu edhe konkurentët, nuk pritet që ta kenë gati këtë shërbim përpara 2020 – ë.

5G, gjenerata e re e rrjetit të telefonave celularë, sipas ekspertëve, parashikohet që të jetë "parajsa" e wireless me një shpejtësi 100 herë më të lartë se 4G LTE, që aktualisht është tepër e shpejtë.

KONFIRMOHET ELEMENTI I 115-TË NË TABELËN PERIODIKE

Meizu ka njoftuar se po e lanson modelin e saj të fundit të lirë, Meizu M3, dhe çmimet për telefonin do të fillojnë prej vetëm 92 dollarë në Kinë.

Meizu M3 vjen me një ekran me diagonalen prej 5 inç me rezolucionin HD prej 1820 x 720 pikselëve dhe pajisja është mundësuar nga procesori i MediaTek, MT6750 octa core.

Për më shumë, do të jenë dy versione të Meizu M3, një me 16GB memorie dhe 2GB RAM, dhe tjetri me 32GB memorie dhe 3GB RAM, si dhe opsionet për

rritje të hapësirës me microSD.

Karakteristikat tjera të pajisjes do të përfshijë edhe kamerën me 5MP f / 2.0 në pjesën e përparme dhe një tjetër me 13MP f / 2.2 në anën e pasme.

Pajisja gjithashtu do të vjen me WiFi, Bluetooth dhe 4G LTE dhe baterinë me 2870 mAh.

Çmimet për modelin me 16GB që është rreth 92 dollarëve, dhe modeli me 32GB do të kushtojë rreth 123 dollarë.

